# RAPORT MBI ZBATIMIN E KONVENTËS CEDAW NË SHQIPËRI

**PARAQITUR NGA INSTITUCIONI I AP PARA KOMITETIT TË KOMBEVE TË BASHKUARA TË KONVENTËS MBI ELIMINIMIN E TË GJITHA FORMAVE TË DISKRIMINIMIT NDAJ GRAVE, CEDAW**

**Tiranë, 2016**

Ky raport “Mbi zbatimin e Konventës CEDAW në Shqipëri” është përgatitur nga institucioni i Avokatit të Popullit, me mbështetjen financiare dhe teknike të Entit të Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave, (UN WOMEN), në kuadër të Programit të Bashkëpunimit ndërmjet Qeverisë së Shqipërisë dhe Kombeve të Bashkuara 2012-2016. Institucioni i AP paraqiti këtë raport të plotë dhe një përmbledhje të raportit në grupin e punës para sesionit të Komitetit CEDAW. Gjithashtu, një informacion me shkrim u paraqit nga institucioni i AP për sesionin e 64-ët të Komitetit CEDAW, të datës 12 korrik 2016. Mendimet dhe pikëpamjet e shprehura në raport janë të autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Entit të Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave (UN WOMEN) ose të Kombeve të Bashkuara.

Titulli: “**Mbi zbatimin e Konventës CEDAW në Shqipëri**”
Periudha e raportimit: 2010-2014

Copyright © UN Women 2016
**UN Women Country Office Albania**
Rr. Skenderbej, Pall. 8, ap. 29-31, Tirana, Albania
Tel: +355 4 450 2555 / 7575
Facebook: unwomenalbania

**Institucioni i Avokatit të Popullit**
Blv. “Zhan D’Ark”, Nr. 2, Tiranë
Email: ap@avokatipopullit.gov.al
Tel: 04 2 380 300, 04 2380 333
Fax: 04 2 380 315
Facebook: Avokati i Popullit

**Kontribues kryesorë**

**Institucioni i Avokatit të Popullit**

Nën drejtimin e Z.Igli Totozani, Avokat i Popullit, falenderojmë stafin që kontribuoi në hartimin e raportit:
Fatbardh Zenelaj, Sekretar i Përgjithshëm,
Znj. Etilda Gjonaj (Saliu), Komisionere, Seksioni i Administratës Publike,
Znj. Jorida Rustemi, Drejtuese e Njësisë për Parandalimin e Torturës (MKPT),
Znj. Anila Nepravishta, Ndihmëskomisionere,
Z. Alket Jaupi, Ndihmëskomisionere,
Znj. Mimoza Morina, Ndihmëskomisionere,
Znj. Inesa Brokaj, Ndihmëskomisionere,
Znj. Mimoza Gjika, Këshilltare për Shoqërinë Civile dhe Bashkëpunimin Ndërkombëtar,

**UN Women Country Office Albania**
Ma. Fiorela Shalsi, Drejtuese e programit Lidershipi dhe Pjesëmarrja Politike, UN Women
Zj. Aurela Bozo, Eksperte Kombëtare e UN Women

Viti i botimit: Tiranë, 2016.
Redaktore letrare: Gjylso Binaj

# TABELA E PËRMBAJTJES


| | |
|---|---|
| **LISTA E SHKURTIMEVE** | **4** |
| **FJALA PËRSHËNDETËSE E AVOKATIT TË POPULLIT** | **6** |
| **PJESA E PARË** | **8** |
| 1. Qëllimi i raportit dhe metodologjia | 8 |
| 2. Hyrje | 8 |
| 3. Konsiderata të përgjithshme | 10 |
| **PJESA E DYTË - ANALIZA E FUSHAVE SPECIFIKE** | **14** |
| A. PJESËMARRJA E GRAVE NË POLITIKË DHE NË VENDIMMARRJE<br>Nenet 7 & 8 & 4 të Konventës CEDAW, paragrafi 22 i VP | 14 |
| B. AKSESI I GRAVE NË SISTEMIN E DREJTËSISË<br>Neni 2 i Konventës CEDAW, paragrafët 14, 15 dhe 27 të vërejtjeve përmbyllëse të Komitetit mbi Eliminimin e Diskriminimit të Grave | 18 |
| C. FUQIZIMI EKONOMIK<br>Neni 11 i Konventës CEDAW, paragrafi 32, 33 i VP të Komitetit CEDAW | 44 |
| D. DHUNA NË FAMILJE<br>Neni 5 i Konventës CEDAW, rekomandimi i përgjithshëm nr. 19 i Komitetit mbi Eliminimin e Diskriminimit të Grave, CEDAW | 54 |
| E. AKSESI NË PËRFITIME EKONOMIKE DHE NË SHËRBIME SOCIALE<br>Neni 13 i Konventës CEDAW, paragrafi nr. 36 & 37 i VP | 65 |
| F. BUXHETIMI GJINOR<br>Neni 3 i Konventës CEDAW | 74 |

# LISTA E SHKURTIMEVE

| | |
|---|---|
| AP | AP |
| ALUIZNI | Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integrimit të Zonave/Ndërtimore Informale |
| AFP | Agjencia e Formimit Profesional |
| BE | Bashkimi Evropian |
| CEDAW | Konventa “Mbi eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit të grave” |
| FARSH | Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë |
| FSHDPAK | Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar |
| GADC | Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim |
| GNP | Grupi ndërministror i punës |
| GjRrGj | Gjykata e rrethit gjyqësor |
| GjK | Gjykata Kushtetuese |
| GJEDNJ | Gjykata Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut |
| IEVP | Institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale |
| INSTAT | Instituti i Statistikave |
| ISHP | Inspektorati Shtetëror i Punës |
| Komiteti CEDAW | Komiteti mbi eliminimin e diskriminimit ndaj grave |
| Kushtetuta e RSH | së-Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë |
| KC | Kodi civil |
| KP | Kodi penal |
| KF | Kodi i familjes |
| K.Pr.C | Kodi i procedurës civile |
| K.Pr.P | Kodi i procedurës penale |
| KZ | Kodi zgjedhor |
| KQZ | Komisioni Qendror i Zgjedhjeve |
| KE-Këshilli i Evropës | International Coordinating Committee of National Human Rights Institutions |
| (ICC) | Komiteti Koordinues Ndërkombëtar i Institucioneve Kombëtare të të Drejtave të Njeriut |
| KLD | Këshilli i Lartë i Drejtësisë |
| KSHH-Komiteti Shqiptar i Helsinkit | Immediate Protection Order |
| KSHNJ | Komisioni shtetëror i ndihmës juridike |
| KMD | Komisioneri për mbrojtjen nga diskriminimi |
| KDPAK | Konventa e OKB-së "Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuar" |
| KMCAP | Komisioni mjekësor i caktimit të aftësisë për punë |
| LGBTI | Lesbike, homoseksualë, biseksualë, transeksualë dhe ndërgjinorë |
| MSA | Marrëveshja e stabilizim-asociimit |

| | |
|---|---|
| MMSR | Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë |
| MD | Ministria e Drejtësisë |
| MSH | Ministria e Shëndetësisë |
| MF | Ministria e Financave |
| MKR | Mekanizmi Kombëtar i Referimit të Rasteve të Dhunës në Familje |
| MPCSSHB | Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta |
| OJF | Organizata jofitimprurëse |
| OKB | Organizata e Kombeve të Bashkuara |
| PNUD | Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim |
| PAK | Persona me aftësi të kufizuar |
| PuPa | Punëkërkues të papunë |
| QNL | Qendra për Nisma Ligjore Qytetare |
| RSH | Republika e Shqipërisë |
| RKPK | Raporti i katërt periodik kombëtar |
| SKBGJ | DHF-Strategjia Kombëtare "Për barazinë gjinore dhe reduktimin e dhunës në familje" |
| SHPSH | Shërbimi Përmbarimor Shtetëror |
| SHSSH | Shërbimi Social Shtetëror |
| SHM | Shkolla e Magjistraturës |
| UMM | Urdhër i menjëhershëm i mbrojtjes |
| UM | Urdhër mbrojtje |
| VKM | Vendim i Këshillit të Ministrave |
| VP | Vërejtje përmbyllëse |
| ZRPP | Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme |
| ZVRPP | Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme |

# FJALA PËRSHËNDETËSE E AVOKATIT TË POPULLIT

Shoqëritë më të zhvilluara dhe më demokratike sot në botë duket se çelësin e suksesit e kanë edhe tek shanset e hapësirat që ofrojnë e krijojnë për gratë, gjysmën më të mirë të popullsisë, duke vënë në eficencë talentin, energjinë dhe përkushtimin e tyre. Sa më i vogël hendeku mes burrit dhe gruas aq më e mirë është performanca e shoqërisë, si nga këndvështrimi social ashtu edhe ekonomik. Ka një korrelacion direkt midis pabarazisë gjinore në mundësitë dhe rritjen reale ekonomike. Dhe një shoqëri që aspiron demokracinë dhe zhvillimin e qëndrueshëm, për një jetë më të mirë e dinjitoze për qytetarët e saj, duhet të fokusohet në investimin më të mirë-fuqizimin e gruas.

Me mbështetjen e Entitetit të Kombeve te Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave, (UN WOMEN), Institucioni i Avokatit të Popullit paraqiti një raport para Komitetit CEDAW, mbi zbatimin e Konventës CEDAW në Shqipëri dhe përfaqësues të institucionit morën pjesë në sesionin e 64-ët të Komitetit CEDAW, në korrik 2016. Është hera e parë që Avokati i Popullit, si institucion kushtetues i pavarur për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut, përfshirë të drejtat e garantuara nga Konventa CEDAW kontribuoi përmes një raporti më vehte mbi zbatimin e kësaj konvente në Shqipëri. Në këtë kuadër, qëndrimi i një institucioni të pavarur kushtetues në mbrojtje të të drejtave të grave, është mjaft i rëndësishëm, orientuar jo vetëm nga rezultatet e arritura, në lidhje me barazinë ligjore, por edhe në lidhje me arritjen e barazisë thelbësore, substanciale.

Në raport u theksua se, vitet 2010-2014 kanë shënuar arritje në fushën e barazisë gjinore në Shqipëri. Janë ndërmarrë hapa në legjislacion, zbatimin e legjislacionit, kuadrin institucional, politika dhe praktika që kanë sjellë progres në disa fusha.

Por, pavarësisht nga përmirësimet në legjislacion, gratë në Shqipëri vazhdojnë të përballen me pabarazi dhe diskriminim për shkak se janë gra dhe mbetet shumë për të bërë, me qëllim gëzimin de facto të të drejtave dhe mbrojtjen efektive të grave nga diskriminimi gjinor.

Çështjet e ngritura në raportin e Institucionit të Avokatit të Popullit dhe në fjalën e mbajtur në këtë sesion u bënë pjesë e Vërejtjeve Përmbyllëse të Komitetit CEDAW për Shqipërinë. Këto Vërejtje kërkojnë një përmirësim të kuadrit ligjor të barazisë gjinore dhe mosdiskriminimit në përputhje me standardet ndërkombëtare, pjesëmarrje të barabartë të grave dhe vajzave në jetën politike dhe publike, marrjen e masave me qëllim heqjen e pengesave faktike për pjesëmarrjen në zgjedhje të grave në nevojë, rritjen e aksesit të grave në sistemin e drejtësisë, monitorimin e efekteve mbi gratë të masave të veçanta të përkohshme në të gjitha fushat, vëmendjen e veçantë ndaj grave

të grupeve vulnerabile, parandalimin dhe mbrojtjen efektive të grave nga dhuna në marrëdhëniet familjare, forcimin e MKR ekzistuese dhe ngritjen e MKR të reja në të gjitha njësitë e qeverisjes vendore, reduktimin e diferencës në paga midis dy gjinive dhe aksesin e barabarte të grave në tregun formal të punes, organizimin e trajnimeve të vazhdueshme me profesionistët e sistemit të drejtësisë mbi të drejtat e grave, standardet e BE-së për barrën e proves në rastet e diskriminimit në marrëdhëniet e punës, përfshirë ngacmimet seksuale në punë, si dhe njohjen e standardeve që burojnë nga Konventa CEDAW mbi barazinë në marrëdhëniet e punës, integrimin e çështjeve gjinore në të gjitha politikat, planet e veprimit dhe buxhetet në nivel vendor, etj.

Si Avokat i Popullit, besoj që një qeverisje e përgjegjshme gjinore e ka kusht kryesor shndërrimin e përparësive kombëtare gjinore në vendore. Për këtë nevojitet një plan konkret veprimi gjinor, ku gratë duhet të luajnë një rol vendimtar në hartimin dhe në zbatimin e tij, me veprime më të koordinuara dhe të matshme në realizimin e tyre.

Vërejtjet Përmbyllëse përbëjnë një platformë pune për institucionin e AP dhe të gjithë aktorët që punojnë në fushën e të drejtave të Njeriut dhe në mënyrë të veçantë të drejtave të grave. Njohja dhe zbatimi i Vërejtjeve Përmbyllëse të Komitetit CEDAW për Shqipërinë, i shërben garantimit të të drejtave të grave në fushat që mbulon Konventa mbi Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave, CEDAW. Ndaj hartimin e një plani pune institucional, e konsiderojmë tejet të rëndësishëm në zbatim të rekomandimeve të Komitetit CEDAW, me synim ushtrimin dhe gëzimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut nga gratë mbi bazën e barazisë me burrat, në të gjitha fushat që mbulon konventa. Së bashku do të punojmë edhe për zbatimin e tij.

Ne duhet të thyejmë një herë e mirë paragjykimet dhe, zërat tanë së bashku duhet të dëgjohen fort: Të drejtat e grave nuk mund të ndahen nga të drejtat e njeriut. Ato janë një e vetme.

**AVOKATI I POPULLIT**

**Igli TOTOZANI**

# PJESA E PARË

## 1. Qëllimi i raportit dhe metodologjia.

Ky raport, i përgatitur nga institucioni i AP, përbën një analizë të arritjeve dhe boshllëqeve ligjore dhe faktike në lidhje me përmbushjen e detyrimeve që i dalin shtetit shqiptar nga Konventa "Mbi eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave", CEDAW[1] në disa fusha.

Nenet e Konventës CEDAW shërbyen si një pikë referimi në përgatitjen e këtij raporti në lidhje me çështjet e përzgjedhura për t'u trajtuar, si: pjesëmarrja e grave në politikë dhe në vendimmarrje, dhuna në familje, aksesi në sistemin e drejtësisë dhe në shërbimet sociale si dhe fuqizimi ekonomik i tyre. Me qëllim matjen e progresit të kryer nga shqyrtimi i raportit të tretë periodik të shtetit shqiptar, përgatitja e këtij raporti u orientua edhe nga hapat e ndërmarrë në lidhje me shqetësimet dhe rekomandimet e shprehura nga Komiteti mbi Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave në VP të tij, në sesionin e dyzetë e gjashtë, më 12-30 korrik 2010, përfshirë rekomandimet që lidhen me rolin e institucionit të AP në zbatimin e Konventës CEDAW. Gjithashtu, dhe rekomandimet e përgjithshme të Komitetit CEDAW kanë orientuar analizën në këtë raport.

Për të vlerësuar progresin dhe identifikuar problematikat në garantimin në praktikë të të drejtave të grave, është analizuar veprimtaria e AP, përmes shqyrtimit të ankesave dhe dhënies së rekomandimeve për marrjen e masave për zgjidhjen e tyre, çështjeve të nisura me iniciativë, rekomandimeve legjislative, përgatitjes dhe paraqitjes në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë të raporteve vjetore dhe të veçanta, bashkëpunimit të ngushtë me OJF-të, kryerjes së inspektimeve etj,. Në përgatitjen e raportit u përdorën intervistat me punonjës të institucionit, bazuar në pyetësorët e përgatitur nga grupi i punës, si edhe të dhënat e siguruara prej tyre. Raporti evidenton problematikat në zbatimin e Konventës CEDAW, rekomandimet e institucionit të AP në zbatim të kësaj konvente dhe sa këto rekomandime janë përmbushur nga legjislativi, ekzekutivi dhe gjyqësori.

Përveç të dhënave nga raporti i katërt periodik kombëtar mbi zbatimin e Konventës CEDAW, janë kryer takime dhe intervista me përfaqësues të aktorëve të ndryshëm shtetërorë dhe joshtetërorë, me qëllim marrjen e informacionit, bazuar në një pyetësor të përgatitur në bazë të çështjeve të përzgjedhura për t'u trajtuar. Kjo ka mundësuar përgatitjen e një raporti me bazë të gjerë në analiza, konkluzione dhe rekomandime.

Raportet dhe studimet ekzistuese të aktorëve shtetërorë, organizatave të shoqërisë civile, në veçanti organizatave që punojnë për të drejtat e grave, raportet e progresit për Shqipërinë, raporte të organizatave të ndryshme ndërkombëtare etj., janë një burim i pasur informacioni.

Perspektiva e grave dhe nevojat e tyre kanë ardhur në këtë raport edhe përmes bashkëpunimit të AP me OJF-të që punojnë për të drejtat e grave dhe garantimin e barazisë gjinore.

Analiza referohet edhe në treguesit e vlerësimit dhe të monitorimit të barazisë gjinore dhe dhunës ndaj grave, përfshirë dhunën në familje, mbikëqyrjen, mbledhjen dhe përpunimin e tyre, të përcaktuar në Udhëzimin e MPCSSHB, nr. 1220, datë 27.05.2010.

## 2. Hyrje.

1. Me ratifikimin e Konventës CEDAW, me Ligjin[2] nr. 7767, datë 9.11.1993 dhe Protokollit shtesë[3] të kësaj konvente me Ligjin nr. 9052, datë 17.4.2003, shteti

1 Shqipëria ratifikoi Konventën CEDAW me Ligjin nr. 1769, datë 9.11.1993, botuar në Fletoren zyrtare nr. 33, datë 15.10.2008. Që nga ky moment, sipas Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 122/1, kjo konventë është pjesë e sistemit të brendshëm juridik si çdo marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar.

2 Ligji nr. 7767, datë 9.11.1993, "Për aderimin në Konventën 'Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit të grave".

3 Ligji 9052, datë 17.4.2003, "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Protokollin shtesë të Konventës "Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit të grave".

shqiptar ka shprehur vullnetin e tij për të përmbushur detyrimet që dalin nga kjo konventë, në lidhje me barazinë gjinore dhe eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit të grave.

2. Në mbështetje të nenit 18 të Konventës CEDAW, shteti shqiptar ka paraqitur pranë Komitetit CEDAW raportin e katërt periodik kombëtar mbi zbatimin e kësaj Konvente, miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave[4] nr. 806, datë 26.11.2014. Mbështetur në Urdhrin e Kryeministrit nr. 112, datë 03.03.2014, "Për ngritjen e grupit ndërministror të punës mbi hartimin dhe pjesëmarrjen në shqyrtimin e raporteve në kuadër të konventave ndërkombëtare për të drejtat e njeriut", institucioni i AP në përbërje të GNP ka kontribuar në përgatitjen e raportit shtetëror mbi zbatimin e Konventës CEDAW në Shqipëri.

3. Është hera e parë që AP, si institucion kushtetues i pavarur për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut, përfshirë të drejtat e garantuara nga Konventa CEDAW, kontribuon përmes një raporti mbi zbatimin e kësaj konvente në Shqipëri. Në këtë kuadër, qëndrimi i një institucioni të pavarur kushtetues në mbrojtje të të drejtave të grave është mjaft i rëndësishëm, orientuar jo vetëm nga rezultatet e arritura në lidhje me barazinë ligjore, por duke i njohur ato, orientuar edhe nga boshllëqet në lidhje me arritjen e barazisë thelbësore, substanciale.

4. Institucioni i AP është krijuar më 1998, me miratimin e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, me Ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998. Në vitin 1999 Parlamenti i Republikës së Shqipërisë miratoi Ligjin nr. 8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", në të cilin përcaktohen rregullat e organizimit dhe funksionimit të AP[5].

5. AP udhëhiqet nga parimet e paanësisë, konfidencialitetit, profesionalizmit dhe pavarësisë, vepron si mbrojtës i të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të qytetarëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike, si dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të saj. Po kështu, institucioni i AP është angazhuar në një rol proaktiv në promovimin e standardeve më të larta të të drejtave të njeriut në vend.

6. Barazia gjinore dhe mosdiskriminimi janë pjesë e tërësisë së të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Mbrojtja nga diskriminimi përbën një të drejtë universale, ajo është jo vetëm një e drejtë e individit, por edhe një detyrim i organeve të administratës shtetërore si dhe i të gjithë aktorëve dhe faktorëve të tjerë në vend.

7. Çështjet e të drejtave të grave janë trajtuar në planin strategjik dhe planin e veprimit për institucionin e AP, 2013 - 2015, duke u bërë kështu pjesë e politikave të institucionit.

8. Veprimtaria e AP është në përputhje me parimet mbi statusin e institucioneve kombëtare për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, ("Parimet e Parisit") të miratuara nga Asambleja e Përgjithshme në vitin 1993[6] . AP është akredituar nga nënkomiteti i akreditimit të ICC-së për herë të parë në vitin 2004 dhe është riakredituar në vitin 2008, me status "A" nga ky komitet. Nënkomiteti i akreditimit të ICC-së riakreditoi AP me status "A" në mars 2015, duke e gjetur në respektim te parimeve të Parisit.

4 Botuar në Fletoren zyrtare të Republikës së Shqipërisë, nr. 187, viti 2014.

5 "Kodi i procedurave administrative" (nr. 8485, datë 12.5.1999), Ligji "Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare" (nr. 8503, datë 30.6.1999), ligji "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve" (nr. 9888, datë 10.3.2008), Ligji "Për mbrojtjen e konsumatorit" (nr. 9135, datë 11.9.2003), si dhe Ligji "Për shëndetin mendor" (nr. 44/2012, datë 19.4.2012) përbëjnë bazën ligjore, ku përcaktohen thuajse të gjitha të drejtat dhe detyrat funksionale të Avokatit të Popullit.

6 Parimet në lidhje me statusin e institucioneve kombëtare për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut ("Parimet e Parisit"), Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme 48/134 e 20 dhjetorit 1993.

9. Ky raport është në përputhje me rekomandimet e nënkomitetit të akreditimit të ICC-së, pas akreditimit me statusin "A" të AP në vitin 2008 që konsistonin, ndër të tjera, edhe në forcimin e mandatit të AP, në promovimin e të drejtave të njeriut si dhe në bashkëpunimin sistematik të AP me sistemin ndërkombëtar të të drejtave të njeriut"[7]. Përgatitja dhe paraqitja e këtij raporti pranë Komitetit CEDAW pasuron aktivitetin ndërkombëtar të institucionit[8].

10. Institucioni i AP nëpërmjet këtij raporti shpreh qëndrimin e tij për pjesëmarrjen e grave në politikë dhe në vendimmarrje, aksesin e tyre në sistemin e drejtësisë, qeverisjen e ndjeshme gjinore, fuqizimin ekonomik, dhunën në familje si dhe aksesin e grave në shërbimet sociale, të konsideruara si ndër çështjet më problematiket me të cilat përballen gratë në Shqipëri. Ky raport përfshin periudhën 2010-2014.

11. Ky raport, ashtu si të gjitha raportet e përgatitura nga institucioni i AP, përshkohet nga bindja se ekzistenca e kuadrit ligjor në fuqi, që synon respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut nga ana e institucioneve publike, shpeshherë nuk është e mjaftueshme, sepse është zbatimi konkret i këtyre detyrimeve ligjore që garanton gëzimin real, të barabartë dhe pa diskriminim të të drejtave dhe lirive të njeriut nga gratë. Raporti synon të analizojë jo vetëm masat dhe iniciativat e ndërmarra, por edhe efektet e masave, iniciativave, politikave dhe praktikave mbi gratë dhe rekomandimet e tij synojnë të përmirësojnë punën e organeve përgjegjëse me qëllim gëzimin e barabartë të të drejtave nga gratë.

12. Përgatitja e këtij raporti është në përputhje edhe me Ligjin nr. 155/2014, "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 8454, datë 4.2.1999, "Për Avokatin e Popullit", të ndryshuar, "Neni 29", "Përgatitja e raporteve për të drejtat e njeriut". Kjo dispozitë parashikon se "AP kontribuon në përgatitjen e raporteve të shtetit shqiptar për organizmat ndërkombëtarë, për zbatimin e konventave të ratifikuara nga shteti shqiptar lidhur me të drejtat e liritë e njeriut në Republikën e Shqipërisë dhe mund të paraqesë pranë tyre raporte paralele". Ky ligj parashikon shtesa dhe ndryshime të rëndësishme në lidhje me promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të grave si edhe adresimin e pabarazive dhe diskriminimit gjinor.

13. Natyrshëm raporti ngre edhe shqetësime të AP në lidhje me rekomandimet pa përgjigje, rekomandimet e pazbatuara, ose pjesërisht të zbatuara nga institucionet shtetërore, mungesën e diskutimit nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë të disa prej raporteve të veçanta[9] të paraqitura nga AP në periudhën 2010-2014, mungesën e mbështetjes financiare për zyrat rajonale të institucionit në 7 qytete kryesore të vendit, ku punojnë aktualisht punonjës vullnetarë pa pagesë etj., zgjidhja e të cilave do të rrisë efektivitetin e punës së AP, në respektim të parimit të barazisë gjinore dhe mosdiskriminimit.

## 3. Konsiderata të përgjithshme.

14. Vitet 2010-2014 kanë shënuar arritje në fushën e barazisë gjinore në Shqipëri. Janë ndërmarrë hapa në legjislacion, në zbatimin e legjislacionit, në kuadrin institucional, politika dhe praktika që kanë sjellë progres në disa fusha. Gjatë periudhës së raportimit shteti shqiptar

7 AP, "Sugjerime dhe konstatime mbi udhërrëfyesin mbi 5 prioritetet miratuar me VKM Nr. 330, datë 28.05.2014", shkresë nr.296 datë 01.10.2014, drejtuar ministres së Integrimit Evropian znj. Klajda Gjosha.

8 AP është anëtar me të drejta të plota në 8 prej shoqatave/organizatave ndërkombëtare të ombudsmanëve si: Komiteti Koordinues Ndërkombëtar i Institucioneve Kombëtare të të Drejtave të Njeriut (ICC), Instituti Ndërkombëtar i Ombudsmanit (IOI), Rrjeti Evropian i Institucioneve Kombëtare të të Drejtave të Njeriut (ENNHRI), Instituti Evropian i Ombudsmanit (EOI), Organizata e Ombudsmanit dhe Mediatorit Frankofon (AOMF), Organizata e Ombudsmanit e Shteteve të Bashkuara të Amerikës (USOA), Organizata e Ombudsmanit Ndërkombëtar (IOA), Organizata e Ombudsmanit e Vendeve Mesdhetare (AOM).

9 Institucioni i AP përgatiti dhe dërgoi në Kuvendin e Shqipërisë 7 raporte të veçanta gjatë vitit 2012 dhe 5 raporte të veçanta gjatë vitit 2013.

ka ratifikuar konventa të ndryshme që lidhen me të drejtat njerëzore të grave. Të tilla janë: Konventa e Këshillit të Evropës "Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje" ratifikuar me Ligjin nr. 104/2012; KDPAK ratifikuar me Ligjin nr. 108/2012. Ratifikimi i këtyre konventave ka hapur rrugën e përafrimit të legjislacionit të brendshëm me standardet e përcaktuara prej tyre si edhe është tregues i vëmendjes në rritje të shtetit dhe aktorëve të tjerë ndaj çështjes së dhunës në familje dhe të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, ndër të cilët edhe grave me aftësi të kufizuar.

15. Miratimi i Ligjit nr. 93/2014, "Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e PAK", Ligjit nr. 33/2012, "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", Ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", Ligjit 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar", ndryshimet në Kodin zgjedhor (Ligji nr. 74/2012), në Kodin penal (Ligji nr. 23/2012 dhe ligji nr. 144/2013), në Kodin e procedurës civile (Ligji nr. 122/2013), në Ligjin nr. 10 329/30.09.2010 "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", në Ligjin, nr. 143/2013 dhe 77/2014 "Për ndihmën juridike", në Ligjin 10399/17.3.2011 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", në Ligjin nr. 40/2014 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve dhe të paraburgosurve", në Ligjin nr. 104/2014 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë etj., përbëjnë hapa të rëndësishëm për përmirësimin e kuadrit ligjor në lidhje me garantimin e të drejtave, duke respektuar barazinë dhe mosdiskriminimin për shkaqe gjinore. Megjithatë, zbatimi i këtyre ligjeve nevojitet të jetë më efektiv.

16. Strategjia Kombëtare "Për barazinë gjinore dhe reduktimin e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje 2011-2015", miratuar me VKM nr. 573, datë 16.6.2011 dhe Plani i Veprimit për zbatimin e kësaj strategjie janë një program i angazhimit të të gjithë aktorëve përgjegjës, i cili kërkon monitorim të rregullt.

17. AP vlerëson përmirësimin e kuadrit ligjor në fushat që mbulon Konventa CEDAW. Megjithatë, ndryshime ligjore janë të nevojshme me qëllim garantimin e barazisë dhe mosdiskriminimit.

18. Por, pavarësisht nga përmirësimet në legjislacion, AP konsideron se gratë në Shqipëri vazhdojnë të përballen me pabarazi dhe diskriminim për shkak se janë gra dhe mbetet shumë për të bërë, për gëzimin de facto të të drejtave dhe mbrojtjen efektive të tyre nga diskriminimi gjinor. Kështu, lidhur me përfaqësimin në jetën publike dhe politike, gratë vazhdojnë të jenë të nënpërfaqësuara nën kuotën 30 % të parashikuar në ligj dhe nën kuotën 40 % të rekomanduar nga Këshilli i Evropës.

19. Me qëllim rritjen e pjesëmarrjes së grave në politikë dhe në vendimmarrje, në marrëdhëniet e punës si edhe në fusha të tjera, janë ndërmarrë masa të veçanta të përkohshme nga shteti shqiptar, por mungojnë monitorime dhe vlerësime të vazhdueshme mbi rezultatet e tyre.

20. Lidhur me përfitimin e ndihmës juridike në nivel kombëtar, në zbatim të Ligjit nr. 10 039, datë 22.12.2008, "Për ndihmën juridike", i ndryshuar, numri i grave përfituese është i vogël në raport me nevojat. Ato kanë një nivel të pamjaftueshëm informacioni në lidhje me të drejtën për ndihmë juridike, rolin e KSHNJ, kushtet që duhet të plotësojnë për përfitimin e ndihmës juridike etj.

    Lidhur me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, me të cilat është vendosur detyrimi në të holla i institucioneve buxhetore apo kryerja e një veprimi të caktuar ndaj subjekteve të ndryshme gjyqfituese, detyrimi për rikthimin në detyrë të gjyqfituesve, ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë që lidhen me çështje të ushtrimit të përgjegjësisë prindërore, si e drejta e takimit, pagesa e detyrimit ushqimor për fëmijët nga ish-bashkëshorti pas zgjidhjes së martesës etj. kanë rezultuar problematika që kanë cenuar të drejtën e grave për proces të rregullt ligjor. Të gjitha këto kanë sjellë efekte në aksesin e tyre në sistemin e drejtësisë dhe gëzimin e të drejtave të parashikuara nga Konventa CEDAW si, gëzimi i të drejtave të barabarta në martesë dhe në jetën familjare, etj.

21. Gratë vazhdojnë të përballen me pengesa

ligjore dhe praktike kur ato kërkojnë dëmshpërblim për aktet e diskriminimit bazuar në seks dhe gjini. Sipas ligjit "Për mbrojtjen nga diskriminimi", paditësi, përfshirë gratë, ka detyrimin të sjellë prova në mbështetje të padisë, për të provuar sjelljet diskriminuese, në rastet e diskriminimit bazuar në seks, duke përfshirë ngacmimet seksuale në vendin e punës. Garantimi i barazisë dhe i mbrojtjes nga diskriminimi në marrëdhëniet e punës kërkon përafrim më të plotë të legjislacionit shqiptar antidiskriminim dhe të punës me acquis communautaire të BE-së, e konkretisht në lidhje me institutin e barrës së përmbysur të provës, mbrojtjes nga ngacmimet seksuale në vendin e punës etj.

22. Papunësia, kryerja më së shumti nga gratë e punëve të papaguara në familje, vështirësitë në lidhje me harmonizimin e angazhimeve në familje dhe punë, diferencat në paga, diskriminimi gjinor janë disa probleme me të cilat përballen gratë në marrëdhëniet e punës. Njohja dhe përdorimi i mjeteve ligjore për mbrojtjen nga diskriminimi gjinor dhe efektiviteti i zbatimit të ligjit "për mbrojtjen nga diskriminimi" (2010) në marrëdhëniet e punës ka nevojë të forcohet.

23. Gratë, në mënyrë të veçantë gratë e divorcuara, gratë prind i vetëm, gratë kryefamiljare, gratë rome, gratë me aftësi të kufizuar, dhe grupe të tjera në nevojë përballen me probleme në lidhje me aksesin e tyre në sistemin e drejtësisë, pabarazi në fushën e punës dhe barriera në përfitimet sociale dhe ekonomike. Mungojnë masa ligjore dhe administrative të cilat rrisin aksesin e grave rome në shërbime dhe pjesëmarrjen në jetën publike.

24. Gratë me aftësi të kufizuar janë përballur me diskriminim të dyfishtë, lidhur ngushtë me kushtet e tyre të veçanta të jetesës. Këto gra përballen me sfida në lidhje me aksesin e tyre në drejtësi, strukturat shtetërore në nivel qendror dhe lokal, media dhe biznes, vonesa në përfitimin e pagesës PAK. Mungojnë të dhëna të mjaftueshme mbi masat e marra nga shteti shqiptar për të trajtuar situatën e veçantë të grave me AK, përfshirë masat e veçanta, për të siguruar që ato kanë akses të barabartë në punësim, sigurime shoqërore, arsim, shëndetësi, jetën sociale dhe kulturore, siç edhe është shprehur nga rekomandimi i përgjithshëm i Komitetit CEDAW nr. 18 për gratë me aftësi të kufizuar.

25. Pavarësisht zhvillimeve në legjislacionin për ndihmën dhe shërbimet shoqërore, gratë kanë hasur vështirësi në përfitimin e ndihmës ekonomike në zonat pilot. Puna e pushtetit vendor në lidhje me ofrimin e shërbimeve sociale, përmirësimin e shpërndarjes, tipologjisë së shërbimeve shoqërore, llojshmërisë së tyre në përputhje me nevojat e grupeve vulnerabile ka nevojë të përmirësohet. Mungojnë masa efektive në favor të lehtësimit të marrjes së kredive nga gratë. Analiza gjinore të efekteve të masave sociale ekonomike mbi gratë nuk kryhen në mënyrë të rregullt.

26. Dhuna në familje vazhdon të përbëjë një problem shqetësues, me të cilin përballen sidomos gratë në shoqërinë shqiptare. Pavarësisht legjislacionit, politikave dhe praktikave që adresojnë dhunën në familje, efektiviteti i zbatimit nuk është në nivelin e duhur. Reagimi në mënyrë të koordinuar në menaxhimin e rasteve të dhunës në familje mbetet një sfidë për anëtarët e mekanizmit të koordinimit dhe referimit të rasteve të dhunës në familje në nivel vendor. Strukturat përgjegjëse për zbatimin e vendimeve për lëshimin e UMM/UM, zyra e përmbarimit, policia dhe njësitë e qeverisjes vendore nuk i përgjigjen shpejtësisë së gjykimit të kërkesave për UM/UMM nga gjykata dhe numrit në rritje të vendimeve. Shërbimet sociale kanë nevojë të përmirësohen dhe të përmbushin standardet e miratuara, të jenë të përshtatshme, lehtësisht të aksesueshme, në numër të mjaftueshëm dhe me një shpërndarje më të mirë gjeografike për të ofruar strehim të sigurt ndaj viktimave, veçanërisht grave dhe fëmijëve të tyre. Numri i grave viktima të dhunës në familje ose formave të ndryshme të dhunës me bazë gjinore si trafikimi, diskriminimi për shkak të gjinisë etj., që kanë përfituar shërbim ligjor falas është i vogël, në raport me nevojat për këtë shërbim. Burimet në nivel qendror

dhe vendor nuk janë të mjaftueshme për të ndihmuar gratë, viktima të dhunës në familje, të rindërtojnë jetën e tyre duke përfshirë mundësitë për punë dhe strehim.

27. Abuzimet seksuale për shkak të shpërdorimit të varësisë, ose të detyrës mbeten shpesh të heshtura ose të padenoncuara, duke kërkuar ndryshime në Kodin penal dhe Kodin e punës.

28. Niveli i njohurive të grave mbi mjetet ligjore që nevojiten të përdorin për gëzimin e të drejtave të pronësisë është i kufizuar. Mungojnë monitorime nga perspektiva gjinore të zbatimit të Strategjisë "Reforma në fushën e të drejtave të pronësisë 2012-2020" dhe Ligjit nr. 33/2012, "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme".

29. Megjithëse është një nga objektivat sociale të garantuar nga Kushtetuta e RSH-së dhe një sërë aktesh ligjore dhe nënligjore e rregullojnë atë, strehimi përbën një nga çështjet më të mprehta me të cilën përballen gratë, në mënyrë të veçantë gratë në nevojë. Ligji nr. 9232, datë 13.05.2004, "Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane", i ndryshuar, nuk krijon mundësi reale për përfitimin e anëtarëve të minoritetit rom, pra edhe të grave rome kryefamiljare në lidhje me të drejtën për strehim.

30. Duke vlerësuar miratimin e planit të veprimit për mbështetjen e gruas sipërmarrëse 2014-2020 si dhe krijimin e fondit në mbështetje të gruas sipërmarrëse, AP inkurajon vazhdimin e përpjekjeve me qëllim që një numër sa më i madh i grave të përfitojnë nga iniciativat sipërmarrëse.

31. Gratë LBTI hasin kufizime në gëzimin e të drejtave të tyre themelore. Homofobia dhe transfobia janë fenomene shumë problematike me të cilat përballen gratë e këtij komuniteti në të gjitha fushat.

32. Institucioni i AP vëren se ndër shkaqet që paraqesin shtetasit shqiptarë në kërkesën e tyre në momentin e aplikimit për azil janë: Gjakmarrja, dhuna në familje (kundër grave), diskriminimi (minoriteti rom, komuniteti LGBT), trafikimi i qenieve njerëzore; problemet shëndetësore, arsyet ekonomike etj.[10], duke treguar qartë nevojën për marrjen e masave për adresimin e këtyre fenomeneve me të cilat përballen kryesisht gratë.

33. Megjithëse Konventa CEDAW dhe Protokolli shtesë i saj janë bërë pjesë e trajnimeve për nëpunësit gjinorë në nivel qendror dhe vendor, si dhe për punonjësit e tjerë të administratës publike, njohja dhe përdorimi i tyre si mjete të rëndësishme për forcimin e të drejtave të grave lë për të dëshiruar.

34. Në vijim, ky raport identifikon problematikat me të cilat përballen gratë në kuadrin e të drejtave që parashtron Konventa CEDAW dhe propozon disa rekomandime konkrete.

10 AP, Draft- raport, "Për ndjekjen, analizimin dhe evidentimin e shkaqeve që kanë ndikuar në rritjen e kërkesave për azil të shtetasve shqiptarë në shtetet anëtare të zonës Shengen", 2014, fq. 12-13.

# PJESA E DYTË ANALIZA E FUSHAVE SPECIFIKE

## A. PJESËMARRJA E GRAVE NË POLITIKË DHE NË VENDIMMARRJE[11]

*Neni 7, 8 dhe 4 i Konventës CEDAW, paragrafi 22 i VP.*

### 1. Kuadri ligjor dhe nevoja për përmirësimin e tij.

35. Kushtetuta e RSH[12], në nenin 45 sanksionon të drejtën e çdo shtetasi që ka mbushur tetëmbëdhjetë vjeç, të zgjedhë dhe të zgjidhet. Vota është vetjake, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë.

36. Ligji "Për barazinë gjinore në shoqëri" sanksionoi kuotën gjinore me synim një përfaqësim të barabartë gjinor në të gjitha organet e pushtetit legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor dhe në institucionet e tjera publike.[13]

37. Kodi zgjedhor i Republikës së Shqipërisë[14] (2008) i referohet të drejtës aktive dhe pasive të votimit si një e drejtë që gëzohet nga çdo shtetas shqiptar, pa dallim, përfshi këtu edhe dallimet gjinore. Kodi përcakton rregulla të qarta në lidhje me përfaqësimin e dy gjinive në përbërje të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe respektimin e kuotës gjinore për KZAZ-të. Në lidhje me përbërjen e KQV-ve nuk kërkohet respektimi i kuotës gjinore. Nuk ka parashikime në Kodin zgjedhor mbi kuotën gjinore në përbërje të GNV.

Ndryshimet e Kodit zgjedhor më 2012[15] sollën përmirësime specifike nga këndvështrimi gjinor të tilla si: detyrimin që për çdo zonë zgjedhore, të paktën 30% e listës shumëemërore dhe një në

11 Analiza e çështjes është referuar edhe në nenin 4 dhe 8 të Konventës CEDAW, Rekomandimet e përgjithshme nr. 5 (masa të veçanta të përkohshme), nr. 23 (jeta politike dhe publike), nr. 25 të Komitetit CEDAW (për nenin 4, paragrafi 1, masa të veçanta të përkohshme) dhe paragrafin 22 të VP të Komitetit CEDAW.

12 Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Ligji nr. 8417, datë 21.10.1998, i ndryshuar.

13 Ligji nr. 9970, datë 24.07.2008,"Për barazinë gjinore në shoqëri", neni 15, "Pjesëmarrja në procesin e vendimmarrjes", 'Përfaqësimi i barabartë gjinor në të gjitha organet e pushtetit legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor dhe në institucionet e tjera publike arrihet kur: a) sigurohet përfaqësim në masën mbi 30 % për secilën gjini, përfshirë edhe në organet e tyre drejtuese; b) sigurohet respektimi në mënyrë të njëjtë për secilën gjini i procedurave dhe kritereve të konkurrimit, gjatë emërimit në këto organe; c) sigurohet përfshirja mbi 30% e secilës gjini në listën e kandidatëve për zgjedhjet në organet përfaqësuese vendore; ç) sigurohet përfshirja jo më pak se 30% e secilës gjini në listën e kandidatëve të paraqitur nga partitë politike për sistemin proporcional për zgjedhjet e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë; d) sigurohet përfshirja mbi 30 për qind të secilës gjini në organet administruese të procesit të zgjedhjeve qendrore dhe vendore'.

14 miratuar me ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, ndryshuar me Ligjin nr. 74/2012, datë 19.07.2012.

15 Ligji nr. 74/2012, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, 'Kodi zgjedhor i Republikës së Shqipërisë'.

tre emrat e parë të saj t'i përkasë secilës gjini (neni 67 i KZ, "Lista e kandidatëve të partive dhe koalicioneve të partive") dhe dënimin nga KQZ-ja të subjektit zgjedhor në rastin e mospërmbushjes së këtij detyrimi në lidhje me përbërjen e listës, me gjobë 1,000,000 lekë në rastin e zgjedhjeve për Kuvendin dhe 50,000 lekë në rastin e zgjedhjeve për organet e pushtetit vendor, si dhe sanksione plotësuese[16]. Sanksionet plotësuese konsistojnë në zëvendësimin e çdo vakance në listën e subjektit, në zonën ku është konstatuar shkelja, me kandidatët vijues në listë nga gjinia më pak e përfaqësuar deri në plotësimin e kuotës gjinore. Kur vakanca i përket një mandati të fituar sipas kuotës gjinore, ajo plotësohet nga kandidati i parë në listë i gjinisë përkatëse, pavarësisht renditjes në listë. Emrat e tjerë të asaj gjinie ngjiten në listë, duke marrë renditjen e kandidatit paraardhës të së njëjtës gjini[17]. AP kontribuoi përmes dërgimit të rekomandimit (nr. 201500100, mars 2015) pesë krerëve të grupeve parlamentare të Kuvendit të Shqipërisë, "Për marrjen e iniciativës për përmirësime në Kodin zgjedhor me synim përfaqësimin dhe aksesin e barabartë gjinor". Garantimi i barazisë gjinore (50%) në përbërjen e Kuvendit të Shqipërisë, përcaktimi i kuotës gjinore 50 % për këshillat bashkiakë dhe refuzimi i listës së partive politike në rastet kur subjektet zgjedhore nuk respektojnë kuotën gjinore ishin drejtimet kryesore të këtij rekomandimi. Me Ligjin nr. 31/2015, "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, 'Kodi zgjedhor i Republikës së Shqipërisë', të ndryshuar", është parashikuar se për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore, për çdo këshill bashkie, një në çdo dy emra të njëpasnjëshëm në renditje duhet t'i përkasë së njëjtës gjini. Në rast të mospërmbushjes së kësaj kuote, subjektet zgjedhore dënohen nga KQZ me refuzimin e listës së partisë politike të kandidatëve për këshillat bashkiakë, për zgjedhjet për organet e pushtetit vendor.

38. Ligji nr. 10221, datë 4.2.2010, "Për mbrojtjen nga diskriminimi", ndalon diskriminimin në ushtrimin e të drejtës për t`u zgjedhur dhe për `tu emëruar në një detyrë publike[18].

39. Nuk ka pengesa ligjore që të përjashtojnë gratë nga mundësia e tyre që të përfaqësojnë qeverinë në arenën ndërkombëtare dhe të marrin pjesë në punimet e organizatave ndërkombëtare.

## 2. Pjesëmarrja e grave në politikë dhe në vendimmarrje. Situata faktike.

40. AP ka ndjekur me vëmendje zbatimin e nenit 7 të Konventës CEDAW, në lidhje me eliminimin e diskriminimit të gruas në jetën politike dhe publike.

AP thekson se, pavarësisht rritjes së pjesëmarrjes së grave në politikë dhe vendimmarrje si rezultat i kuotave gjinore, nuk është përmbushur përfaqësimi gjinor i parashikuar në ligj jo më pak se 30 %. Institucioni i AP ka shprehur shqetësimin në lidhje me moszbatimin e kuotës gjinore nga partitë politike. AP në zgjedhjet e 2013, u ka bërë apel partive politike para mbylljes së listave të kandidatëve në zgjedhje të zbatojnë kuotën 30 % të pjesëmarrjes së grave në listat e kandidatëve për deputete[19]." Për të përmbushur këtë kuotë, shumë parti vendosën gra në vendet e fundit të listës, në pozicione ku nuk mund të fitonin..... Megjithëse KQZ-ja u dha partive një mundësi të korrigjonin shkeljet në lidhje me kuotën gjinore, ato nuk e bënë këtë. Listat që nuk përputheshin me kërkesat u regjistruan dhe pastaj KQZ-ja vendosi gjoba për partitë[20]". Sanksionet me gjobë të parashikuara në Kodin zgjedhor kanë rezultuar të dobëta dhe nuk kanë arritur qëllimin e tyre. Ky shqetësim i moszbatimit të kuotës gjinore nga partitë politike është ngritur edhe nga Departamenti Amerikan i Shtetit, në raportin për të drejtat e njeriut për vitin

16 Neni 175 i Kodit zgjedhor, "Sanksionet në lidhje me barazinë gjinore", ndryshuar me Ligjin nr. 74/2012.

17 Kodi zgjedhor, neni 164, "Ndërprerja e mandatit dhe zëvendësimi i vakancës".

18 neni 9, "Pjesëmarrja në politikë".

19 www.gazetaidea.com 3 Maj 2013.

20 OSCE, "Zgjedhjet parlamentare", 23 qershor 2013, Misioni i OSBE/ODIHR-it për vëzhgimin e vgjedhjeve, raporti përfundimtar. Ky raport është i vlefshëm në http://www.osce.org/sq/odihr/elections/

2013, që konstaton se Kodi zgjedhor nuk u zbatua nga të gjitha partitë dhe gjobat për moszbatim ishin të ulëta. [21]

41. Ndarja e funksioneve ministrore nga ato ligjvënëse, e për pasojë lënia e mandatit të deputetit nga ministrat e qeverisë aktuale ka mundësuar zëvendësimin e tyre me kandidate gra, si gjinia më pak e përfaqësuar, duke rritur numrin e grave deputete në Kuvendin e RSH-së.

42. Edhe pse Kodi zgjedhor parashikoi si sanksionin plotësues zëvendësimin e çdo vakance në listën e subjektit, në zonën zgjedhore ku është konstatuar shkelja e kriterit të gjinisë me kandidatët vijues në listë nga gjinia më pak e përfaqësuar nuk u arrit qëllimi i kërkuar. Pas zëvendësimeve të bëra nga KQZ, si pasojë e dorëheqjeve nga mandati i deputetit, në përbërjen e Kuvendit numri i deputeteve femra aktualisht është 29 ose 20.71 %....Nga 20 ndërprerjet e mandateve dhe zëvendësimet e vakancave të kërkuara nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë (gjatë vitit 2013-2014), numri i deputeteve femra u rrit vetëm 4. Kjo dhe për faktin se KQZ në 6 raste, edhe pse subjektet garuese në zgjedhje kishin marrë sanksion administrativ me gjobë, nuk ariti të zbatonte sanksionin plotësues të parashikuar nga neni 175, pika 2 e Kodit zgjedhor, për shkak të shterimit të kandidateve femra nga listat shumëemërore. Në këto raste, mandati i kalonte kandidatit mashkull të listës shumëemërore[22].

43. Jo më shumë se 27 % e përfaqësuesve në komisionet parlamentare janë femra. Kryetarë të komisioneve parlamentare për vitin 2013 kanë qenë 63 % meshkuj dhe 37 % femra. Kryetarët e grupeve parlamentare në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë janë të gjithë meshkuj[23].

44. Në nivel vendor pas zgjedhjeve të vitit 2011 situata u paraqit e tillë: nga 65 Bashki – 3 ishin gra kryetare bashkie ose 7,7% ( Burrel, Konispol, Patos); nga 11 minibashkitë e Tiranës -2 ishin kryetare ose 18 % (njësia 1 dhe 5); anëtare të këshillave bashkiake 13,8%; 2 kryetare komunash nga 309, 0,6% dhe 1 kryetare qarku nga 12[24].

45. Ndonëse e drejta aktive dhe pasive e votimit është një e drejtë që garantohet de jure për çdo shtetas shqiptar, pa dallim gratë përballen me vështirësi në gëzimin de fakto të kësaj të drejte. AP ka ngritur shqetësimin se dukuria e gjakmarrjes pengon ushtrimin e të drejtës kushtetuese të votës nga shtetasit, ndër të cilët edhe nga gratë.[25]

46. Ankesa për shkelje të së drejtës për të votuar janë paraqitur pranë KMD nga persona me aftësi të kufizuara ose OJF që punojnë në këtë fushë, duke ngritur shqetësimin e mungesës së përshtatjes së mjediseve të qendrave të votimit për të ushtruar të drejtën e votës. KMD ka konstatuar diskriminim të drejtpërdrejtë nga njësitë vendore dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka rekomanduar zbatimin e kritereve për përshtatjen e qendrave të votimit dhe vendosjen e tyre në katet e para të godinave, për personat me aftësi të kufizuar[26].

47. Edhe gratë rome përballen me vështirësi në gëzimin e të drejtës së tyre aktive dhe pasive të votimit. Kërkesat për dokumente regjistrimi dhe mungesa e identifikimit në popullsinë rome vështirësoi pjesëmarrjen e romëve në zgjedhjet e 23

21 http://albanian.tirana.usembassy.gov/latest-embassy-news/2014---deklarata/raporti-pr-t-drejtat-e-njeriut-pr-vitin-2013-26-shkurt-2014.html

22 KQZ, Raport për veprimtarinë e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, 1 janar-31 dhjetor 2014, i vlefshëm në: http://www2.cec.org.al/Portals/0/Images/CEC/Legjislacioni_2015/VENDIME_2015/VENDIM_29/KQZRaporti%20per%20Kuvend%20%202014.pdf

23 INSTAT, Femra dhe Meshkuj 2014.http://www.instat.gov.al/media/257796/femra_dhe_meshkuj_2014_.pdf, fq. 90.

24 http://www.sociale.gov.al/files/documents_files/Raporti_Final_Pekin+20_dt_30.04.2014.pdf

25 AP, "Mbi fenomenin e gjakmarrjes", 2013, fq. 7. Ky raport është diskutuar në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë. http://www.parlament.al/web/pub/2013_raporti_per_gjakmarrjen_15419_1.pdf

26 Vendimi nr. 100, datë 14.10.2013, http://kmd.al/skedaret/1383048306-Vendim%20Nr%20100.pdf; Vendimi nr.101, datë 18.10.2013,http://www.kmd.al/skedaret/1383048378-Vendim%20Nr%20101.pdf

qershorit[27]...... Nuk pati romë të zgjedhur në parlament apo në pozicione ministrash e zëvendësministrash[28].

48. Ligji "Për barazinë gjinore në shoqëri" (2008)[29] parashikon një kuotë përfaqësimi jo më pak se 30% nga secila gjini në të gjitha organet e pushtetit legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor dhe në institucionet e tjera publike. Janë shënuar disa hapa në respektimin e kuotës gjinore për organet e emëruara. Rritja e numrit të grave ministre 7/20 përben një hap të rëndësishëm në përfaqësimin gjinor.

49. AP ka bashkëpunuar me OJF-të dhe koalicionet e tyre duke mbështetur ose duke u bërë pjesë e iniciativave, me qëllim rritjen e pjesëmarrjes së grave/vajzave në politikë dhe vendimmarrje.

50. AP vlerëson iniciativën e aleancës së grave deputete të Parlamentit të Shqipërisë, për ndryshimin e Kodit zgjedhor me qëllim përmirësimin e përfaqësimit të gruas në politikë. Kjo aleancë është ndërpartiake dhe ka luajtur rol aktiv në promovimin e çështjeve të barazisë gjinore.

*Përfaqësimi në jetën publike dhe në nivel diplomatik/ndërkombëtar:*

51. Pavarësisht përqindjes në rritje të grave në FARSH, Policinë e Shtetit, drejtësi etj diferencat gjinore në përfaqësim vazhdojnë të jenë prezente. Është evidente se gratë janë të nënpërfaqësuara në shërbimet diplomatike. Në lidhje me pjesëmarrjen e grave në misionet diplomatike, për vitin 2013, në pozicionin "Ambasadorë" rezultojnë 83% meshkuj dhe 17 % femra.[30] Pjesëmarrja e grave në aktivitete ndërkombëtare ka shënuar rritje, por ende rezultojnë diferenca gjinore. Diferencat gjinore në lidhje me përfaqësimin në arenën ndërkombëtare lidhen edhe me pjesëmarrjen e ulët të grave në vendimmarrje.

## 3. Rekomandime.

*Në lidhje me kuadrin ligjor:*

52. Rekomandohet miratimi i ndryshimeve në Kodin zgjedhor me synim garantimin e një balance të vërtetë gjinore, prej 50 % burra dhe 50 % gra në përbërjen e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, me synimin që në zgjedhjet e ardhshme të ketë një numër jo më pak se 70 gra deputete. Kjo kuotë prej 50 % do të rriste rezultatin e synuar, rritjen e pjesëmarrjes së grave në politikë.

    Rekomandohet forcimi i sanksioneve në Kodin zgjedhor duke parashikuar refuzimin e listës së partive politike në rastet kur nuk zbatohet kuota gjinore për zgjedhjet për Kuvendin. Rekomandimi (nr. 201500100, mars 2015) iu dërgua drejtuesve të grupeve parlamentare në Kuvendin e Shqipërisë.

53. Të merren masa ligjore dhe të tjera që synojnë të garantojnë rritjen e numrit të grave, kryetare bashkie, duke krijuar akses të barabartë të grave dhe burrave për përfaqësimin në organet e qeverisjes vendore.

*Në lidhje me zbatimin e legjislacionit dhe rolin e shoqërisë civile:*

54. Rekomandohet zbatimi nga subjektet zgjedhore i kuotës gjinore për përbërjen e Kuvendit dhe zbatimi i sanksioneve nga KQZ në rast të moszbatimit të këtij detyrimi ligjor.

55. Njësitë e qeverisjes vendore dhe KQZ rekomandohet të marrin masat e nevojshme që lidhen me sigurimin e personelit, pajisjeve, etj. me qëllim garantimin e të drejtës së votës për personat që nuk mund të votojnë vetë, heqjen e barrierave për ushtrimin e të drejtës së votimit për përfaqësuesit e minoritetit rom dhe grupe të tjera të margjinalizuara.

---

27 Raporti mbi të Drejtat e Njeriut, 2013. http://albanian.tirana.usembassy.gov/latest-embassy-news/2014---deklarata/raporti-pr-t-drejtat-e-njeriut-pr-vitin-2013-26-shkurt-2014.html

28 Raporti mbi të Drejtat e Njeriut, 2013. http://albanian.tirana.usembassy.gov/latest-embassy-news/2014---deklarata/raporti-pr-t-drejtat-e-njeriut-pr-vitin-2013-26-shkurt-2014.html

29 Ligji nr.9970, datë 24.07.2008, "Për barazinë gjinore në shoqëri".

30 INSTAT, Femra dhe meshkuj 2014. http://www.instat.gov.al/media/257796/femra_dhe_meshkuj_2014_.pdf, fq. 93.

56. Rekomandohet forcimi i punës së shoqërisë civile dhe aktorëve të tjerë me qëllim që gratë të jenë të interesuara të përfshihen në listat zgjedhore si edhe të rriten kapacitetet e tyre përmes trajnimeve, me qëllim që kuota gjinore të mos përbëjë vetëm numra, por në të njëjtën kohë cilësi.

## 4. Masat e veçanta të përkohshme. Neni 4 i Konventës CEDAW.

57. AP vlerëson marrjen e masave të veçanta të përkohshme në fushën e pjesëmarrjes në politikë dhe vendimmarrje, punësimit, formimit profesional, strehimit, shërbimeve shoqërore, arsimit etj., gjatë periudhës së raportimit, të cilat janë prezantuar edhe në raportin shtetëror mbi zbatimin e konventës CEDAW. Ligji "Për barazinë gjinore në shoqëri"(2008). Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 143/12.3.2014 "Për procedurat e rekrutimit, përzgjedhjes, periudhës së provës, lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, të ulët, të mesme drejtuese" dhe ligje e akte të tjera nënligjore prezantojnë masa të veçanta të përkohshme në fusha të ndryshme.

58. Pavarësisht masave të veçanta të përkohshme të ndërmarra, mungojnë monitorime dhe vlerësime të vazhdueshme mbi efektin e tyre në lidhje me pjesëmarrjen e grave në politikë dhe vendimmarrje ose në fusha të tjera si punësimi, arsimi etj.

## 5. Rekomandime.

59. Rekomandohet marrja e masave të veçanta të përkohshme në të gjitha fushat dhe monitorimi i vazhdueshëm i efekteve që kanë sjellë këto masa mbi gratë dhe vajzat në fushën e pjesëmarrjes në politikë dhe vendimmarrje, punësimit, formimit profesional, arsimit, shërbimeve sociale, ndihmës ekonomike, ndihmës juridike, etj. Autoritetet përgjegjëse si KQZ, MMSR, Ministria e Drejtësisë, MAS, etj., rekomandohet të kryejnë studimin e efekteve të masave të veçanta të përkohshme mbi gratë.

# B. AKSESI I GRAVE NË SISTEMIN E DREJTËSISË[31]

Neni 2 i Konventës CEDAW, paragrafët 14, 15 dhe 27 të vërejtjeve përmbyllëse të Komitetit mbi Eliminimin e Diskriminimit të Grave.

Duke vlerësuar hapat e ndërmarrë në lidhje me përmirësimin e legjislacionit të barazisë gjinore dhe mosdiskriminimit, të raportuara nga shteti shqiptar në zbatim të nenit 2 të Konventës CEDAW, tërheqim vëmendjen se raporti duhet të theksonte edhe më qartë sigurimin e zbatimit praktik të parimit të barazisë së burrave dhe të grave dhe mbrojtjen efektive të grave nga çdo veprim diskriminues. Kjo lidhet edhe me mungesën e një monitorimi të plotë të ndikimit të legjislacionit të BGJ-së dhe antidiskriminimit, çka është pranuar edhe në raportin shtetëror[32].

## 1. Aspekte të situatës ligjore dhe faktike mbi aksesin e grave në sistemin e drejtësisë dhe mbrojtjen nga diskriminimi.

60. Institucioni i AP vlerëson iniciativat e ndërmarra në lidhje me përmirësimin e kuadrit ligjor mbi aksesin e grave në sistemin e drejtësisë dhe mbrojtjen nga diskriminimi.

### 1.1. E drejta e grave për të kërkuar dëmshpërblim për veprimet e diskriminimit për shkaqe gjinore.

61. Ligji "Për mbrojtjen nga diskriminimi" (2010), e përfshin gjininë si një prej terreneve të mbrojtura. Ligj parashikon të drejtën e një personi, grupi personash

31 Analiza e çështjes është referuar edhe në nenin 15 të Konventës CEDAW dhe paragrafët 14, 15 dhe 27 të VP të Komitetit CEDAW.

32 Raporti i katërt periodik kombëtar mbi zbatimin e Konventës "Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit të grave", miratuar me VKM nr. 806, datë 26.11.2014. Fletorja zyrtare e RSH nr.187/2014, fq.10177. http://tbinternet.ohchr.org/Treaties/CEDAW/Shared%20Documents/ALB/CEDAW_C_ALB_4_7078_E.pdf , pg.11.

që pretendojnë se janë diskriminuar ose një organizate me interesa legjitimë që pretendon diskriminimin në emër të një personi apo grupi personash, të paraqesë ankesë pranë institucionit të KMD dhe/ose ndjekjen e procedurave përpara gjykatës. Nëse gjykata vendos se ka shkelje të ligjit cakton dëmshpërblim si edhe afatin kohor për kryerjen e zhdëmtimit.

62. Instituti i "barrës së përmbysur të provës" është një institut mjaft i rëndësishëm në lidhje me procesin e të provuarit në çështjet me këtë objekt. Legjislacioni shqiptar nuk është në përputhje të plotë me standardet ndërkombëtare në lidhje me këtë institut. Institucioni i Avokatit të Popullit ka konsideruar rishikimin e dispozitave mbi barrën e provës si të rëndësishme për të siguruar barazinë midis palëve, siç edhe shprehet në rekomandimin e përgjithshëm të Komitetit CEDAW nr.33, mbi aksesin e grave në drejtësi.

63. Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi është më së shumti në përputhje me acquis të BE-së, megjithatë, zbatimi i tij është i pamjaftueshëm dhe duhet të ndërtohet një jurisprudencë solide anti-diskriminim[33].

### 1.2. Këshillimi dhe ndihma ligjore për gratë, në mënyrë të veçantë për gratë në paaftësi paguese dhe të margjinalizuara.

Garantimi i aksesit në drejtësi të grupeve vulnerable, ndër të tjera grave dhe vajzave në nevojë, si edhe zbatimi efektiv i vendimeve gjyqësore të formës së prerë ka përbërë një nga drejtimet e punës së institucionit të AP, në përputhje me rekomandimin 7 të BE për Shqipërinë, "Reforma në gjyqësor"[34].

*Kuadri ligjor në lidhje me ndihmën juridike. Roli i AP në përmirësimin e ligjit "Për ndihmën juridike", i ndryshuar. (2008):*

64. Miratimi i Ligjit "Për ndihmën juridike" (2008) përbën një zhvillim të rëndësishëm në kuadrin ligjor, në lidhje me garantimin e të drejtës për mbrojtjen ligjore falas.

AP vlerëson mundësitë që ofron Ligji nr. 10039, datë 22.12.2008, "Për ndihmën juridike" dhe aktet nënligjore të miratuara për aksesin e grave në sistemin e drejtësisë.

Periudha 2010-2014 është karakterizuar nga zhvillime në drejtim të miratimit të akteve nënligjore, në zbatim të Ligjit nr. 10039, datë 22.12.2008, "Për ndihmën juridike". Me Ligjin nr. 143/2013, "Për disa shtesa në Ligjin nr. 10 039, datë 22.12.2008, "Për ndihmën juridike", zgjerohet rrethi i përfituesve duke përcaktuar si persona që kanë të drejtë të përfitojnë ndihmë juridike, personat që: "c) kanë nevojë të mbrojnë të drejtat e tyre nëpërmjet paraqitjes së kërkesëpadisë, por nuk kanë mjete të mjaftueshme për të paguar taksën mbi aktet si dhe shpenzimet e nevojshme për njoftimet ose shërbimet e tjera gjyqësore. Në këtë rast, që personi ta përfitojë ndihmën juridike, duhet të vërtetojë se: i) përfshihet në programet e mbrojtjes sociale ose plotëson kushtet për t'u përfshirë në to; ose ii) është viktimë e dhunës në familje ose viktimë e trafikimit të qenieve njerëzore, për çështjet gjyqësore që lidhen me to[35].

Së pari, ky parashikim sjell efekte tek gratë, sepse janë gratë ato që në përqindjen më të lartë të rasteve përballen me dhunë në familje dhe trafikimin e qenieve njerëzore.

Së dyti, nga studime të organizatave jofitimprurëse vlerësohet se taksat dhe tarifat gjyqësore kanë përbërë dhe vazhdojnë të përbëjnë një barrierë për gratë e margjinalizuara në lidhje me përdorimin e mjeteve ligjore dhe gëzimin e të drejtave. Ky ligj në ndihmën juridike përfshin edhe përjashtimin e individit nga pagimi i taksës mbi aktet, si dhe të shpenzimeve të nevojshme për njoftimet ose shërbimet e tjera gjyqësore në proceset gjyqësore

33 http://www.integrimi.gov.al/al/dokumenta/progres-raporte/progres-raporti-2014&page1

34 AP, Raport, "Për zbatimin e masave të parashikuara në rekomandimet 6, 7, 10, 11 dhe 12 të BE për Shqipërinë, të cilat kanë lidhje me fushën e veprimtarisë së Avokatit të Popullit, si dhe aktiviteti i institucionit lidhur me këto rekomandime, gjatë periudhës janar-qershor 2012", Tiranë, Korrik 2012, fq. 5. http://www.avokatipopullit.gov.al/sites/default/files/ctools/Raport%20i%20vecante%20masat%20e%20BE.pdf

35 Avokati i Popullit ka paraqitur sugjerimet e tij drejtuar komisionit të ligjeve, për ndryshimet në ligjin nr. 10039, datë 22.12.2008, "Për ndihmën juridike", duke sugjeruar dhe përfshirjen e viktimave të trafikut dhe të dhunës në familje, si subjekte që përfitojnë ndihmë juridike.

civile dhe administrative[36]. Përjashtimi nga taksat përbën një parashikim me rëndësi për gratë, në mënyrë të veçantë gratë viktima të krimeve të dhunshme, për të kërkuar dëmshpërblimin nga autorët e veprave penale.

65. Ligji nr. 77/2014, "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 10 039, datë 22.12.2008, 'Për ndihmën juridike', të ndryshuar" përbën një tjetër hap në kuadrin e mundësive për të garantuar ndihmën juridike për qytetarët, ndër të cilët edhe gratë. Me shkresën nr. 197/1 datë 13.06.2014, "Dërgohen mendime dhe komente mbi projektligjin 'Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 10039, datë 22.12.2008 "Për ndihmën juridike", i ndryshuar, institucioni i AP ka paraqitur mendimet e tij pranë komisionit për çështjet ligjore, administratën publike dhe të drejtat e njeriut, në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë. Një pjesë e mendimeve dhe komenteve janë marrë në konsideratë dhe janë reflektuar në shtesat dhe ndryshimet që janë bërë në Ligjin nr. 10039, datë 22.12.2008, me Ligjin nr. 77/1014.

Kështu, është sugjeruar nga institucioni i AP përjashtimi i personave që përfshihen në programet e mbrojtjes shoqërore nga detyrimi i dorëzimit të dokumentacionit shoqërues, që përcaktohet me vendim nga KSHNJ. Për këtë kategori individësh, sigurimi i dokumentacionit shoqërues të bëhet në mënyrë institucionale nga vetë KSHNJ, me qëllim përjashtimin e individëve nga kostot financiare. Me Ligjin nr. 77/1014[37], personat, të cilët deklarojnë se përfshihen në programet e mbrojtjes shoqërore dhe të miturit janë përjashtuar nga detyrimi për paraqitjen e dokumentacionit shoqërues dhe është parashikuar detyrimi i KSHNJ të bashkëpunojë me institucionet përgjegjëse për të siguruar dokumentacionin e nevojshëm.

Gjithashtu, është sugjeruar nga institucioni i AP që të miturit të mund të trajtohen me ndihmë juridike jo vetëm kur i mituri është autor i veprës penale, por edhe kur ai është dëshmitar si dhe kur është viktimë nga vepra penale. Ky sugjerim është konsideruar dhe reflektuar në ndryshimet e Ligjit nr. 10039, datë 22.12.20087 "Për ndihmën juridike", me Ligjin nr. 77/2014[38], që parashikon të drejtën e të miturve, për të cilët mbrojtja në procedimin penal dhe në gjykim është e detyrueshme me ligj, si dhe të miturit e dëmtuar nga vepra penale, të përfitojnë ndihmë juridike në të gjitha fazat e procedimit, të parashikuara në Kodin e procedurës penale.

Institucioni i AP sugjeroi që në përcaktimin e individëve që përfitojnë ndihmë juridike të mbahen parasysh jo vetëm të ardhurat personale të kërkuesit, por edhe rrethana të tjera si, numri i anëtarëve që kërkuesi ka në përbërjen e tij/saj familjare, personat në ngarkim që mund të jenë të paaftë ose të mitur etj. Ky sugjerim u konsiderua dhe me ndryshimet e ligjit, neni 13, "Kriteret për përfitimin e ndihmës juridike". Pika 3 parashikon se "KSHNJ vlerëson plotësimin e kritereve të përfitimit të ndihmës juridike, të tilla si të ardhurat financiare të pamjaftueshme të personit dhe të personave që janë në ngarkim të tij/saj, përbërja familjare, statusi shoqëror, përfshirja në programet e mbrojtjes sociale ose plotësimi i kushteve për t'u përfshirë në to dhe çdo rrethanë tjetër që e vendos personin në kushte pamundësie për të siguruar privatisht ndihmë juridike."

Me Ligjin, nr. 77/2014, "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 10 039, datë 22.12.2008, "Për ndihmën juridike", të ndryshuar", neni 4, është zgjeruar rrethi i subjekteve që përfitojnë ndihmë juridike, duke përfshirë jo vetëm shtetasit shqiptarë me vendbanim në territorin e Republikës së Shqipërisë, shtetasit e huaj, personat pa shtetësi të pajisur me lejeqëndrimi, por edhe personat me shtetësi të huaj ose

36 Ligji nr. 143/2013, "Për disa shtesa në Ligjin nr. 10039, datë 22.12.2008, "Për ndihmën Juridike", neni 11.

37 Ligji nr. 77/2014, "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 10 039, datë 22.12.2008, 'Për ndihmën juridike', të ndryshuar", neni 16, "Paraqitja e kërkesës dhe dokumentacionit për përfitimin e ndihmës juridike".

38 Ligji nr. 77/2014, "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 10 039, datë 22.12.2008, 'Për ndihmën juridike', të ndryshuar", neni 13, "Kriteret për përfitimin e ndihmës juridike".

personat pa shtetësi që janë në procedurë aplikimi për lejeqëndrimi ose që janë në proces ankimi ose shqyrtimi gjyqësor për refuzimin e lejes së qëndrimit ose kërkimin e statusit të azilkërkuesit[39].

Ky ligj parashikon ofrimin e menjëhershëm të ndihmës juridike nga KSHNJ, në raste urgjente. Për këto raste parashikohet vërtetimi i plotësimit të kritereve në një moment të mëvonshëm[40].

66. AP vlerëson se parashikimi me Ligjin nr. 10329, datë 30.09.2010, "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006 "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", të ndryshuar, se kërkuesi shkarkohet nga të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifat për shpenzimet gjyqësore, si dhe ato të shërbimeve përmbarimore shtetërore do të rritë aksesin e viktimave të dhunës në familje në sistemin e drejtësisë, në mënyrë të veçantë grave, të cilat përballen në përqindjen më të lartë të rasteve me dhunë në familje.

67. AP ka kontribuar në vazhdimësi, përmes fuqisë së rekomandimeve, në reduktimin e tarifave gjyqësore. Kështu, AP ka shqyrtuar një ankesë të paraqitur nga Qendra për Nisma Ligjore Qytetare, që argumentonte se Udhëzimi nr. 991/3, datë 02.03.2010 "Për një ndryshim në Udhëzimin nr. 13, datë 12.02.2009, `Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për veprime dhe shërbime të administratës gjyqësore, Ministrisë së Drejtësisë, prokurorisë, noterisë dhe Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme" i ministrit të Drejtësisë dhe ministrit të Financave ndikonte drejtpërdrejtë në uljen e aksesit në sistemin e drejtësisë të qytetarëve, në mënyrë të veçantë grave dhe vajzave të varfra dhe të dhunuara, duke i dekurajuar ato në lidhje me përdorimin e mjeteve ligjore. AP, pas shqyrtimit të ankesës,[41] u ka drejtuar një rekomandim ministrit të financave dhe institucioneve të përfshira, duke rekomanduar të revokohet ky udhëzim dhe të parashikohet qartë termi "tarifë" dhe "taksë gjyqësore". Rezultat i këtyre përpjekjeve, por edhe i kontributit të aktorëve të tjerë, ishte reduktimi i tarifave gjyqësore me Udhëzimin e Përbashkët nr. 5668, datë 20.11.2013, "Për një ndryshim në Udhëzimin nr. 13, datë 12.2.2009, "Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për veprime e shërbime të administratës gjyqësore e Ministrisë së Drejtësisë, shërbimit përmbarimor shtetëror, prokurorisë, noterisë dhe Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme", të ndryshuar.

68. Është e rëndësishme të theksojmë se Gjykata Kushtetuese me Vendimin nr. 7, datë 27.2.2013[42], ka vlerësuar se gjyqtari i zakonshëm nuk pengohet të hetojë dhe të përjashtojë paditësin nga pagesa e tarifës gjyqësore, në rastet kur ndodhet përpara pamundësisë financiare të tij për të bërë këtë pagesë. GJK shprehet se kjo realizohet nga gjykata nëpërmjet shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur nga vetë qytetari/ja për të provuar paaftësinë e tij/saj paguese.

### 1.3. Situata de facto në lidhje me garantimin e të drejtës për ndihmë juridike.

69. Institucioni i AP, duke vlerësuar krijimin dhe funksionimin e KSHNJ, nëpërmjet Ligjit nr. 10039/2008 dhe akteve nënligjore që rregullojnë mënyrën e funksionimit të tij ngre shqetësimin se, ndonëse kanë kaluar disa vjet nga krijimi i këtij institucioni, numri i përfituesve të ndihmës juridike

39 Neni 11/1 i Ligjit nr. 10 039, datë 22.12.2008, "Për ndihmën juridike", të ndryshuar","Subjektet përfitues të ndihmës juridike".

40 Ligji nr. 77/2014, "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 10 039, datë 22.12.2008, 'Për ndihmën juridike', të ndryshuar", neni 16, "Paraqitja e kërkesës dhe dokumentacionit për përfitimin e ndihmës juridike".

41 Ankesa është shqyrtuar nga AP gjatë vitit 2010.

42 Objekti i çështjes është: "-Kontrolli i kushtetutshmërisë së nenit 11/2, të ligjit nr. 9975, datë 28.07.2008, "Për taksat kombëtare", i ndryshuar; -Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën, i Udhëzimit të ministrit të Financave dhe ministrit të Drejtësisë nr. 991/3, datë 02.03.2010, "Për një ndryshim në Udhëzimin nr. 13, datë 12.02.2009, "Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për veprime dhe shërbime të administratës gjyqësore, Ministrisë së Drejtësisë, prokurorisë, noterisë dhe Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme"; Interpretimi përfundimtar i nenit 155 të Kushtetutës në lidhje me zbatimin e Ligjit nr. 9975, datë 28.07.2008 "Për taksat kombëtare", i ndryshuar, mbi bazën e parimit të aftësisë paguese", me kërkues Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Qendra për Nisma Ligjore Qytetare.

është i pakët. Shumë nga këto shërbime të ndihmës juridike ofrohen ende nga disa organizata të mbështetura nga donatorë[43]. Nga analiza e MD rezulton se për vitin 2011 kanë aplikuar 27 persona nga të cilët asnjë prej tyre nuk ka plotësuar kriteret për përfitimin e ndihmës juridike; për vitin 2012 kanë aplikuar 62 persona nga të cilët kanë përfituar 45 persona dhe për vitin 2013 kanë aplikuar 171 persona nga të cilat kanë përfituar 85 persona[44].

Gratë kanë përfituar ndihmë parësore dhe dytësore për çështje që lidhen me pjesëtimin e pasurisë, konflikte në marrëdhëniet e punës, zgjidhje martese, vërtetim fakti, regjistrim fëmije, kujdestari, shpërblim dëmi, çështje penale etj[45].

70. Mungesa e ndërgjegjësimit mbi komisionin shtetëror dhe punën e tij vazhdon[46]. Niveli i informacionit të grave në lidhje me të drejtën e tyre për ndihmë juridike, KSHNJ, kushtet që duhet të plotësojnë për përfitimin e ndihmës juridike, etj., është i kufizuar. 22 gra gjatë vitit 2013 dhe 11 gra gjatë vitit 2014 kanë paraqitur kërkesë pranë AP për ndihmë juridike falas. Komiteti Shqiptar i Helsinkit në raportin mbi situatën e respektimit të të drejtave të njeriut në Shqipëri për vitin 2014 thekson se "Përsa i përket shërbimit ligjor falas, që duhet ofruar nga strukturat publike pranë Ministrisë së Drejtësisë, bazuar në Ligjin nr. 10039, datë 22.12.2008, "Mbi ndihmën juridike", i ndryshuar, konstatohet se shtetasit nuk kanë informacionin e nevojshëm dhe as besimin e duhur në këtë shërbim. Ky shërbim nuk funksionon si duhet që nga koha e krijimit, nuk është transparent për veprimtarinë që kryen dhe ende nuk ka buxhetin e mjaftueshëm në dispozicion, në raport me nevojat e shumta të shtetasve të varfër, për të ofruar shërbimin ligjor falas."[47].

71. Institucioni i AP ka shprehur shqetësimin se gjatë periudhës objekt raportimi, ndjekja e procedurave komplekse dhe mbledhja e dokumenteve të nevojshme ka pasur një kosto të caktuar në kohë dhe para, që i ka demotivuar gratë, në mënyrë të veçantë gratë nga grupe në nevojë, të aplikojnë për përfitimin e ndihmës juridike pranë KSHNJ, si në rastin e çështjeve civile, familjare ashtu edhe në ato penale, kur gratë janë viktima të krimeve të dhunshme. Kjo ka cenuar aksesin në drejtësi, por edhe vënien e të drejtës në vend për gratë e margjinalizuara. Nga praktika kanë rezultuar raste kur mospërmbushja e afatit për plotësimin e dokumentacionit ka përbërë shkak për ndërprerje të procedurës për shqyrtim të kërkesës për dhënien e ndihmës juridike falas[48].

72. AP vlerëson se, megjithë prioritetet e përcaktuara nga KSHNJ në lidhje me përfitimin e ndihmës juridike, numri i grave rome, egjiptiane, grave me aftësi të kufizuar, grave viktima të dhunës në marrëdhëniet familjare, grave të trafikuara, grave të përballura me diskriminim, si subjekte përfituese mbetet i kufizuar. Kështu, gjatë gjysmës së parë të vitit 2014 kanë përfituar ndihmë juridike nga komisioni shtetëror për ndihmën juridike vetëm 2 gra të dhunuara në marrëdhëniet familjare[49]. Kjo pranohet edhe në raportin e katërt periodik kombëtar[50] mbi zbatimin e Konventës CEDAW, duke shprehur qartë problemet në lidhje me aksesin në

43 Shkresa Nr. 197/1 date 13.06.2014 , "Dërgohen mendime dhe komente mbi projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 10039, datë 22.12.2008 "Për ndihmën juridike", i ndryshuar.

44 http://www.drejtesia.gov.al/files/userfiles/Analiza_e_sistemit_te_drejtesise_FINAL/Analiza_e_sistemit_te_drejtesise_FINAL.pdf, fq. 84.

45 Ky informacion është siguruar nga anëtarja e Komisionit Shtetëror për Ndihmën Juridike, I.A.

46 http://www.ecoi.net/file_upload/1226_1390300219_com-instranet1.pdf, fq.16.

47 Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Raport mbi situatën e respektimit të të drejtave të njeriut në Shqipëri për vitin 2014. Tiranë, dhjetor 2014, fq. 28.

48 Nga intervista me shtetasen R.G., e cila pohon se mosplotësimi në kohë i dokumentacionit ka përbërë shkak për mosshqyrtimin e kërkesës së saj për ndihmë juridike falas.

49 Raporti i Katërt Periodik i shtetit shqiptar mbi zbatimin e Konventës "Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit të grave", miratuar me VKM nr. 806, datë 26.11.2014. Fletorja zyrtare e RSH nr. 187/2014, fq. 10184.

50 Raporti i katërt periodik kombëtar mbi zbatimin e Konventës "Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit të grave", miratuar me VKM nr. 806, datë 26.11.2014. Fletorja zyrtare e RSH, nr. 187/2014, fq. 10184. (4 raste/ 2013; 2 raste për gjashtëmujorin e I-rë 2014 -një shtetase shqiptare, një e huaj)

ndihmën juridike. Në raportin shtetëror mungojnë të dhëna mbi numrin e grave përfituese të ndihmës juridike nga KSHNJ si edhe të dhëna në lidhje me numrin e përfituesevë nga gratë rome dhe egjiptiane, me aftësi të kufizuara, gra të trafikuara, etj. Analizat vjetore të Ministrisë së Drejtësisë nuk sigurojnë të dhëna mbi përfituesit e ndihmës ligjore të ndara sipas gjinisë, përkatësisë në një minoritet, formave të dhunës me bazë gjinore, AK, etj.

73. Duhet theksuar se ndonëse Ligji nr. 10329, datë 30.09.2010, "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006 "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", të ndryshuar' parashikon detyrimin e Dhomës Kombëtare të Avokatisë dhe KSHNJ t`u njoftojnë gjykatave listën e avokatëve që janë të autorizuar për ofrimin e ndihmës juridike falas, kjo listë nuk është vënë në dispozicion të të gjitha gjykatave të rretheve gjyqësore, duke sjellë efekte negative në mënyrë të veçantë mbi gratë, të cilat rezultojnë si anëtarët më të dhunuar në familje.

74. Pavarësisht kritereve të vlerësimit të përcaktuara në vendimin e KSHNJ "Për kriteret e vlerësimit, format dhe standardet e kontrollit të cilësisë në ofrimin e ndihmës juridike" ende nuk është krijuar një praktikë e konsoliduar e vlerësimit në vazhdimësi të shërbimit dhe standardeve që ai ofron. Burimet njerëzore dhe financiare për këtë qëllim janë të pamjaftueshme.

75. Mungesa e klinikave vendore dhe ofrimit të shërbimeve prej tyre ka sjellë efekte në aksesin e grave nga qarqe të ndryshme në sistemin e drejtësisë. Zyrat rajonale të AP pohojnë se objekt i ankesave të qytetarëve janë edhe ato që lidhen me përfitimin e ndihmës juridike falas[51]. Këshilli i Ministrave ende nuk ka marrë masat për krijimin e infrastrukturës së nevojshme për ushtrimin normal të veprimtarisë së klinikave ligjore vendore, duke përfshirë edhe planifikimin e fondeve të nevojshme buxhetore, në buxhetin e shtetit për funksionimin e tyre.

76. Transparenca e veprimtarisë se komisionit shtetëror të ndihmës juridike lidhur me vendimmarrjen për subjektet që u miratohet dhënia e ndihmës ose jo, fondet e akorduara nga buxheti i shtetit për ofrimin e ndihmës juridike, kontratat e lidhura me avokatët dhe organizatat jofitimprurëse që do të ofrojnë shërbimin nuk është në nivelin e duhur[52]. Mungojnë raporte të plota dhe sistematike mbi veprimtarinë e KSHNJ, nga të cilat të rezultojë numri i aplikuesve për ndihmë juridike që nga hyrja në fuqi e Ligjit për ndihmën juridike (2008), numrin e përfituesve, numrin e përfituesve sipas gjinisë, rezultate të monitorimit të cilësisë së ndihmës juridike, etj. Ky institucion nuk ka një website të vlefshëm në të cilin të bëhet publik aktiviteti i tij dhe i aksesueshëm nga qytetarët, përfshirë gratë.

77. Aktualisht, nuk mundësohet de facto zgjedhja nga qytetarët, përfshirë gratë, e avokatit që do të ofrojë ndihmë juridike.

78. KSHNJ, si institucion i parashikuar nga Ligji "Për ndihmën juridike" (2008), ka autoritetin të lidhë kontrata bashkëpunimi me organizatat jofitimprurëse të specializuara në fushën e dhënies së ndihmës juridike. Është e nevojshme të forcohet ky bashkëpunim me qëllim rritjen e numrit të përfitueseve gra. Ofrimi i shërbimeve ligjore edhe nëpërmjet kontraktimit të OJF-ve të specializuara në këtë fushë do të siguronte ofrimin e shërbimeve cilësore nga avokatë të mirëtrajnuar të këtyre OJF-ve dhe të ndjeshëm ndaj çështjeve gjinore.

79. AP ka lidhur një marrëveshje

51 Intervista me përfaqësuesin e zyrës rajonale Pogradec, Egli Rustemi, botuar në "Avokati i Popullit", botim periodik i institucionit të Avokatit të Popullit, nr. 1, nëntor 2014, fq. 23.

52 Mungesa e transparencës së KSHNJ është një nga problematikat e konstatuara nga AP në raportin, "Për zbatimin e masave të parashikuara në rekomandimet 6, 7, 10, 11 dhe 12 të BE për Shqipërinë, të cilat kanë lidhje me fushën e veprimtarisë së Avokatit të Popullit, si dhe aktiviteti i institucionit lidhur me këto rekomandime, gjatë periudhës janar-qershor 2012", Tiranë, korrik 2012, fq. 6.

bashkëpunimi[53] me komisionin shtetëror të ndihmës juridike në muajin qershor 2012, në të cilën është përcaktuar angazhimi i komisionit shtetëror të ndihmës juridike për të vlerësuar dhe trajtuar sipas procedurave ligjore dhe nënligjore rastet e referuara nga AP, me qëllim ofrimin e ndihmës juridike parësore dhe dytësore, grupeve vulnerable, të cilat plotësojnë kriteret e parashikuara në ligj. Por numri i përfituesve nga rastet e referuara ka qenë i vogël. Në rastin e viktimave të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe trafikimit të qenieve njerëzore AP ka referuar rastet edhe në OJF-të që ofrojnë shërbime për këto target-grupe.

80. Në lidhje me tarifat gjyqësore edhe raport-progresi për Shqipërinë 2014 thekson se "Tarifat gjyqësore frenojnë shumë qytetarë dhe procedurat e aplikimit janë shumë të ngadalta. Vazhdon të jepet ndihmë juridike falas, kryesisht nga organizatat joqeveritare me financim të donatorëve[54]".

81. Komisioneri për të drejtat e njeriut i Këshillit të Evropës Nils Muiznieks, gjatë vizitës së tij në Shqipëri nga data 23-27 shtator 2013 ka rekomanduar që gjyqtarët të pajisen me një udhëzim të qartë që do t`i ndihmonte ata në zbatimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese për përjashtimin nga taksat gjyqësore.[55]

### 1.4. Rekomandime.

*Ndihma juridike:*

82. Rekomandohet rritja e efektivitetit në funksionimin e komisionit shtetëror të ndihmës juridike, me synim rritjen e numrit të rasteve që u ofrohet ndihma juridike parësore apo dytësore[56]. Edhe raport-progresi 2014 për Shqipërinë rekomandon: "Përsa i përket aksesit në drejtësi, duhet të përmirësohet funksionimi i komisionit shtetëror për ndihmën juridike dhe të zbatohen dispozitat e miratuara rishtas për ndihmën juridike, që parashikojnë ngritjen e zyrave vendore për ndihmën juridike[57]".

83. Ngritja dhe funksionimi i klinikave ligjore vendore do të kontribuonte ndjeshëm përmes asistencës në përgatitjen e kërkesës për ndihmë juridike dhe sigurimit të dokumentacionit të nevojshëm[58]. Kjo kërkon miratimin pa vonesë të akteve mbi strukturën e klinikave ligjore vendore dhe buxhetin që nevojitet për mirëfunksionimin e tyre. Kjo do të sillte një mbështetje më të mirë të nevojave të grave, në një shpërndarje më të mirë gjeografike, duke rritur efektivitetin e zbatimit të ligjit.

84. Rekomandohet që KSHNJ të orientohet nga kontraktimi i organizatave jofitimprurëse, që ofrojnë shërbime ligjore falas, në vend të mbështetjes së rasteve individuale, të viktimave të trafikimit, viktimave të dhunës në familje, grave me AK, grave rome dhe egjiptiane dhe grave të grupeve të ndryshme të margjinalizuara. Kjo do të sjellë rritjen e numrit të përfituesve dhe ofrimin cilësor të shërbimeve nga avokatë të trajnuar në vazhdimësi, në lidhje me këto çështje.

85. Rekomandohet të forcohet puna e KSHNJ për trajtimin si raste me përparësi të grave rome, grave me aftësi të kufizuara, grave të

53 Gjatë vitit 2012, në institucionin e AP janë paraqitur gjithsej 55 ankesa dhe kërkesa për përfaqësim ligjor, pasi ankuesit, përfshirë gratë pretendonin se nuk kishin mundësi për të marrë një avokat privat. Gjatë vitit 2013, janë paraqitur 39 kërkesa për ndihmë juridike falas, pranë institucionit të AP. Raportet vjetore të AP janë burimi i të dhënave.

54 http://www.integrimi.gov.al/al/dokumenta/progres-raporte/progres-raporti-2014&page1

55 http://www.ecoi.net/file_upload/1226_1390300219_com-instranet1.pdf, p.17.

56 Mungesa e efektivitetit në funksionimin e komisionit shtetëror për ndihmën juridike është një nga problematikat e konstatuara nga AP në raportin "Për zbatimin e masave të parashikuara në rekomandimet 6, 7, 10, 11 dhe 12 të BE për Shqipërinë, të cilat kanë lidhje me fushën e veprimtarisë së Avokatit të Popullit, si dhe aktiviteti i institucionit lidhur me këto rekomandime, gjatë periudhës janar-qershor 2012", Tiranë, Korrik 2012, fq. 6. http://www.avokatipopullit.gov.al/sites/default/files/ctools/Raport%20i%20vecante%20masat%20e%20BE.pdf

57 http://www.integrimi.gov.al/al/dokumenta/progres-raporte/progres-raporti-2014&pageç1

58 Ligji nr. 143/2013, "Për disa shtesa në ligjin nr. 10039, datë 22.12.2008, "Për ndihmën juridike", neni 12/1, p. 2, "Klinikat ligjore vendore".

moshuara, grave nga komuniteti LBTI etj.

86. Rekomandohet monitorimi në vazhdimësi nga KSHNJ i cilësisë së ndihmës juridike të ofruar nga avokatët, apo organizatat jofitimprurëse, si një element shumë i rëndësishëm për garantimin dhe dhënien e drejtësisë qytetarëve, përfshirë gratë. Rekomandohet që kryesisht apo me kërkesë të ministrit të Drejtësisë KSHNJ të kontrollojë në mënyrë të vazhdueshme cilësinë e shërbimit ligjor falas të ofruar[59]. Forcimi i burimeve njerëzore dhe rritja e burimeve financiare është e rekomandueshme me qëllim kryerjen e këtij vlerësimi në mënyrë profesionale dhe sistematike.

87. Në lidhje me zbatimin e Ligjit "Për ndihmën juridike", i ndryshuar (2008), rekomandohet marrja e masave për zbatimin e Ligjit nr. 77/2014, "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 10039, datë 22.12.2008, "Për ndihmën juridike", të ndryshuar", me qëllim lehtësimin e procedurave dhe dokumentacionit, përmes mbështetjes nga KSHNJ në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse.

88. Rekomandohet rritja e transparencës së veprimtarisë së KSHNJ, në lidhje me numrin e aplikuesve për ndihmë juridike, numrin e përfituesve, numrin e përfituesve sipas gjinisë, përkatësisë në një minoritet, AK etj.

89. Rekomandohet krijimi i listave të hapura të avokatëve, me qëllim zgjedhjen nga vetë individi të avokatit që do t'i ofrojë ndihmën juridike, e cila do t`i nënshtrohet vendimmarrjes së komisionit. Në këtë mënyrë institucioni i AP mendon se do të shmanget subjektivizmi dhe qëndrimet abuzive në përzgjedhjen e ofruesve të ndihmës juridike[60].

90. Rekomandohet që MD, KSHNJ dhe DHKA të marrin masa me qëllim përmbushjen e detyrimit ligjor të pajisjes së gjykatave me listën e avokatëve që do të ofrojnë shërbim ligjor falas për viktimat e dhunës në familje, në procesin e lëshimit të UMM/UM.

91. Një website duhet të krijohet nga komisioni shtetëror për ndihmën juridike, me qëllim jo vetëm rritjen e transparencës së institucionit por gjithashtu rritjen e nivelit të njohurive të qytetarëve në nevojë për ndihmë ligjore falas, duke përfshirë gratë.

### 1.5. Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë.

Në kuadrin e procesit të rregullt ligjor, AP ka trajtuar edhe çështje të mosekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, brenda një afati ligjor të arsyeshëm dhe çështje të garantimit dhe zbatimit të procedurave të drejta gjatë procesit të hetimit dhe gjykimit. Kjo çështje është analizuar nga njëra anë e lidhur ngushtësisht me aksesin e grave në sistemin e drejtësisë dhe të drejtën e tyre për një gjykim të drejtë, por nga ana tjetër është e lidhur me garantimin e të drejtës së parashikuar në Konventën CEDAW për barazi në martesë dhe në jetën familjare.

92. E drejta për një proces të rregullt ligjor garantohet në nenin 42 të Kushtetutës së RSH-së dhe nenin 6/1 të KEDNJ-së. Edhe jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese të RSH-së dhe GJEDNJ shpreh qartë se ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë në një afat të arsyeshëm përbën pjesë integrale të nenit 6/1 të KEDNJ-së.

93. Me Ligjin nr. 155/2014, "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 8454, datë 4.2.1999, "Për Avokatin e Popullit", të ndryshuar, parashikohet se AP pranon ankesa, kërkesa ose njoftime për shkelje

59 AP, Raport, "Për zbatimin e masave të parashikuara në rekomandimet 6, 7, 10, 11 dhe 12 të BE për Shqipërinë, të cilat kanë lidhje me fushën e veprimtarisë së Avokatit të Popullit, si dhe aktiviteti i institucionit lidhur me këto rekomandime, gjatë periudhës janar-qershor 2012", Tiranë, korrik 2012, fq. 7. http://www.avokatipopullit.gov.al/sites/default/files/ctools/Raport%20i%20vecante%20masat%20e%20BE.pdf

60 AP, Raport, "Për zbatimin e masave të parashikuara në rekomandimet 6, 7, 10, 11 dhe 12 të BE për Shqipërinë, të cilat kanë lidhje me fushën e veprimtarisë së Avokatit të Popullit, si dhe aktiviteti i institucionit lidhur me këto rekomandime, gjatë periudhës janar-qershor 2012", Tiranë, korrik 2012, fq. 7. http://www.avokatipopullit.gov.al/sites/default/files/ctools/Raport%20i%20vecante%20masat%20e%20BE.pdf

të të drejtave të njeriut, që rrjedhin nga administrata e pushtetit gjyqësor dhe ekzekutimi i vendimeve gjyqësore.

*Situata faktike dhe efektiviteti institucional:*

94. Institucioni i AP vlerëson se situata e procesit të ekzekutimit të titujve ekzekutivë nuk është në nivelin që do të dëshironim. Numri i ankesave të paraqitura për shqyrtim pranë AP gjatë periudhës tetor 2013 – tetor 2014 arrin në 68, ku përfshihen edhe ankesa të paraqitura nga gratë. AP konstaton me shqetësim se numri i qytetarëve ku përfshihen dhe gratë, që paraqesin ankesa për të realizuar të drejtën e tyre të fituar gjyqësisht është në rritje. Ndër ankesat tërheq vëmendjen numri i grave që ankohen për mosekzekutim të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, në lidhje me çështjet me objekt rregullimin e pasojave të zgjidhjes së martesës, kthimin në punë, etj.

95. Përmes raporteve vjetore dhe raportit të veçantë, "Për situatën e krijuar nga mosekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë"[61], është ngritur shqetësimi i vazhdueshëm i institucionit të AP në lidhje me mosekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë sepse moszbatimi i titullit ekzekutiv për një kohë tepër të gjatë e shndërron në iluzion të drejtën e subjekteve ankuese për të pasur akses në gjykatë.

*1.5.1 Në lidhje me mosekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë me objekt rregullimin e pasojave të zgjidhjes së martesës:*

96. AP shpreh shqetësimin në lidhje me situatën problematike të mosekzekutimit të vendimeve gjyqësore, që lidhen me çështje të lënies së fëmijëve për rritje dhe edukim, të drejtën e takimit të fëmijëve dhe detyrimit ushqimor të prindit ndaj fëmijëve, pas zgjidhjes së martesës. Kjo çështje prek në mënyrë të veçantë gratë, sepse, në përqindjen më të lartë të rasteve, fëmijët i lihen nënës për rritje dhe edukim. Ish-bashkëshorti, të cilit nuk i janë lënë fëmijët për rritje dhe edukim, ka të drejtën e takimit të fëmijëve dhe detyrohet të paguajë detyrimin ushqimor për ta. Siç rezulton edhe nga monitorimi i vendimeve gjyqësore me objekt zgjidhjen e martesës dhe rregullimin e pasojave të saj, "Nëna është prindi që i lihen më së shumti fëmijët për përkujdesje pas zgjidhjes së martesës. Si e tillë, ajo është ushtruesja kryesore e përgjegjësisë prindërore. Për gjykatën e Tiranës, këtë e hasim në 87-88% të vendimeve të monitoruara për vitin 2011-2012; për GjRrGj Durrës në 90% të rasteve për vitin 2011 dhe në 82% të rasteve për 2012. Po kështu ndodh edhe për Vlorën e Shkodrën".[62] Ky shqetësim përbën objektin e një numri ankesash të paraqitura në institucionin e AP, për periudhën 2010-2014. Kështu, rezulton se për vitet 2010-2014 janë paraqitur 14 ankesa nga gratë për çështje të mosekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë që lidhen me të drejtën e takimit me fëmijët, 27 ankesa për mosekzekutim të vendimeve gjyqësore të formës së prerë që lidhen me detyrimin ushqimor për fëmijët, 5 ankesa për mosekzekutim të vendimeve gjyqësore të formës së prerë që lidhen me lënien e fëmijëve për rritje dhe edukim dhe 2 ankesa në lidhje me mosekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë që lidhen me detyrimin për dorëzimin e fëmijëve[63].

Nga ankesat e paraqitura pranë AP ka rezultuar se disa nga shkaqet e mosekzekutimit të vendimeve të formës së prerë me këtë objekt janë: "ish-bashkëshorti nuk rezulton të ketë pasuri që mund t`i sekuestrohet"[64], "është pezulluar ekzekutimi i vendimit nga Gjykata e Lartë", "aktet e paraqitura për ekzekutimin e vendimit pranë zyrës së përmbarimit nuk

61 AP, Raport i veçantë, "Për situatën e krijuar nga mosekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë", nr. 211, dt..27.07.2012, fq. 5. http://www.parlament.al/web/pub/2012_raporti_per_vendimet_gjyqesore_15413_1.pdf

62 Prof.dr.Arta Mandro (Balili) & Av.Aurela Bozo & Prof.dr.Aurela Anastasi, "Njohja dhe zbatimi i standardeve të barazisë gjinore në procesin gjyqësor", Raport mbi gjetjet kryesore nga monitorimi i vendimeve të gjykatave të shkallës së I-rë, të rretheve gjyqësore Tiranë, Durrës, Shkodër e Vlorë, 1 janar 2011-1 qershor 2012. fq. 13,Tiranë, dhjetor 2013.

63 Këto të dhëna janë mbledhur nga institucioni i AP, gjatë muajit nëntor 2014.

64 Ankesa F.T. (2013)

kanë qenë të plota”[65], ish-bashkëshorti, që detyrohet të paguajë pensionin ushqimor për fëmijët, është jashtë shtetit etj.

97. Mosekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë rezulton edhe nga të dhënat zyrtare për rastet e gjykuara në procesin penal, për veprën penale “Mosdhënie e mjeteve për jetesë”, (neni 125 i Kodit penal). Ka rezultuar nga Vjetari statistikor i Ministrisë së Drejtësisë për vitin 2011 se janë gjykuar 41 çështje penale me këtë objekt dhe janë dënuar 42 persona[66]. Duke iu referuar të njëjtit burim informacioni, në vitin 2012 rezultojnë 49 çështje me këtë objekt dhe 43 të dënuar, në vitin 2013 rezultojnë 89 çështje me këtë objekt dhe 45 të dënuar dhe 108 çështje në vitin 2014, për të cilat 44 persona janë dënuar. Këto të dhëna zyrtare tregojnë se numri i çështjeve penale me këtë objekt është në rritje. Është dënuar një femër për kryerjen e kësaj vepre penale gjatë vitit 2012, një femër për vitin 2013 dhe një tjetër në vitin 2014, duke treguar qartë se efektet e mosekzekutimit të vendimeve gjyqësore për detyrimin ushqimor për fëmijët rëndojnë sidomos mbi gratë.

98. Në veprimtarinë e AP, në periudhën e raportimit, janë shqyrtuar ankesa të paraqitura nga gratë edhe në lidhje me mosekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë për shkak të mos pagimit të shpenzimeve përmbarimore.

99. Aktiviteti i shërbimit përmbarimor shtetëror dhe privat në lidhje me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë lë për të dëshiruar. Nga ankesat e paraqitura pranë AP rezulton se ka vendime në lidhje me të drejtën e takimit ose detyrimit ushqimor për fëmijët, që nuk janë ekzekutuar nga shërbimi përmbarimor për një kohë të gjatë (2-3 vjet), pasi vendimi ka marrë formë të prerë[67], duke përbërë një cenim të gëzimit të së drejtës së fituar në rrugë gjyqësore.

*1.5.1.1. Rekomandime:*

100. Rekomandohet rritja e efektivitetit institucional të zyrave të shërbimit përmbarimor ashtu edhe e policisë dhe institucioneve të tjera përgjegjëse që kanë rol në ekzekutimin e vendimeve gjyqësore me objekt çështje që lidhen me lënien e fëmijëve për rritje dhe edukim, të drejtën e takimit dhe detyrimin ushqimor për fëmijët nga ish-bashkëshortët.

101. Rekomandohet marrja e masave pozitive nga shteti në lidhje me gëzimin de facto të të drejtave për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, që lidhen me ushtrimin e përgjegjësisë prindërore, në mënyrë të veçantë detyrimin ushqimor për fëmijët, lënien e fëmijëve për rritje dhe edukim dhe të drejtën e takimit të fëmijëve. Në lidhje me detyrimin ushqimor për fëmijët, “Nuk ka masa të tjera ekonomike pozitive. Ndërkohë, mund të ishte menduar nga shteti për politika punësimi të këtyre personave, me qëllim vjeljen e detyrimit ushqimor për fëmijët, ose politika kompensimi, ku shteti bëhet garant për detyrimin ushqimor ndaj fëmijës, kurse prindi detyrohet ta shlyejë atë në raport me shtetin, në një periudhë të mëvonshme”[68].

102. MD rekomandohet të përmbushë përgjegjësitë për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë në lidhje me detyrimin ushqimor ose të drejtën e takimit me fëmijët, kur prindërit debitorë jetojnë jashtë shtetit, në kuadrin e akteve ndërkombëtare në këtë fushë dhe marrëveshjeve me vendet e tjera.

*1.5.2 Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë, ku është vendosur detyrimi i institucioneve buxhetore të paguajnë detyrime në të holla ndaj subjekteve të ndryshme gjyqfituese:*

103. Situata ligjore dhe faktike. AP ka ngritur shqetësimin se “angazhimi i qeverisë për të përfunduar ekzekutimin e gjithë

65 Ankesa e D.N., në lidhje me të drejtën e takimit të fëmijëve. (2013)

66 Në këto statistika nuk janë veçuar rastet e mosekzekutimit të detyrimit ushqimor të prindit ndaj fëmijës, nga rastet e tjera të detyrimeve për ushqim.

67 Ankesa V.T. (2013) V.T. ankohet se vendimi në lidhje me detyrimin ushqimor për fëmijën nuk ekzekutohet prej tre vitesh.

68 Prof.dr.Av.Aurela Anastasi, “In margine al Sinodo 2014”, ‘Çështje të ekzekutimit te vendimeve gjyqësore për detyrimin ushqimor ndaj fëmijëve në rastet e shkurorëzimit (Rasti i Shqipërisë)’, Bari 2014, f. 44.

vendimeve gjyqësore të formës së prerë (titujve ekzekutivë) të dhëna në vite, ku është vendosur detyrimi i institucioneve buxhetore të paguajnë detyrime në të holla apo të kryejnë përmbushjen e një veprimi të caktuar ndaj subjekteve të ndryshme gjyqfituese, nuk është në nivelin e angazhimit të marrë".[69] Në rastet e mospërmbushjes së detyrimit të pagimit të detyrimeve në të holla përgjithësisht justifikimi ka qenë se nuk disponohen fonde dhe se shlyerja do të kryhet me këste, në referim të mundësive financiare si dhe përcaktimeve të Udhëzimit nr. 2, datë 18.08.2011, "Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të institucioneve buxhetore në llogari të thesarit" të Këshillit të Ministrave. Ky udhëzim përmbante përcaktime që nuk janë në përputhje me dispozitat ligjore të Kodit të procedurës civile mbi ekzekutimin e detyruar të titujve ekzekutivë dhe krijon mundësi për dështimin e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë brenda një afati të arësyeshëm. AP i rekomandoi Ministrisë së Drejtësisë me shkresën nr. Prot. K3/S8-6, datë 26.3.2012 dhe Ministrisë së Financave, duke vënë në dijeni Këshillin e Ministrave, përmes shkresës me nr. Prot. K3/S8-9, datë 28.8.2012, amendimin e Udhëzimit nr. 2, datë 18.08.2011, "Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të institucioneve buxhetore në llogari të thesarit"[70]. AP i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese për shfuqizimin e këtij udhëzimi si të papajtueshëm me Kushtetutën. GjK ka vendosur shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e RSH-së të shkronjës "d", të pikës 7, të këtij udhëzimi. Ky udhëzim është shfuqizuar tërësisht nga Këshilli i Ministrave me nxjerrjen e Udhëzimit nr. 1, datë 4.06.2014, "Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit". AP është i mendimit se Udhëzimi nr. 1, datë 4.06.2014 paraqet problematika, sepse nuk është në përputhje me disa dispozita ligjore që përcaktojnë veprimet përmbarimore në procesin e ekzekutimit të detyrueshëm të titujve ekzekutivë, me objekt detyrimin e institucioneve buxhetore të paguajnë shuma të caktuara në të holla.

104. AP ka shprehur shqetësimin se në periudhën objekt raportimi, në kundërshtim me detyrimin e vendosur nga gjykata apo Komisioni i Shërbimit Civil, në disa raste, titullarët e institucioneve buxhetore debitorë kanë mbajtur qëndrim të papranueshëm në përmbushje të detyrimit për pagimin e pagave në favor të gjyqfituesve, duke dorëzuar në favor të tyre shuma modeste mujore në masën 5000 deri 10.000 lekë. Kjo "zgjidhje" e dhënë prej tyre, përveçse është sa 1/10 apo 1/15 e detyrimit mujor të vendosur e vijues, sjell dëme për gjyqfituesen si dhe familjen e saj[71]. AP ka theksuar se mungesa e mjeteve financiare, të përdorura si një justifikim për mospërmbushjen e detyrimeve, është në kundërshtim me jurisprudencën e GJEDNJ e cila është shprehur: "Asnjë argument i përdorur nga administrata publike nuk mund të justifikojë mosekzekutimin e asaj të drejte që shtetasi e ka fituar në rrugë gjyqesore"[72]. Gratë, gjithashtu janë përballur me këtë situatë. AP ka rekomanduar përmes shqyrtimit të ankesave, "marrjen e masave për dorëzimin tërësisht të detyrimit financiar, si i vetmi veprim që duhet të kryhet në

69 Ky shqetësim është ngritur nga institucioni i AP në raportin e veçantë, "Për situatën e krijuar nga mosekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë", korrik 2012, fq. 6. (nr. 211, dt. 27.07.2012). http://www.parlament.al/web/pub/2012_raporti_per_vendimet_gjyqesore_15413_1.pdf

70 AP, Raport i veçantë, "Për situatën e krijuar nga mosekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë", korrik 2012, fq. 8. (nr.11, dt.27.07.2012) http://www.parlament.al/web/pub/2012_raporti_per_vendimet_gjyqesore_15413_1.pdf

71 AP, Raport i veçantë, "Për situatën e krijuar nga mosekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë", korrik 2012, fq. 8. (nr. 211, dt. 27.07.2012) http://www.parlament.al/web/pub/2012_raporti_per_vendimet_gjyqesore_15413_1.pdf

72 AP, Raport i veçantë, "Për situatën e krijuar nga mosekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë", korrik 2012, fq. 26. (nr.11, dt.27.07.2012) http://www.parlament.al/web/pub/2012_raporti_per_vendimet_gjyqesore_15413_1.pdf Referuar në jurisprudencën e GJEDNJ, Aplikimi nr.5426800, Qufaj & Co shpk k. Shqipërisë, datë 30.3.2005, "Asgjë, madje as edhe mungesa e fondeve nuk mund të justifikojë mosekzekutimin e një vendimi gjyqësor".

përmbushje të detyrimit të vendosur"[73].

105. Janë konstatuar raste të moskryerjes së veprimeve nga përmbaruesit gjyqësorë në lidhje me dënimin me gjobë të debitorit si dhe çdo personi të tretë, të cilët në procesin e ekzekutimit të vendimit kryejnë veprime të parregullta, nuk respektojnë afatet dhe nuk zbatojnë urdhrin e ekzekutimit.

106. Në rastin e institucioneve debitore që nuk ekzekutojnë vendimin e formës së prerë, edhe në ato raste kur titullarët e tyre janë penalizuar me gjoba, bazuar në nenin 606 të K.Pr.C, gjobat nuk janë vjelë, pasi gjykatat i kanë anuluar vendimet e përmbaruesve gjyqësorë.

107. Reagimi i disa institucioneve buxhetore ndaj rekomandimeve të AP ka qenë heshtje në lidhje me disa ankesa të paraqitura nga gratë me nr. 00901831, nr. 201001284, nr. 201101285, nr. 201100563, nr. 201100086 dhe nr. 201001682, etj.

*1.5.2.1. Rekomandime:*

108. Rekomandohet marrja e masave nga institucionet buxhetore debitore për dorëzimin tërësisht të detyrimeve financiare, në zbatim të vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Vendosja e masës së sekuestros mbi llogarinë e institucioneve buxhetore debitore si dhe vendosja e gjobave për titullarët e institucioneve debitore janë të rekomandueshme me qëllim gëzimin efektiv të të drejtave nga qytetarët, përfshirë gratë.

109. Rekomandohet zbatimi i vendimeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, sepse mosekzekutimi i tyre jo vetëm cenon gëzimin efektiv të të drejtave nga shtetasit, ndër të cilat edhe gratë, por edhe mund të shoqërohet me sanksione për shtetin shqiptar si shtet palë i KEDNJ.

*1.5.3 Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë në lidhje me detyrimin për rikthimin në detyrë të gjyqfituesve:*

110. Duhet të theksojmë se nga ankesat e paraqitura në institucionin e AP ka rezultuar se nuk janë respektuar detyrimet e përcaktuara në vendimet gjyqësore të formës së prerë për kthimin në vendin e mëparshëm të punës, në rastet e punëmarrëseve me status të nëpunësit civil, me pretendimin se organika është plotësuar apo suprimuar struktura. Ky qëndrim ka sjellë efekte negative edhe mbi gratë që përballen me një situatë të tillë. Gjykata Kushtetuese, në jurisprudencën e saj, është shprehur se i takon debitorit (organit të administratës publike) të gjej një mundësi zgjidhjeje sa më të përshtatshme për rastet, me qëllim vënien në vend të së drejtës së kreditorit.

111. Pavarësisht se Ligji nr. 152/3013, "Për nëpunësin civil" ka hyrë në fuqi në shkurt 2014, periudha deri në hyrjen në fuqi të tij me vendimin e Gjykatës Kushtetuese ka sjellë një sërë problemesh për ata që janë larguar ose emëruar nga shërbimi civil gjatë kësaj periudhe. Kjo evidentohet mjaft qartë edhe në vendimet gjyqësore të cilat nuk kanë një praktikë të unifikuar, sidomos gjatë kësaj periudhe "pauze" të ligjit për nëpunësin civil[74]. Nga ankesat ka rezultuar se vazhdon të mbetet problematike situata për personat, që kanë dalë në listëpritje përpara hyrjes në fuqi të ligjit "Për nëpunësin civil". Shumica e tyre janë bërë pjesë e shqyrtimeve gjyqësore dhe nga vendimet gjyqësore rezulton se gjykatat i kanë dhënë fuqi prapaveprue se vendimit të Gjykatës Kushtetuese për ligjin për nëpunësin civil, duke e konsideruar nxjerrjen në listat e pritjes si akt të pavlefshëm dhe kanë kërkuar kthimin në vendin e punës të këtyre punonjësve[75].

112. Puna e Ministrisë së Drejtësisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarimit Gjyqësor Shtetëror për drejtimin dhe

73 AP, Raport i veçantë, "Për situatën e krijuar nga mosekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë", korrik 2012, fq. 11. (nr. 211, dt. 27.07.2012) http://www.parlament.al/web/pub/2012_raporti_per_vendimet_gjyqesore_15413_1.pdf

74 Procesverbali i mbledhjes dt. 12.11.2014, i komisionit për çështjet ligjore, administratën publike dhe të drejtat e njeriut, seancë dëgjimore me Avokatin e Popullit për progres raportin e vitit 2014.

75 Komente dhe mendime të Avokatit të Popullit për progres--raportin e KE-së për Shqipërinë për 2014, Tiranë 2014, fq. 2. Procesverbali i mbledhjes dt. 12.11.2014 i komisionit për çështjet ligjore, administratën publike dhe të drejtat e njeriut, seancë dëgjimore me Avokatin e Popullit për progres raportin e vitit 2014.

kontrollin e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, ndër të cilat edhe të vendimeve gjyqësore me këtë objekt, që afektojnë gratë, nuk ka rezultuar efektive.

113. Nuk është diskutuar në kohë raporti i veçantë i AP mbi mosekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Me Ligjin nr. 155/2014, "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 8454, datë 4.2.1999, "Për avokatin e popullit", të ndryshuar", neni 28 i ligjit është ndryshuar. Raporti vjetor i AP shqyrtohet në Kuvend brenda 3 (tre) muajve nga depozitimi. Raportet e veçanta të AP diskutohen në Kuvend brenda 2 (dy) muajve nga depozitimi. Nëse raporti vjetor ose raportet e veçanta nuk diskutohen nga Kuvendi brenda afateve të parashikuara në këtë dispozitë, AP ka të drejtë të publikojë raportin.

*1.5.3.1. Rekomandime:*[76]

114. Institucionet përgjegjëse të marrin masa për përmbushjen në kohë të detyrimit ligjor të zbatimit të rekomandimeve të AP në lidhje me kthimin në punë të gjyqfituesve, përfshirë gratë.

115. Krijimi i një baze të dhënash për pasqyrimin e të gjitha praktikave përmbarimore është i rekomandueshëm. Elementi gjinor rekomandohet të përfshihet në bazën e të dhënave.

116. Rekomandohet hartimi dhe miratimi i një akti nënligjor për mënyrën dhe afatin maksimal të ekzekutimit të titujve ekzekutivë nga organet e shtetit, lidhur me detyrimet monetare, apo kryerjen e një veprimi të caktuar (neni 605 i KPrC).

117. Rekomandohet forcimi i rolit drejtues dhe kontrollues i Ministrisë së Drejtësisë dhe i Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarimit Gjyqësor Shtetëror për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë.[77]

118. Rekomandohet ngritja e grupit të punës për evidentimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, të paekzekutuara, ndër të cilat edhe vendimeve gjyqësore të formës së prerë në favor të grave, me palë debitore institucionet e administratës shtetërore, si dhe marrjen e masave për ekzekutimin sa më parë të këtyre vendimeve.

119. Rekomandohet përgatitja e një plani veprimi për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore për dëmshpërblimet dhe për rastet për kthimin e punonjësve në vendet e mëparshme të punës[78].

120. Komisioneri për shërbimin civil do të përbëjë një institucion garant dhe të rëndësishëm për reformën në administratën publike. Rekomandohet kryerja e monitorimit nga aktorë të tjerë të jashtëm, jo vetëm nga institucionet e pavarura por dhe nga shoqëria civile. Për këtë arsye rekomandohet krijimi i aksesit të nevojshëm[79].

121. Rekomandohet diskutimi në kohë i raporteve të veçanta nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, ndër të cilat edhe të raportit "Për situatën e krijuar nga mosekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë".

## 1.6. Aspekte të respektimit të së drejtës për proces të rregullt ligjor përmes ankesave për gjykatën dhe prokurorinë.

*Gjykata:*

122. Ankesat e shqyrtuara nga AP kanë pasur

76 Ndonëse disa nga rekomandimet e institucionit duken neutrale nga pikëpamja gjinore, zbatimi i tyre do të sillte efekte të drejtpërdrejta tek gratë dhe garantimin e të drejtave të njohura me vendim gjyqësor të formës së prerë. Këto rekomandime lidhen, jo vetëm me mosekzekutimin nga institucionet të vendimeve gjyqësore të formës së prerë për kthimin në punë të gjyqfitueseve.

77 Ky rekomandim është prezantuar në raportin e veçantë të institucionit të AP, "Për situatën e krijuar nga mosekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë", fq. 5. (nr. 211, dt. 27.07.2012)

78 Komente dhe mendime të Avokatit të Popullit për progres-raportin e KE-së për Shqipërinë për 2014, Tiranë 2014, procesverbali i mbledhjes dt. 12.11.2014 i komisionit për çështjet ligjore, administratën publike dhe të drejtat e njeriut, seancë dëgjimore me Avokatin e Popullit për progres raportin e vitit 2014, fq. 3.

79 Komente dhe mendime të Avokatit të Popullit për progres-raportin e KE-së për Shqipërinë për 2014, Tiranë 2014, procesverbali i mbledhjes dt. 12.11.2014 i komisionit për çështjet ligjore, administratën publike dhe të drejtat e njeriut, seancë dëgjimore me Avokatin e Popullit për progres-raportin e vitit 2014, fq. 2.

të bëjnë me zvarritje të padrejta dhe të pajustifikuara të gjykimeve, si për çështje civile ashtu edhe për çështje penale.

*Organi i prokurorisë:*

123. Në institucionin e AP janë paraqitur ankesa edhe në lidhje me mosrespektimin e detyrimit të organit procedues për njoftimin e palës së dëmtuar nga vepra penale në lidhje me të drejtën e saj për të ngritur padi civile në procesin penal dhe për të kërkuar shpërblimin e dëmit, sipas nenit 61 të Kodit të procedurës penale. Ky mosveprim ka detyruar palën e dëmtuar, ose familjarët e viktimave apo të dëmtuarve nga vepra penale, për të paraqitur kërkesëpadi më vete para gjykatës civile me objekt "Shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga vepra penale". AP ka bërë një studim dhe ka përgatitur rekomandimin legjislativ me propozime për shtesa dhe përmirësime në nenet 48 dhe 58 të Kodit të procedurës penale, me qëllim caktimin e avokatit mbrojtës në hetimin dhe gjykimin e procedimit penal për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të ligjshme të viktimës. Ky rekomandim është në përputhje me standardet ndërkombëtare, në lidhje me të drejtat e viktimave të krimeve të dhunshme, në mënyrë të veçantë viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore apo krimeve të tjera të dhunshme.

*1.6.1. Rekomandime:*

124. Rekomandohet rishikimi i vlerësimit të gjyqtarëve dhe monitorimi i punës së tyre në vazhdimësi nga KLD. Kjo do të ishte në përputhje me rekomandimin e Komitetit CEDAW, "të zhvillohen mekanizma efektivë dhe të pavarur që të studiojnë dhe monitorojnë aksesin e grave në drejtësi me qëllim që të sigurojnë që sistemet e drejtësisë janë në përputhje me parimet e drejtësisë, vlefshmërisë, aksesit, cilësisë së mirë dhe efektivitetit të mjeteve"[80]. Të dhëna nga monitorimi mbi kohëzgjatjen e procedurave dhe rezultatet e tyre duhet të jenë të ndara sipas gjinisë së ankuesit.

125. Të miratohen ndryshimet në Kodin e procedurës penale, më qëllim një përcaktim të qartë të profesionistëve përgjegjës për informimin e viktimave të krimeve të dhunshme, në lidhje me të drejtën e tyre për kompensim dhe të drejta të tjera.

126. Rekomandohet miratimi pa vonesë i propozimeve të AP për shtesa dhe përmirësime në nenet 48 dhe 58 të Kodit të procedurës penale, me qëllim caktimin e avokatit mbrojtës në hetimin dhe gjykimin e procedimit penal, të cilat do të sillnin një mbrojtje më të mirë të të drejtave të viktimave. Miratimi i tyre do të sillte efekte tek gratë, viktima të krimeve të dhunshme, si dhunës në familje, trafikimit të qenieve njerëzore etj.

*Diskriminimi i shumëfishtë:*

Neni 2 i Konventës CEDAW dhe paragrafi 42 i VP të Komitetit CEDAW.

### 1.7. Mbi përmirësimin e kuadrit ligjor dhe masat për mbrojtjen e të drejtave të grave që i përkasin komunitetit LGBTI.

127. Shteti shqiptar ka bërë përpjekje për zbatimin e rekomandimit të Këshillit të Evropës CM/Rec (2010)5 "mbi masat kundër diskriminimit për shkak të orientimit seksual ose idEntit gjinor". Për sa i përket të drejtave të personave lesbike, homoseksualë, biseksualë, transeksualë dhe ndërgjinorë (LGBTI), është përmirësuar bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve shtetërore dhe organizatave të shoqërisë civile për këtë çështje[81]. "Plani i masave për mosdiskriminim për shkak të orientimit seksual dhe idEntit gjinor, 2012-2014" është miratuar në dhjetor të vitit 2012. AP, si institucioni kryesor i mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të njeriut në Shqipëri, ka paraqitur sugjerime lidhur me planin, shtimin e treguesve që përcaktojnë realizimin e masave, si dhe burimin e financimit të kostos së masës konkrete duke e vlerësuar të rëndësishme zbatimin e tyre nga autoritetet shtetërore përgjegjëse.

128. Institucioni i AP ka përgatitur një raport

80 Komiteti CEDAW, Rekomandimi i përgjithshëm nr.33, mbi aksesin e grave në drejtësi, 20 (a).

81 KE, progres-raporti 2014 për Shqipërinë, fq. 56, http://www.integrimi.gov.al/al/dokumenta/progres-raporte/progres-raporti-2014&page1

të posaçëm që është paraqitur nga AP në nënkomisionin për të drejtat e njeriut në Kuvendin e Shqipërisë dhe është shqyrtuar nga nënkomisioni për të drejtat e njeriut dhe nënkomisioni për çështjet e të miturve, barazisë gjinore dhe dhunës në familje në dhjetor 2014[82]. Një nga shqetësimet që ka ngritur institucioni i AP është përmirësimi i legjislacionit në lidhje me të drejtat e komunitetit LGBTI.

*Në lidhje me kuadrin ligjor:*

129. Ligji "Për mbrojtjen nga diskriminimi"[83] (2010) rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit edhe për shkak të idEntit gjinor dhe orientimit seksual.

130. AP ka kontribuar në përmirësimin e legjislacionit penal në mbrojtje të të drejtave të personave LGBTI. Kështu, AP ka rekomanduar që në pjesën e përgjithshme të Kodit penal, në nenin 50, germa "j", të shtohet si rrethanë rënduese edhe kryerja e veprës, e shtyrë nga motive që kanë të bëjnë me orientimin seksual dhe ky rekomandim është pranuar. Me Ligjin nr. 144/2013, "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, 'Kodi penal i Republikës së Shqipërisë', të ndryshuar", neni 50, shkronja "j" është ndryshuar duke konsideruar si rrethanë rënduese kryerjen e veprës, shtyrë nga motive që kanë të bëjnë me identitetin gjinor dhe orientimin seksual, përveç motiveve të tjera.

Me Ligjin nr. 144/2013, "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 'Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë', të ndryshuar" neni 265 i Kodit penal, "Nxitja e urrejtjes ose grindjeve"[84] i ndryshuar, Kuvendi i Shqipërisë parashikoi kryerjen e veprës penale të nxitjes së urrejtjes dhe grindjeve për shkak të orientimit seksual, por nuk përfshiu si shkak të saj identitetin gjinor.

Në nenin 253 të Kodit penal, "Shkelja e barazisë së shtetasve" është përfshirë edhe kryerja për shkak të detyrës e në ushtrim të saj nga ana e punonjësit me funksion shtetëror apo në shërbim publik, e dallimeve mbi bazë orientimi seksual ose identiteti gjinor që konsiston në krijimin e privilegjeve të padrejta ose në refuzimin e një të drejte ose përfitimi që buron nga ligji.

131. Gjatë vitit 2013 AP ka rekomanduar edhe ndryshimin e neneve 119/a dhe 119/b të Kodit penal, ku të parashikohej si vepër penale shpërndarja e materialeve homofobike si dhe e fyerjes nëpërmjet rrjetit kompjuterik për motive të orientimit seksual dhe/ose idEntit gjinor. Ky rekomandim është i pazbatuar.

132. AP ka vlerësuar se neni 9 i Kodit të punës i Republikës së Shqipërisë (miratuar me Ligjin 7961/1995)[85] nuk garanton trajtim të barabartë të personave LGBTI për ushtrimin e të drejtës për punësim dhe formim profesional. Në nenin 9 të Kodit të punës, i ndryshuar, parashikohet se ndalohet çdo lloj diskriminimi në fushën e marrjes në punë dhe të profesionit. Në nenin 9 të Kodit të punës përcaktohet përkufizimi i diskriminimit si dhe shkaqet në bazë të të cilave mund të ndodhë diskriminimi si, raca, ngjyra, seksi, mosha, feja, bindjet politike, origjina kombëtare, origjina shoqërore, lidhjet familjare, të metat fizike ose mendore, duke mos përfshirë ndalimin e diskriminimit për shkak të orientimit seksual apo idEntit gjinor. AP ka ndarë shqetësimin se mospërfshirja e ndalimit të diskriminimit për shkak të orientimit seksual dhe idEntit gjinor mund të përbëjë shkak për të cenuar garantimin e të drejtës për punë të komunitetit LGBTI. AP i ka paraqitur një rekomandim legjislativ ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, duke vlerësuar se orientimi seksual dhe identiteti gjinor

82 Raport i posaçëm i veprimtarisë së Avokatit të Popullit gjatë vitit 2012 për të drejtat e personave LGBT. (nr. 245, datë 05.09.2012) http://www.parlament.al/web/pub/2012_raporti_per_lgbt_15412_1.pdf

83 Ligji nr. 10221, datë 4.2.2010, "Për mbrojtjen nga diskriminimi".

84 Neni 265, 'Nxitja e urrejtjes ose grindjeve', i ndryshuar me ligjin nr. 144/2013, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 'Kodi penal i Republikës së Shqipërisë'", të ndryshuar.

85 Shkresa nr.116, datë 13.04.2012, "Relacion për ndryshimet e Ligjit nr. 7961/1995", dërguar MPCSSHB. Kjo vërejtje është prezantuar edhe në raportet vjetore të institucionit të AP. (2012)

duhet të parashikohen si shkaqe për të cilat ndalohet diskriminimi. AP vlerëson faktin se rekomandimi i paraqitur në datën 13.4.2012[86] mbi njohjen e orientimit seksual dhe idEntit gjinor si shkaqe shtesë të diskriminimit është pranuar dhe reflektuar në draftligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995, 'Kodi i punës i Republikës së Shqipërisë', të ndryshuar", miratuar nga Këshilli i Ministrave në datën 8.4.2015.

133. AP ka bashkëpunuar me KE, KMD dhe grupet e interesit dhe me iniciativë të MMSR, në muajin dhjetor 2014 është propozuar një paketë rekomandimesh për ndryshime legjislative, përfshirë edhe ndryshime në Kodin e familjes[87], ku parashikohet ligjërimi i bashkëjetesës mes personave të të njëjtit seks[88]. Ky rekomandim nuk është zbatuar.

*Në lidhje me situatën de facto:*

134. Organizatat e komunitetit LGBTI shprehin shqetësimin se gratë LBTI përballen me shtypje në familje, papunësi dhe forma të ndryshme diskriminimi në punësim, akte urrejtjeje dhe dhune, dhunë në familje, diskriminim në arsim, diskriminim të shumëfishtë, kërcënime me vdekje[89] dhe nivel të ulët raportimi të krimit të urrejtjes për shkak të mungesës së besimit tek institucionet shtetërore ku raportohen këto krime.

135. Në raportin e institucionit të AP për vitin 2014 theksohet se përfaqësuesit e komunitetit LGBTI përballen me vështirësi në jetën e tyre të përditshme dhe me kufizime të të drejtave themelore. Raporti citon se, "Megjithëse Shqipëria ka bërë progres drejt pranimit të personave LGBTI, homofobia dhe transfobia mbeten fenomene shumë problematike në të gjithë vendin. Situata e LGBTI në mjedisin e punës mbetet e paqartë dhe, për shkak të homofobisë dhe transfobisë së lartë që ekziston, shumë prej tyre zgjedhin të mbajnë të fshehur identitetin e tyre seksual dhe gjinor. E njëjta situatë mbetet dhe në sistemin arsimor si dhe atë shëndetësor duke i gjetur stafet e papërgatitura për adresimin dhe zgjidhjen e problemeve që hasin më së shumti anëtarët e LGBTI". Në vitin 2014 AP ka shqyrtuar ankesa lidhur me diskriminimin për shkak të idEntit gjinor, fjalime të mbushura me urrejtje në media sociale nga persona publikë, publikime diskriminuese dhe me përmbajtje të lartë urrejtje nga politikanë dhe figura të tjera publike.

136. Në Shqipëri personat LGBTI, përfshirë gratë LBTI nuk gëzojnë të drejtën e martesës, unioneve civile etj.

137. AP i është drejtuar me rekomandim Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës duke theksuar nevojën për rishikimin e programeve dhe materialeve mësimore në Fakultetin e Mjekësisë dhe atë të Drejtësisë në UT dhe është sjellë në vëmendje të të gjithë strukturave shtetërore se këto materiale përmbajnë përkufizime diskriminuese ndaj këtij komuniteti. Ky rekomandim është zbatuar.

AP ka shprehur qartë shqetësimin e tij edhe në lidhje me përmirësimin e kurikulës në arsimin parauniversitar dhe krijimin e një ambienti të përshtatshëm për bashkëjetesë për personat LGBTI, përfshirë vajzat e këtij komuniteti.

138. Gjithashtu, lidhur me promovimin e të drejtave të Komunitetit LGBT në Shqipëri institucioni i Avokatit të Popullit ka luajtur një rol shumë aktiv si bashkorganizator i Festivalit të Diversitetit në Tiranë, më 17 maj dhe në aktivitete të tjera ndërgjegjësuese.

*1.7.1. Rekomandime:*

*Në lidhje me kuadrin ligjor:*

139. Rekomandohet miratimi i ndryshimeve ligjore në Kodin penal, që konsistojnë në një përkufizim më të plotë të krimit të urrejtjes dhe ndryshimin e neneve

86 Rekomandimi nr.116, datë 13.4.2012, drejtuar Z. Spiro Ksera, ish-ministër i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

87 Ligji nr. 9062, datë 8.5.2003, "Kodi i familjes".

88 Referuar raportit vjetor "Për veprimtarinë e Avokatit të Popullit", 1 janar-31 dhjetor 2014. Rekomandimi nr.doc. 201501690/2, mbi ndryshimet në Ligjin nr. 9062, datë 05.08.2003, "Kodi i familjes i RSH-së", i është dërguar ministrit të Drejtësisë, në vitin 2015.

89 OJF të këtij komuniteti raportojnë për dëshmi të transvestitëve, që në mënyrë të vazhdueshme janë përballur me kërcënime me vdekje.

119/a dhe 119/b të Kodit penal, duke parashikuar si vepër penale shpërndarjen e materialeve homofobike si dhe fyerjen nëpërmjet rrjetit kompjuterik për motive të orientimit seksual dhe/ose idEntit gjinor. Po ashtu rekomandohet miratimi i ndryshimeve ligjore të rekomanduara nga AP në Kodin e familjes në lidhje me bashkëjetesën e personave të të njëjtit seks dhe njohja e idEntit gjinor në ligjin "Për gjendjen civile". Barra e përmbysur e provës në Kodin e punës do të rriste garancitë për mbrojtjen e personave LGBTI, përfshirë gratë nga diskriminimi në punë, arsim dhe shërbime.

*Në lidhje me situatën de facto:*

140. Rekomandohet marrja e masave antidiskriminim në punësim, arsim dhe në fushën e të mirave dhe shërbimeve nga punëdhënësit publikë dhe privatë, drejtuesit e institucioneve arsimore dhe personat fizikë dhe juridikë që ofrojnë të mira apo shërbime, në zbatim të detyrimeve të përcaktuara në Ligjin nr. 10221, datë 4.2.2010, "Për mbrojtjen nga diskriminimi" (2010).

141. Organizatat që punojnë për të drejtat e grave LBTI rekomandohet të forcojnë rolin e tyre përmes paraqitjes së ankesave në emër të individëve apo grupeve të individëve që janë përballur me situata diskriminimi ose nëpërmjet paraqitjes së informacioneve të besueshme para institucionit të KMD.

142. Rekomandohet përfshirja në kurikula dhe programe mësimore në të gjitha nivelet e arsimit, e njohurive dhe informacioneve për komunitetin LGBT. Kjo do të ndihmonte në sfidimin e paragjykimeve të bazuara në orientimin seksual dhe identitetin gjinor.

*Në lidhje me rritjen e kapaciteteve dhe ndërgjegjësimin e profesionistëve:*

143. Rekomandohet organizimi në vazhdimësi i trajnimeve nga Shkolla e Magjistraturës i gjyqtarëve, prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore, në lidhje me zbatimin e ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi, legjislacionit penal dhe ndryshimeve të fundit në lidhje me të drejtat e personave LGBTI, përfshirë gratë.

144. Rekomandohet trajnimi në vazhdimësi i stafit akademik dhe psikologëve në shkolla për moslejimin e çdo forme diskriminimi, duke siguruar në institucionet arsimore mbrojtje nga diskriminimi edhe për shkak të idEntit gjinor dhe orientimit seksual. Trajnime të tilla janë të rekomandueshme si për stafin edhe për drejtues të institucioneve të ndryshme publike, me qëllim mbrojtjen e këtij grupi nga përjashtimi dhe diskriminimi.

### 1.8. Gratë e moshuara.

145. Megjithëse mungesa e të dhënave për gratë e moshuara ishte një nga shqetësimet e Komitetit CEDAW për Shqipërinë në 2010, VP, p. 38, "ende nuk ka një analizë dhe statistika të plota mbi gratë e moshuara dhe gjendjen e tyre faktike sipas fushave të Konventës"[90]. Kjo situatë pranohet edhe në raportin e katërt periodik kombëtar mbi zbatimin e Konventës CEDAW.

146. AP ka ngritur shqetësimin e mungesës së një ligji, që synon përmirësimin e cilësisë së jetesës së moshës së tretë dhe vazhdon punën me institucionet përgjegjëse për miratimin e tij.

147. AP ka ngritur shqetësimin se mungesa e sigurimit të një minimumi të ardhurash mund të bëjë që kjo kategori sociale dhe familjet e tyre të jetojnë në varfëri, të mos marrin shërbimet e duhura shëndetësore dhe të mos kenë të ardhura të mjaftueshme për të përballuar jetesën.

148. Në disa raste, të moshuarit në prag të daljes në pension, largohen nga puna pa e mbushur moshën e daljes në pension dhe kjo sjell efekte në sigurimet shoqërore. Kjo grup-moshë has vështirësi për të gjetur një punë të re, kur ka humbur vendin e mëparshëm të punës, duke u përballur me diskriminim për shkak të moshës dhe gjinisë.

149. AP në inspektimet e kryera në qendrat sociale, rezidenciale dhe ditore për të moshuarit ka konstatuar probleme në

90 Raporti i katërt periodik kombëtar mbi zbatimin e Konventës "Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit të grave", miratuar me VKM nr. 806, datë 26.11.2014. Fletorja zyrtare e RSH nr. 187/2014, fq. 10178.

lidhje me kushtet fizike dhe cilësinë e jetesës së të moshuarve, përfshirë gratë.

150. Është e rëndësishme të theksojmë se nevojat e moshës së tretë, pra edhe të grave të këtij grupi janë bërë pjesë e politikave për përfshirjen sociale si edhe mbrojtjen shoqërore, por zbatimi në praktikë i këtyre politikave lë për të dëshiruar.

*1.8.1. Rekomandime:*

*Në lidhje me kuadrin ligjor:*

151. Rekomandohet miratimi i statusit të moshës së tretë me synim forcimin e grave të moshuara, të cilat mund të përballen me diskriminim për shkak të moshës, gjinisë, etj., në të gjitha fushat që mbulon Konventa CEDAW. Miratimi i një projektligji për moshën e tretë, që do t`i trajtonte gratë si kategori më vete, i shoqëruar me kostot financiare, i konsultuar me grupet e interesit rekomandohet të vlerësohet në kuadrin e reformës së pensioneve, të decentralizimit dhe asaj territoriale.

*Në lidhje me situatën faktike:*

152. Rekomandohet kryerja e një analize dhe mbledhja e të dhënave të plota mbi të moshuarit, të ndara sipas gjinisë dhe gjendjes faktike të grave të moshuara, sipas fushave të Konventës, që do të shërbejnë për marrjen e masave të nevojshme dhe forcimin e mekanizmave socialë ekonomikë nga aktorët përgjegjës si MMSR, pushteti vendor etj.

153. Rekomandohet që bashkitë dhe Shërbimi Social Shtetëror të marrin masa për përmirësimin e vazhdueshëm të kushteve dhe cilësisë së jetesës së të moshuarave në qendrat sociale rezidenciale dhe ditore për të moshuarit.

154. Rekomandohet që MMSR të monitorojë rregullisht zbatimin e politikave për përfshirjen sociale, me qëllim matjen e efekteve të masave të marra tek gratë e moshuara.

**1.9. Gratë rome.**

*Në lidhje me kuadrin ligjor dhe nevojën për përmirësimin e tij:*

155. AP ka rekomanduar miratimin e një ligji specifik, që të përfshijë përkufizimin dhe kriteret e njohjes së minoriteteve, miratimin e Kartës Evropiane për gjuhët rajonale dhe minoritare dhe aksesin në arsimin publik në gjuhët minoritare për të gjithë individët minoritarë.

156. Masat e veçanta të përkohshme të parashikuara në legjislacionin ekzistues për fuqizimin e komunitetit, në mënyrë të veçantë të grave, janë vlerësuar nga AP të pamjaftueshme. Kështu janë paraqitur rekomandime legjislative që lidhen me ndryshimin e ligjit 9232/2004, “Për programet sociale për strehimin e banorëve në zonat urbane”, i ndryshuar. AP ka propozuar që 5 % e vendeve nga çdo program të plotësohet nga familje rome. Këto familje të konsiderohen prioritare dhe të përfitojnë nga programi edhe kur të ardhurat e tyre janë nën nivelin e kërkuar nga ligji. Në përgjigje të këtij rekomandimi, Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit ka theksuar se ligji garanton të drejtën e strehimit për minoritetin rom.

Ligji “Për gjendjen civile” (2009) ka përcaktuar afatet për deklarimin, regjistrimin dhe ndryshimin e vendbanimit të shtetasve duke përcaktuar afatin 30-ditor nga ardhja në vendbanim si afat të deklarimit të ndryshimit. Edhe për deklarimin e banesave që nuk kanë statusin e vendbanimit zbatohet i njëjti afat. Një numër pjesëtarësh të minoritetit rom, përfshirë gratë, kanë ndryshuar vendbanimin, por vazhdojnë të jenë të regjistruar në zyrat e gjendjes civile të bashkive dhe komunave ku kanë jetuar më parë. Mosmarrja e masave efektive për të regjistruar pjesëtarët e minoritetit rom, përfshirë gratë rome në regjistrat e gjendjes civile ku kanë vendbanimin aktual sjell efekte në garantimin e të drejtave të këtij grupi si në përfitimet ekonomike, sociale, punësimit, strehimit etj. Rekomandimi i AP drejtuar ministrit të Brendshëm për ndryshime në Ligjin nr. 10129, datë 11.05.2009, “Për gjendjen civile” ka statusin e një rekomandimi pa

përgjigje[91].

157. AP ka rekomanduar ndryshimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 787/2005, "Për përcaktimin e kritereve, procedurave dhe të masës së ndihmës ekonomike", i ndryshuar, drejtuar MMSR, që ka statusin e një rekomandimi pa përgjigje. Pavarësisht se legjislacioni për ndihmën ekonomike synon trajtim të barabartë, mungesa e vendbanimeve të qëndrueshme, jetesa në baraka dhe lëvizja e vazhdueshme kanë sjellë mosplotësimin e kritereve ligjore për anëtarët e këtij komuniteti, përfshirë gratë rome. Janë propozuar ndryshime në VKM nr. 787/2005, me qëllim që këto familje të përfitojnë NE, pavarësisht llojit të banesës dhe shkakut të lëvizjes. Ndryshimet e propozuara i janë paraqitur ministrit të MSR dhe kryeministrit të RSH-së në 2012.

*Situata faktike:*

*Në lidhje me garantimin e të drejtave të minoritetit rom:*

158. Minoriteti rom është një grup vulnerabël dhe në risk, që në një pjesë të mirë të rasteve e ka të pamundur të përfitojë nga sistemi ynë social, duke përfshirë këtu strehimin, regjistrimin në gjendjen civile, përfitimin e ndihmës ekonomike, apo edhe arsimimin, punësimin, kujdesin shëndetësor dhe çdo përfitim që sistemi ynë social ua siguron qytetarëve shqiptarë. Për vitin 2012, institucioni i AP ka trajtuar ankesa në mënyrë individuale apo në grup nga 183 individë të minoritetit rom, përfshirë gratë[92].

159. Femrat që u përkasin grupeve të popullsisë rome, të cilat janë abuzuar, trafikuar, ose janë kryefamiljare kanë një probabilitet më të lartë për të jetuar në varfëri, për shkak të arritjeve të ulëta arsimore dhe shkëputjes nga tregu i punës, përveç faktorëve të tjerë[93].

160. Dy rekomandime të AP drejtuar Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve rekomandojnë ndalimin e segregimit të fëmijëve romë dhe egjiptianë në arsim. Segregimi dhe mospërmbushja e detyrimit të transportit falas për fëmijët[94] nga disa njësi të pushtetit vendor ka krijuar mundësi të braktisjes së shkollës, veçanërisht nga vajzat dhe vajzat e minoritetit[95]. AP ka kërkuar një angazhim proaktiv dhe të qëndrueshëm të institucioneve arsimore në nivel qendror dhe vendor me qëllim eliminimin e segregimit të fëmijëve romë dhe egjiptianë në arsim janë rekomanduar amendime të legjislacionit të brendshëm dhe ngritja e mekanizmave monitorues.

161. Aktualisht zbatohen programe për nxitjen e punësimit të grave rome si: Vendimi nr. 48, datë 16.01.2008, i ndryshuar, "Për masën dhe kriteret e përfitimit nga programi i nxitjes së punësimit të punëkërkuesve të papunë në vështirësi", që parashikon përfitimin nga ky program të punëkërkuesve të papunë në vështirësi, duke përfshirë edhe personat nga komuniteti rom. Edhe Vendimi nr. 27, datë 11.01.2012, "Për programet e nxitjes së punësimit të femrave nga grupet e veçanta", i ndryshuar përcakton si përfituese të këtij programi femrat punëkërkuese nga grupet e veçanta, duke përfshirë edhe femrat rome. Numri i grave

91 "Rekomandim për marrjen e masave për regjistrimin e pjesëtarëve të minoritetit rom ne regjistrat e gjendjes civile, në njësitë vendore ku ata kanë vendbanimin aktual", drejtuar ministrit të Brendshëm dhe kryeministrit të Shqipërisë, 2013.

92 Raport vjetor "Për veprimtarinë e Avokatit të Popullit", Viti 2012, fq. 49.

93 Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2014-2020, miratuar me VKM "Për miratimin e strategjisë kombëtare për punësim dhe aftësi 2014 – 2020 dhe të Planit të Veprimit për zbatimin e saj", botuar në Fletoren zyrtare nr. 188/2014, fq. 10322.

94 Njësitë e pushtetit vendor janë të detyruara të sigurojnë transportin falas për të gjithë fëmijët që ndjekin shkollën fillore dhe jetojnë më larg se 2 km nga shkolla dhe për të gjithë fëmijët që ndjekin shkollën 9-vjeçare dhe jetojnë më larg se 5 km nga shkolla.

95 Dy ankesa janë paraqitur pranë institucionit të AP nga ERRC (Qendra Evropiane për të Drejtat e Romëve). Rekomandimet në lidhje me situatën në shkollën 9-vjeçare publike në Korçë dhe shkollën fillore në Moravë, Berat janë rekomandime pa përgjigje nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, megjithëse afati i parashikuar në ligj ka kaluar. Rekomandimet janë botuar në: http://www.avokatipopullit.gov.al/sites/default/files/ctools/css/Rekomandimi%20MAS%202.pdf http://www.avokatipopullit.gov.al/sites/default/files/ctools/css/Rekomandimi%20MAS%203_0.pdf

rome që kanë përfituar nga këto programe është i pamjaftueshëm në raport me nevojat e këtij grupi.

162. Rekomandime janë paraqitur nga institucioni i AP në lidhje me integrimin e fëmijëve romë në të gjitha nivelet e arsimit[96], përmirësimin e kushteve të jetesës së minoritetit rom, ofrimin e një strehimi të përshtatshëm pas dëbimit të familjeve rome, marrjen e masave për trajtimin dhe asistencën e vazhdueshme shëndetësore për pjesëtarët e komunitetit rom, regjistrimin e fëmijëve në shkollat 9-vjeçare pranë vendbanimit, etj[97]. Integrimi i fëmijëve rom, përfshirë vajzat, në të gjitha nivelet e arsimit i përgatit ata për një jetë sociale pa përjashtime dhe diskriminim.

163. AP vlerëson çështjen e strehimit si një nga problemet më shqetësuese me të cilën po përballet minoriteti rom, përfshirë gratë rome. Numri i familjeve rome që kanë përfituar nga Ligji nr. 9232, datë 13.05.2004, "Për programet sociale të strehimit të banorëve të zonave urbane", i ndryshuar, është i kufizuar. "Gratë kanë më pak gjasa për të aplikuar e për rrjedhojë përfitojnë më pak nga programet sociale të strehimit"[98]. Çështja e strehimit të përshtatshëm të minoritetit rom, përfshirë gratë rome është e lidhur ngushtë me të drejta të tjera të parashikuara në Konventën CEDAW. Institucioni i AP gjatë vitit 2014 ka trajtuar ankesa të grave rome, me statusin e të pastrehës, të cilat kanë aplikuar pranë Bashkisë Tiranë për banesa sociale dhe ka rekomanduar marrjen e masave të menjëhershme për zgjidhjen e problemit të strehimit. Në vijim të rekomandimeve të AP në lidhje me ankesa të caktuara, Bashkia e Tiranës ose është përgjigjur se rastet janë ende në proces[99] ose në disa raste nuk ka pasur përgjigje[100]. Por numri i grave rome përfituese është i kufizuar.

Edhe raport-progresi për Shqipërinë, 2014, thekson mungesën e zgjidhjeve afatgjata dhe të qëndrueshme për strehimin dhe përballjen e këtij komuniteti me kushte jetese shumë të vështira dhe shpesh me diskriminim dhe përjashtim social, sidomos përsa i përket aksesit në kujdes shëndetësor, mbrojtjes sociale, punësimit dhe strehimit"[101].

164. Mungojnë të dhëna të sakta mbi popullsinë e minoritetit rom, të pakontestuara nga

96 Realizimi i disa përmirësimeve në Ligjin nr. 69, datë 21.06.2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", që do të parashikojnë dhe garantojnë integrimin në arsim të fëmijëve Romë, nga niveli parashkollor e deri në nivelet e tjera më të larta të arsimit; (shkresa nr. K1/I62-6 datë 23.12.2013).

97 Rekomandim Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta për ndërhyrjen urgjente dhe verifikimin e situatës së rëndë sociale, si dhe zgjidhjen e problemit të strehimit të pjesëtarëve të komunitetit rom në kampin e ish-dekorit; (shkresa nr. K3/M39-7, datë 12.08.2013)
Rekomandim Bashkisë Tiranë për zgjidhjen e problemit të strehimit të pjesëtarëve të komunitetit rom në kampin e ish-dekorit;(shkresa nr. K3/M39-5, datë 6.08.2013)
Rekomandim shefit të Komisariatit nr. 2 për hetimin e kallëzimeve penale me objekt cenimin e jetës dhe shëndetit të pjesëtarëve të komunitetit rom në kampin e ish-dekorit; (shkresa nr. K3/M39-6 date 12.08.2013)
Rekomandim Ministrisë së Shëndetësisë për marrjen e masave për trajtimin dhe asistencën e vazhdueshme shëndetësore për pjesëtarët e komunitetit rom në kampin e ish-dekorit; (shkresa K3/M39-8 date 15.08.2013)
Rekomandim drejtuar drejtorisë arsimore rajonale Tiranë për marrjen e masave për të mundësuar regjistrimin e fëmijëve të komunitetit rom, që jetojnë në kampin e ish-dekorit në rrugën e Kavajës, në shkollat 9-vjeçare pranë vendbanimit aktual të tyre dhe pajisjen e tyre me libra dhe bazën mësimore falas. (shkresa nr. K1/L44-4 date 12.09.2013)
AP ka rekomanduar përmirësimin e kushteve të jetesës në vendbanime konkrete të minoritetit rom, sikurse godina e ish-repartit ushtarak, të ndodhur në zonën e Sharrës, Tiranë. (K3/E53-2 date 6.11.2013)
Rekomandimi nr.dok. 201401900/4, "Rekomandohet garantimi dhe respektimi i të drejtave të banorëve të komunitetit rom në zonën e Selitës lidhur me programet e strehimit social", drejtuar Bashkisë Tiranë, Entit Kombëtar të Banesave, Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Turizmit dhe Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë. (shkresa nr. K3/Sh63-4 date 18.11.2014)

98 Programi i Kombeve të Bashkuara për mbështetjen e përfshirjes sociale në Shqipëri, "Strehimi social në Shqipëri: Vlerësim i nevojave", Tiranë 2014, fq. 8.

99 Ankesë e paraqitur nga shtetasja rome M.K., nr.dok. 201302695/10, K1/M65-10, datë 15/05/2014. (Rekomandimi drejtuar Bashkisë Tiranë është zbatuar pjesërisht).

100 Ankesë e paraqitur nga shtetasja rome, M.SH. nr. 201201724/9, K1/M27-9, datë 10/06/2014. (Rekomandimi drejtuar Bashkisë Tiranë është rekomandim pa përgjigje).

101 http://www.integrimi.gov.al/al/dokumenta/progres-raporte/progres-raporti-2014&page1

ky minoritet. Në lidhje me gratë rome, mungesa e të dhënave të ndara sipas gjinisë nuk mundëson marrjen e masave të studiuara për të adresuar nevojat e tyre.

165. AP ka shprehur shqetësimin në lidhje me rekomandimet pa përgjigje që lidhen me përmirësimin e kushteve të jetesës dhe gëzimin e të drejtave nga ky komunitet, përfshirë gratë rome. Në rekomandimet me status "rekomandime pa përgjigje" të institucionit të AP përfshihen edhe rekomandimet për marrjen e masave për përmirësimin e kushteve të jetesës së minoritetit etnogjuhësor rom, drejtuar disa bashkive dhe njësive bashkiake në Tiranë[102].

### 1.9.1. Rekomandime:

*Në lidhje me kuadrin ligjor dhe masa të tjera:*

166. Rekomandohet plotësimi i kuadrit ligjor për mbrojtjen e minoriteteve, në këndvështrimin e të drejtave të parashikuara në Konventën Kuadër të Këshillit të Evropës "Për mbrojtjen e minoriteteve kombëtare".

167. Rekomandohet kryerja e përmirësimeve ligjore në ligjin "Për gjendjen civile" (2009), Ligjin "Për programet sociale për strehimin e banorëve në zonat urbane" (2004), Ligjin "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë" (2012), Ligjin "Për mbrojtjen nga diskriminimi" (2010), etj. me qëllim garantimin e të drejtave të minoritetit rom, përfshirë gratë rome në mënyrë të barabartë dhe pa diskriminim.

Rekomandohet që ndryshimet ligjore të mundësojnë një diskriminim pozitiv dhe lehtësim të kritereve ligjore për përfitimin e shërbimeve të sistemit aktual social dhe përmirësimin e aksesit të minoritetit rom, përfshirë gratë rome në strehim, arsim, shërbimet sociale, pjesëmarrjen në jetën publike në vend dhe programet e formimit profesional dhe punësimit. Janë rekomanduar amendime të legjislacionit të brendshëm në lidhje me parandalimin dhe eliminimin e segregimit në arsim. Masa të mirëstudiuara kundër segregimit të ndërmerren nga institucionet arsimore në nivel qëndror dhe vendor.

168. Në lidhje me strehimin e përshtatshëm të komunitetit rom, përfshirë gratë, janë rekomanduar ndryshime në legjislacionin ekzistues, përsa i takon plotësimit të kritereve për të përfituar nga mundësitë që ofron pushteti qendror dhe vendor për problemin e strehimit. AP ka rekomanduar ndryshime të Ligjit nr. 9232, datë 13.05.2004, "Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane", i ndryshuar, duke kërkuar parashikimin e dispozitave të veçanta për komunitetin rom, që do të mundësonin përfitimin e këtij komuniteti, përfshirë gratë, në lidhje me të drejtën për strehim.

169. Rekomandohet thjeshtimi i procedurave të aplikimit në lidhje me të drejtën për strehim dhe informimi i grave rome dhe egjiptiane si edhe grave nga grupe të tjera në nevojë për ecurinë e procesit.

170. Institucioni i AP rekomandon respektimin e standardeve ndërkombëtare në lidhje me akomodimin e përshtatshëm të komunitetit rom pas dëbimit, duke e konsideruar këtë të drejtë si tejet të rëndësishme për gratë rome. Në rastin e grave, në mënyrë të veçantë grave në nevojë, grave nga komuniteti rom, egjiptian etj., përfitimi nga programet e banesave sociale është i lidhur ngushtësisht me të drejtat që mbulon Konventa CEDAW si e drejta për arsim, punësim, barazinë në martesë dhe jetën familjare, etj.

171. Rekomandohet kryerja e regjistrimit të popullsisë (censusi), të pakontestuar dhe të gjithëpranuar edhe nga minoritetet dhe komunitetet e tjera, i cili do të ofronte shifrat reale të popullsisë minoritare, si edhe të komuniteteve të tjera, të ndara edhe sipas gjinisë.

## 1.10. Gratë me aftësi të kufizuar.

172. Në lidhje me kuadrin ligjor. Garantimi i të drejtave të personave me aftësi të kufizuar është pjesë e rekomandimit 11, të BE për Shqipërinë dhe, në këtë kontekst por jo vetëm, zhvillimet në legjislacionin dhe politikat për personat me aftësi të kufizuar, si dhe zbatimi i tyre, kanë qenë objekt i vlerësimeve dhe rekomandimeve

102 Avokati i Popullit, botim periodik i institucionit të Avokatit të Popullit, nr.1, nëntor 2014, fq.10.

të institucionit tonë. Miratimi i Ligjit nr. 93/2014, "Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuar" përbën një nismë që i hap rrugën përafrimit të legjislacionit të brendshëm me standardet e Konventës së OKB "Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuar", me qëllim garantimin e të drejtave të PAK, përfshirë gratë. Ky ligj adreson disa çështje të rëndësishme si: vlerësimi i AK, monitorimi i zbatimit të KDPAK nga AP dhe KMD, shërbimet për një jetesë të pavarur, barazia para ligjit, etj.

173. Ligji nr. 26/2012, " Për disa ndryshime në Ligjin nr. 8098, datë 28.03.1996, "Për statusin e të verbrit" prezantoi ndryshime, ndër të cilat përfitimi i kompensimit të faturës së energjisë elektrike dhe telefonisë fikse nga të gjithë personat e verbër sipas nenit 1 të këtij ligji. AP i ka rekomanduar ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, ministrit të Punëve Publike dhe Transportit dhe ministrit të Financave nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të Ligjit nr. 26/2012 "Për disa ndryshime në Ligjin nr. 8098 datë 28.03.1996 "Për statusin e të verbrit"; të Ligjit nr. 27/2012 "Për disa ndryshime në Ligjin nr. 8626 datë 22.06.2000 "Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik", të ndryshuar; të Ligjit nr. 7889 datë 14.12.1994 "Për statusin e invalidit". Ky rekomandim është marrë në konsideratë dhe janë nxjerrë aktet nënligjore.

174. Me Ligjin nr. 47/2014 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9355, datë 10.3.2005, "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", të ndryshuar, është parashikuar se përfituesve, të klasifikuar me vendim të KMCAP-it në grupet e aftësisë së kufizuar, përfshirë gratë u ndërpritet pagesa vetëm pas 24 muajsh punësimi.

175. Me VKM nr. 837, datë 3.12.2014 është njohur gjuha e shenjave për personat që nuk flasin dhe nuk dëgjojnë, duke përbërë një hap të rëndësishëm në lidhje me të drejtat e këtyre personave, përfshirë gratë.

*Në lidhje me politikat:*

176. Me VKM nr. 818, datë 26.11.2014 është miratuar Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2014-2020 dhe Plani i Veprimit për zbatimin e saj. Disa nga problemet që evidenton kjo strategji për PAK, përfshirë gratë, janë: mundësia e qasjes fizike në kurset e AFP-së, mungesa e instruktorëve të trajnuar, mungesa e materialeve të përshtatshme, informacioni i kufizuar, ngurrimi i kompanive si edhe i institucioneve publike për t'i punësuar ata, mungesa e shërbimeve shoqëruese mbështetëse, si dhe e personave që përkujdesen për ta, si edhe çështjet e transportit. Është e rëndësishme që kjo strategji shoqërohet nga një plan veprimi, buxhet përkatës dhe një sistem i qartë monitorimi.

*Në lidhje me situatën faktike:*

177. Pavarësisht përmirësimit të situatës ligjore, situata reale e gëzimit të të drejtave nga gratë me AK lë për të dëshiruar. Raporti vjetor 2013 i KMD thekson se "Diskriminimi ndaj njerëzve me aftësi të kufizuar ekziston në të gjitha sferat e jetës publike dhe private, e theksuar kryesisht në fushën e punësimit, arsimimit, aksesit në shërbime dhe strehimit, aksesueshmërisë fizike dhe asaj në informacion"[103]. Pavarësisht përpjekjeve, problem shqetësues mbetet aksesi i PAK, përfshirë gratë, në institucionet e drejtësisë dhe strukturat qeveritare në nivel qendror dhe lokal, për shkak të mungesës së përshtatjes së ndërtimeve. Organizata të shoqërisë civile që mbështesin gratë me AK raportojnë se gratë me aftësi të kufizuar përballen me diskriminimin e dyfishtë, për shkak të gjinisë si edhe për shkak të aftësive të kufizuara. Ato janë më të izoluara se burrat me AK, braktisen nga burrat kur kanë fëmijë me AK, kanë akses të ulët në shërbime, në tregun e punës dhe ndihmën juridike."Gratë me AK përballen më shumë me dhunë psikologjike nga familjet e tyre. Ato qëndrojnë më shumë në shtëpi. Duke qenë të përjashtuara nga shoqëria, ato, për rrjedhojë dhunohen ne çdo aspekt të jetës"[104]. Gratë dhe vajzat me paaftësi mendore ka më shumë mundësi të dhunohen dhe të përballen me dhunë

103 http://kmd.al/skedaret/1394541003-Raporti%20vjetor%202013.pdf, fq. 11.

104 Cani Drenofci, B (2012), Field notes on women with disabilities in the E&E region (Albania), fq.10.

seksuale në mënyrë të veçantë [105].

178. Viti 2013 ka pasur jo pak vështirësi për personat me aftësi të kufizuar, nga të cilat mund të përmendim vonesat e krijuara disa herë për pagesën e paaftësisë, si dhe për kompensimin e energjisë elektrike, shpenzimeve telefonike, transportit urban dhe interurban, të parashikuara në legjislacionin në fuqi[106].

179. Gratë me AK nuk kanë aksesin e duhur në shërbimet sociale. Shërbimet sociale ekzistuese nuk janë të mjaftueshme në numër dhe kanë një shpërndarje gjeografike jo lehtësisht të aksesueshme nga një numër grash me AK, ndër të cilat gratë me AK që banojnë në zonat e thella rurale. Nga inspektimet e kryera nga institucioni i AP në 9 (nëntë) qendra të përkujdesit social gjatë vitit 2014 është konstatuar se mungon trajtimi i specializuar i grave me probleme të rënda të shëndetit mendor dhe kapaciteti i nevojshëm i stafeve të këtyre qendrave për të adresuar nevojat e tyre në mënyrë të përshtatshme, sipas diagnozave të ndryshme. Mungojnë vlerësime të nevojave të grupeve të ndryshme si grave me AK që banojnë në zonat rurale, grave me probleme të rënda të shëndetit mendor, grave me AK kryefamiljare, etj.

180. PAK, përfshirë gratë me AK përballen me diskriminim në tregun e punës, pavarësisht nivelit të ulët të raportimit. “Nuk është respektuar neni 15 i Ligjit nr. 7995, “Për nxitjen e punësimit” dhe nuk është respektuar përgjithësisht raporti: 1 PAK i punësuar në çdo 24 persona”[107]. Me VKM nr. 248, datë 30.04.2014, “Për programin e nxitjes së punësimit të personave me aftësi të kufizuar”, i ndryshuar, zyrat e punësimit financojnë për punësimin e personave me aftësi të kufizuar, ndër të cilat edhe gratë me aftësi të kufizuar. Ky vendim i miratuar në prill të vitit 2014 ka gjetur një zbatim të pjesshëm dhe është pilotuar si fillim vetëm në dy qytete kryesore, Tiranë dhe Elbasan. Në vitin 2015, VKM do t`i shtrijë efektet në të gjitha qarqet në RSH. Nga vëzhgimet e FSHDPAK rezulton që niveli i njohjes së tij ka qenë i ulët edhe në komunitetin e personave me aftësi të kufizuar, por edhe nga punëdhënësit potencialë[108].

181. Pavarësisht tarifave falas në sistemin e formimit profesional publik të grave me AK, infrastruktura fizike e qendrave të formimit profesional nuk është në nivelin e duhur, duke sjellë efekte në përfitimin nga ky sistem.

182. Duke vlerësuar se me ndryshimet në ligjin për ndihmën dhe shërbimet shoqërore gratë me AK, nëna të vetme apo kryefamiljare trajtohen me shërbime mbështetëse nga qendrat publike komunitare, (cituar edhe në raportin e katërt periodik kombëtar mbi zbatimin e Konventës CEDAW) konstatojmë se mungojnë monitorime gjinore në vazhdimësi të zbatimit të ndryshimeve në këtë ligj dhe identifikimi i numrit të përfitueseve gra nga ky grup.

183. Të dhëna mbi PAK janë jashtëzakonisht fragmentare dhe nuk janë të ndara sipas gjinisë[109].

*Në lidhje me mekanizmin antidiskriminim:*

184. Nga ankesat e paraqitura pranë KMD për vitin 2013 dhe ato të mbartura nga viti 2012, rezultojnë 23 ankesa për shkelje të të drejtave të PAK. Raporti vjetor 2013 i KMD thekson se “Punësimi i personave me aftësi të kufizuar vazhdon të jetë problematik”, megjithëse nuk raportohet asnjë ankesë për diskriminim nga ana e personave me aftësi të kufizuar[110].

*1.10.1. Rekomandime në lidhje me kuadrin ligjor:*

185. Rekomandohet harmonizimi i vazhdueshëm i legjislacionit të brendshëm

105 USAID, “Gratë me AK në rajonin e Evropës dhe Euro-Azisë”, 2012, fq. 28.

106 Raport vjetor “Për veprimtarinë e Avokatit të Popullit”, viti 2013, fq. 15. (nr. 65, datë 21.02.2014)

107 AP, “Raport i posaçëm i veprimtarisë së Avokatit të Popullit për punësimin e personave me aftësi të kufizuar (PAK), në institucionet e pushtetit qendror e atij lokal”, fq. 10, Prill 2013.

108 FSHDPAK, “Objektivat e programit qeverisës dhe planet për aftësinë e kufizuar”. Raport vëzhgimi. dhjetor 2014, fq. 28.

109 USAID, “Gratë me AK në rajonin e Evropës dhe Euro-Azisë”, 2012, fq. 5.

110 http://kmd.al/skedaret/1394541003-Raporti%20vjetor%202013.pdf, fq. 15.

me KDPAK. Me qëllim rritjen e aksesit të personave me aftësi të kufizuara në sistemin e drejtësisë, rekomandohen ndryshime ligjore që konsistojnë në shtimin e një dispozite specifike në Kodin e procedurës civile, Kodin e procedurës penale, Kodin e procedurave administrative për të garantuar akses të PAK në procesin gjyqësor civil, në procesin gjyqësor penal dhe pjesëmarrjen në procedura administrative. Gjithashtu, AP ka rekomanduar të plotësohen dispozitat specifike në Ligjin "Për noterinë", për të garantuar shprehjen e plotë dhe të pandikuar të vullnetit të PAK në hartimin e një akti noterial.

186. Rekomandohet hartimi i një akti nënligjor, në zbatim të Ligjit nr. 7995/1995 "Për nxitjen e punësimit", i cili të përcaktojë hollësisht rregullat, mënyrën dhe procedurën e derdhjes së pagës minimale në fondin kombëtar të punësimit. AP konstaton se ky akt është i vonuar, pasi Këshilli i Ministrave autorizohet drejtpërsëdrejti për nxjerrjen e një akti të tillë.

187. Rekomandohet marrja e masave nga MMSR, në zbatim të VKM nr. 837, datë 3.12.2014, me qëllim përcaktimin e detyrimeve të institucioneve që duhet të ofrojnë shërbimin e gjuhës së shenjave.

*Në lidhje me situatën faktike:*

188. Zbatimi i ligjit të ri kuadër kërkon përmirësime të konsiderueshme në infrastrukturë dhe qasje të barabartë në shërbime[111].

189. Rekomandohet sigurimi i përshtatshmërisë së ambienteve për PAK, në vendin e punës, duke mundësuar kështu heqjen e barrierave dhe akses të barabartë me të tjerët.

190. Të dhënat në lidhje me punësimin e PAK nga institucionet publike dhe private rekomandohet të jenë të ndara sipas gjinisë. Gjithashtu, mbledhja e të dhënave të mos kryhet vetëm në bazë të përfitimeve nga skemat sociale, por rekomandohet të kryhet edhe për fusha të ndryshme si dhuna në familje, punësimi, shërbimet sociale dhe shëndetësore, aksesi në drejtësi, ndjekja e arsimit të detyruar, etj.

191. Autoritetet shtetërore përgjegjëse, Inspektorati Shtetëror i Punës rekomandohet të kontrollojnë zbatimin nga punëdhënësit të dispozitave ekzistuese, (Ligji 7995/1995 "Për nxitjen e punësimit") në mënyrë që të garantojnë edhe zbatimin në praktikë të dispozitës, nga punëdhënësit publik apo privatë[112].

192. Rekomandohet kryerja e monitorimeve të vazhdueshme mbi zbatimin e ndryshimeve në ligjin për ndihmën dhe shërbimet shoqërore, në lidhje me përfitimin e grave me AK, nëna të vetme apo kryefamiljare që trajtohen me shërbime mbështetëse nga qendrat publike komunitare, si edhe mbi zbatimin e ndryshimeve ligjore të fundit.

193. Rekomandohet ngritja e qendrave rehabilituese dhe shërbimeve komunitare për gratë me AK mendore në gjendje të rëndë.

*Në lidhje me mekanizmin antidiskriminim:*

194. Rekomandohet që të rritet niveli i njohurive të grave me AK në lidhje me mjetet ligjore që ofron Ligji "Për mbrojtjen nga diskriminimi" (2010) dhe rolin që luan KMD dhe gjykata në adresimin e rasteve të diskriminimit, për shkak të AK si dhe diskriminimit të shumëfishtë.

195. Të rritet roli i organizatave jofitimprurëse në përdorimin e mekanizmit antidiskriminim, përmes paraqitjes së ankesave në emër të grave me AK ose informacioneve mbi situata diskriminimi ndaj tyre.

### 1.11. Gratë në institucionet penitenciare.

196. Nga inspektimet e kryera ka rezultuar se nuk është përmbushur detyrimi ligjor për ngritjen e dhomave të shoqërimit të veçanta për gratë në disa njësi policore.

197. Ligji nr. 40/2014 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8328, datë 16.4.1998, 'për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve

111 http://www.integrimi.gov.al/al/dokumenta/progres-raporte/progres-raporti-2014&page1

112 Avokati i Popullit, "Road map", Për zbatimin e reformave të nevojshme për 5 prioritet kyçe për procesin e integrimit në Bashkimin Evropian, fq. 16-17.

me burgim dhe të paraburgosurve', të ndryshuar" parashikon detyrimin për të trajtuar gratë e paraburgosura dhe të dënuara, duke respektuar liritë dhe të drejtat themelore pa diskriminim. Ky ligj parashikon ofrimin e masave të mbrojtjes, mbështetje dhe këshillime ligjore për të paraburgosurit dhe të dënuarit që kanë pasur përvoja të dhunës fizike, psikologjike ose seksuale, para ose gjatë qëndrimit në institucion. Individualizimi i trajtimit kërkon respektimin e nevojave specifike gjinore të grave. IEVP, (institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale) në bashkëpunim me shërbimin e provës, shërbimet e mirëqenies sociale, organet vendore dhe organizatat jofitimprurëse kanë detyrimin ligjor të hartojnë programe riintegrimi prag-lirimi për adresimin e çështjeve gjinore. Gratë e dënuara dhe të paraburgosura përbëjnë një kategori të veçantë në këtë ligj që duhet të përfitojë kujdes të plotë shëndetësor, që përfshin kujdesin shëndetësor mendor, riprodhues, trajtim për abuzimet seksuale që mund të kenë pësuar gratë para pranimit në institucion, etj. Ky ligj përcakton kryerjen e kontrollit të grave dhe të miturave të paraburgosura ose të dënuara vetëm nga stafi me të njëjtën gjini.

198. Mekanizmi kombëtar për parandalimin e torturës gjatë vitit 2014 ka qenë pjesë aktive e grupit të punës mbi reformën në burgje, të drejtuar nga Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me prezencën e OSBE-së në Shqipëri. Në bashkëpunim me DPB-në, është mundësuar instalimi i kutive postare për ankesat e personave të privuar nga liria në të gjitha institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale (IEVP-të) të vendit, me qëllim mundësimin e dërgimit të drejtpërdrejtë të ankesave dhe kërkesave pranë AP, nga vetë të dënuarit dhe të paraburgosurit, përfshirë gratë.

199. Nga inspektimet e institucionit të AP ka rezultuar se disa nga problemet me të cilat janë përballur gratë në institucionet penitenciare deri në vitin 2014 si mbipopullimi, mangësi në infrastrukturën e godinave, mungesë të ambienteve të përshtatshme për takimin me fëmijët e mitur, etj., janë zgjidhur me përshtatjen e institucionit të vuajtjes së dënimit "Ali Demi" në Tiranë për gratë e paraburgosura dhe të burgosura, në dhjetor 2014. Në inspektimin e këtij institucioni në vitin 2015 u arrit në përfundimin se gratë në institucionet penitenciare përballen me nevojën për një shërbim ligjor më cilësor, probleme me takimin e fëmijëve në institucionet e përkujdesit shoqëror, mungesa në trajtimin me produkte personale të higjienës, etj.

Gjithashtu, gratë që sipas vendimit gjyqësor duhet të marrin mjekim të detyrueshëm shëndetësor në një mjedis spitalor, për shkak të mungesës së një institucioni të posaçëm mjekësor mbahen në sektorë të veçantë të krijuar në institucionet e vuajtjes së dënimit si dhe në institucionet shëndetësore të burgjeve në Tiranë, në kundërshtim më legjislacionin dhe standardet ndërkombëtare të shëndetit mendor. Gjatë inspektimeve të AP në institucionet shëndetësore të burgjeve rezultoi se nuk ishte kryer ndarja e pacientëve në sektorë të veçantë për të paraburgosur e të burgosur sikurse parashikojnë standardet, mungonte ambienti i përshtatshëm dhe në përputhje me standardet për takimet e pacientëve me familjarët e rritur dhe të mitur, dhomat e regjimit të brendshëm nuk ishin të pajisura me zile elektronike për komunikim në raste emergjence, dhomat e pacientëve nuk ishin të pajisura siç duhet me orendi, çarçafë, dyshekë, karrige e tavolina, mungonte mbulimi me sistem ngrohje, mungonin ambientet e përbashkëta për të mundësuar zhvillimin e aktiviteteve fetare, kulturore dhe sportive nga ana e sektorit të kujdesit psikosocial, mungonte një fond rezervë për të sëmurët me sëmundje tumorale, trajtimi i të cilëve kërkon medikamente të kushtueshme etj.

*1.11.1. Rekomandime:*

200. Rekomandohet marrja e masave për përmbushjen e detyrimit ligjor për ngritjen e dhomave ose seksioneve të veçanta për gratë në të gjitha komisariatet e policisë.

201. Rekomandohet që standardet e parashikuara në ligjin nr. 40/2014, "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 8328, datë 16.4.1998, 'për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim

dhe të paraburgosurve', të ndryshuar", të shërbejnë si tregues të monitorimit të punës së Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe IEVP në lidhje me respektimin e të drejtave të grave të dënuara me burgim dhe të paraburgosura.

202. Disa rekomandime për IEVP Ali Demi[113] janë: Marrja e masave për pajisjen e institucionit me regjistrin e dokumentimit të rasteve të ushtrimit të dhunës; Marrja e masave për garantimin e kontakteve të shpeshta të juristit me të paraburgosurat dhe të dënuarat, në mënyrë që të mundësohet informimi i tyre mbi procedurat e përfitimit nga lejet shpërblyese e të veçanta, shërbimi i provës, etj. Marrja e masave për pajisjen e të dënuarave/paraburgosurave me paketa bazë të higjienës vetjake si dhe të higjienës sanitare.

203. Disa rekomandime për institucionin e veçantë shëndetësor të burgjeve Tiranë[114] janë: marrja e masave urgjente për rikonstruksionin e plotë të institucionit të veçantë shëndetësor të burgjeve Tiranë, pasi ky është një institucion që ofron kryesisht shërbim shëndetësor, ndaj dhe kushtet e trajtimit të pacientëve duhet të përmbushnin standardet e një shërbimi shëndetësor të përshtatshëm, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut; marrja e masave për shtimin në organikë të personelit të mesëm mjekësor, duke pasur parasysh kategorinë e veçantë të personave që trajtohen në këtë institucion; marrja e masave për shtimin në organikë të një stomatologu në mënyrë që të ofrohet një shërbim i përshtatshëm dentar; marrja e masave për krijimin e një fondi rezervë për të sëmurët me sëmundje tumorale, trajtimi i të cilëve kërkon medikamente të kushtueshme; marrja e masave për shtimin e organikës së stafit policor në mënyrë që të bëhet shoqërimi i të sëmurëve në qendrat e tjera spitalore brenda QSUT-së, pa cenuar kushtet e sigurisë;

113 Rekomandimet për IEVP Ali Demi janë dërguar me shkresën nr. K4/I35-2 prot., datë 02.09.2015.

114 Rekomandimet për institucionin e veçantë shëndetësor të burgjeve (IVSHB) janë dërguar me shkresën nr. K4/I6-2 prot., datë 22.01.2015.

204. Rekomandohet forcimi i kapaciteteve njerëzore me specialistë për trajtimin e individualizuar të grave të dënuara me burgim dhe të paraburgosura. Psikologë, punonjës socialë, mjekë të shëndetit riprodhues etj., nevojiten për të përmbushur nevojat e grave të këtij grupi për kujdes social dhe shëndetësor.

### 1.12. Gra/vajza të ngujuara.

205. Institucioni i AP në vazhdimësi ka ngritur shqetësimin e gëzimit të së drejtës për punë, të drejtës për arsim, për përfitimin e shërbimit shëndetësor nga shtetasit e ngujuar, ndër të cilët edhe nga gratë[115].

*1.12.1. Rekomandime*

206. Rekomandohet marrja e masave efektive për garantimin e të drejtës për punë, përfitimin e shërbimeve shëndetësore, të drejtës për arsim të grave dhe vajzave të ngujuara.

### 1.13. Gratë emigrante.

207. Strategjia "Për riintegrimin e shtetasve shqiptarë të kthyer në vend 2010- 2015" dhe plani i veprimit krijojnë mekanizma mbështetës për emigrantët.

208. Vendimi nr. 48, datë 16.01.2008, i ndryshuar, "Për masën dhe kriteret e përfitimit nga programi i nxitjes së punësimit të punëkërkuesve të papunë në vështirësi", parashikon përfitimin nga ky program të punëkërkuesve të papunë në vështirësi, duke përfshirë edhe emigrantët e kthyer, me probleme ekonomike. Edhe Vendimi nr. 27, datë 11.01.2012, "Për programet e nxitjes së punësimit të femrave nga grupet e veçanta", i ndryshuar përcakton si përfituese të këtij programi femrat punëkërkuese nga grupet e veçanta, duke përfshirë edhe femra që kthehen nga emigracioni, me probleme ekonomike.

*1.13.1. Rekomandime:*

209. Rekomandohet monitorimi në vazhdimësi i zbatimit të Strategjisë "Për riintegrimin

115 AP, Raport i veçantë "Mbi fenomenin e gjakmarrjes", fq.7. (nr.28/4, datë 22.04.2013) http://www.parlament.al/web/pub/2013_raporti_per_gjakmarrjen_15419_1.pdf

e shtetasve shqiptarë të kthyer në vend 2010- 2015" dhe Plani i Veprimit, edhe nga perspektiva gjinore.

210. Rekomandohet monitorimi në vazhdimësi i zbatimit të programeve të nxitjes së punësimit, që synojnë të nxisin punësimin e emigrantëve të kthyer, ndër të cilët emigrantet gra.

# C. FUQIZIMI EKONOMIK[116]

Neni 11 i Konventës CEDAW, paragrafi 32, 33 i vp të Komitetit CEDAW

Fuqizimi ekonomik i grave është i lidhur ngushtësisht me garantimin e të drejtës për punë, të drejtës për shpërblim të barabartë, sigurime shoqërore, siguri në punë dhe mbrojtjes nga diskriminimi gjinor në marrëdhëniet e punës.

## 1. Kuadri ligjor, zhvillimet dhe nevojat për përmirësimin e tij në lidhje me barazinë dhe mosdiskriminimin në marrëdhëniet e punës.

211. Kushtetuta e RSH-së, në kreun IV, "Liritë dhe të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore", neni 49, sanksionon të drejtën e secilit të fitojë mjetet e jetesës së tij me punë të ligjshme, që e ka zgjedhur ose pranuar vetë si edhe lirinë e çdo individi të zgjedhë profesionin, vendin e punës, si dhe sistemin e kualifikimit profesional. Kushtetuta e RSH-së garanton për të punësuarit të drejtën e mbrojtjes shoqërore të punës.

212. Një nga kërkesat e nenit 77 të MSA, "Kushtet e punës dhe mundësi të barabarta" është harmonizimi i legjislacionit të brendshëm me atë të BE-së në fushën e kushteve të punës, të shëndetit dhe sigurisë në punë dhe mundësive të barabarta. Kodi i punës përshkohet nga parimi i barazisë gjinore dhe mosdiskriminimit në fushën e punësimit. Ai parashikon një mbrojtje të veçantë për punëmarrëset, gra shtatzëna, gra me fëmijë në gji, etj.

213. Ligji nr. 9970, datë 24.7.2008, "Për barazinë gjinore në shoqëri" synon të eliminojë diskriminimin në fushën e punësimit, duke kërkuar trajtim të barabartë të punëmarrësve në marrëdhëniet e punës, mundësi të barabarta për punë, punësim pa diferencime për shkaqe gjinore, detyrime të punëdhënësit dhe të drejtat e punëmarrësit. Ky ligj parashikon masa të veçanta të përkohshme, që synojnë arritjen e barazisë midis dy gjinive në marrëdhëniet e punës. Ligji përcakton detyrimet e punëdhënësit për të mbrojtur punëmarrësit nga diskriminimi, ngacmimi dhe shqetësimi seksual.

214. Ligji nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil" synon të garantojë të drejtat e nëpunësve të këtij shërbimi, bazuar në parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit.

215. Ligji nr. 10221, datë 4.2.2010, "Për mbrojtjen nga diskriminimi" ka rregulluar zbatimin e parimit të barazisë gjinore në punësim.

216. Ligji, Nr. 7995, datë 20.9.1995, "Për nxitjen e punësimit" ka si qëllim të tij ndjekjen e politikave aktive në lidhje me punësimin, formimin e kualifikimin profesional. Në zbatim të këtij ligji janë miratuar vendime të Këshillit të Ministrave që fuqizojnë ekonomikisht gratë, në mënyrë të veçantë gratë nga grupet e veçanta. Vendimi nr. 27, datë 11.01.2012, i ndryshuar me VKM nr. 189, datë 2.4.2014 dhe VKM nr. 4509, datë 9.7.2014, "Për programin e nxitjes së punësimit të femrave nga grupet e veçanta" parashikon si përfituese të këtij programi femrat punëkërkuese nga grupet e veçanta. Femrat nga grupe të veçanta që përfitojnë nga ky program janë: a) femra të papuna për një periudhë afatgjatë (të regjistruara, si punëkërkuese të papuna për më shumë se një vit); b) femra që përfitojnë nga programet e mbështetjes me të ardhura; c) femra të trafikuara; ç) femra mbi 50 vjeç; d) femra rome; dh) femra me aftësi të kufizuara; e) vajza nëna; ë) femra të

116 Disa nga çështjet e trajtuara janë punësimi, programet aktive të punësimit, formimi profesional, sigurimet shoqërore dhe mundësitë e barabarta në marrëdhëniet e punës. neni 11 i Konventës CEDAW, paragrafi 32, 33 dhe 36 i VP të Komitetit CEDAW, rekomandimi i përgjithshëm nr. 13 si edhe çështje të nenit 2 të Konventës CEDAW kanë mbështetur analizën e çështjes.

divorcuara me probleme sociale; f) femra që kthehen nga emigracioni me probleme ekonomike. VKM nr. 248, datë 30.04.2014 parashikon se zyra përkatëse e punësimit financon për punësimin e personave me aftësi të kufizuara si edhe për formimin në punë të personave me aftësi të kufizuar. Në përfundim të periudhës së formimit, punëdhënësit duhet të punësojnë jo më pak se 30% të të trajnuarve, për një periudhë 6-mujore. Ky program është zbatuar për herë të parë gjatë vitit 2014. VKM nr. 48, datë 16.01.2008, "Për masën dhe kriteret e përfitimit nga programi i nxitjes së punësimit të punëkërkueseve të papunë në vështirësi", e ndryshuar, si subjekte përfituese në punëkërkuesit e papunë në vështirësi përcakton edhe personat me aftësi të kufizuar si edhe personat nga komuniteti rom. Me VKM nr. 199, datë 11.02.2012, i ndryshuar, "Për masën e financimit, kriteret dhe procedurat e zbatimit të programit të nxitjes së punësimit të PuPa të rinj" synohet mbështetja e të rinjve dhe të rejave për punësim. Me VKM nr. 873, datë 27.12.2006, i ndryshuar, "Për masën e financimit, kriteret dhe procedurat e zbatimit të programeve të praktikave profesionale për PuPa, që kanë mbaruar arsimin e lartë, brenda apo jashtë vendit", parashikohet se PuPa që kanë përfunduar arsimin e lartë brenda apo jashtë vendit, të cilët kanë më pak se 24 muaj nga diplomimi, përfitojnë praktika profesionale falas.[117]

217. Urdhri i ministrit (MMSR), nr. 286/16.12.2013 "Për tarifat e sistemit të formimit profesional publik" parashikon tarifa falas për të gjithë PuPa nga muaji dhjetor 2013, duke sjellë efekte edhe tek PuPa femra.

218. Programet e pagesës së papunësisë mbështesin financiarisht të gjithë PuPa në rast papunësie, përfshirë gratë.

*Nevoja për përmirësimin e legjislacionit:*

219. Pavarësisht zhvillimeve në legjislacion, ka ende vend për përmirësime në lidhje me garantimin e parimit të barazisë gjinore dhe mosdiskriminimit në marrëdhëniet e punës. AP ka paraqitur rekomandime për ndryshime në Kodin e punës. Gjatë trajtimit të ankesave, disa prej të cilave janë paraqitur nga gra, lidhur me të drejtën shoqërore për punë, institucioni i AP ka konstatuar se, përveç shkeljeve në zgjidhjen e marrëdhënieve të punës, ka pasur edhe veprime të përsëritura të punëdhënësit për cenim të të drejtës së punës ndaj punëmarrësit. Në këto raste, krahas dëmtimit të interesave të ligjshme socialekonomike të individëve (nëpërmjet uljes së pagës, apo largimeve nga puna), është shkaktuar edhe një gjendje jo e mirë e shëndetit ose cenim i dinjitetit të tij psikologjik, të cilat kanë çuar në uljen e rendimentit të punës, duke vijuar më tej edhe me dëmtim të shëndetit fizik e mendor të individëve. AP ka rekomanduar[118] plotësimin e Ligjit nr. 7961 datë 12.07.1995, "Kodi i punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, në nenin 32 të tij duke shtuar si dispozitë ligjore në pikën 4 edhe ngacmimin moral të punëmarrësit, nga ana e punëdhënësit, i cili me veprime të përsëritura ka si qëllim shkatërrimin ose degradimin e kushteve të punës, duke i cenuar të drejtat dhe dinjitetin/moralin si dhe duke dëmtuar shëndetin fizik dhe mendor të tij. Ky rekomandim është paraqitur pranë Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë si edhe i është dërguar për shqyrtim Ministrisë së Drejtësisë. Ky rekomandim është pranuar dhe është bërë pjesë e draft-ligjit mbi ndryshimet në Kodin e punës. Ky draft-ligj pritet të miratohet nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

220. Barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi palët e interesuara, sipas nenit 82 të Kodit të procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë. Kodi i punës në nenin 115, "Barazi në shpërblim midis sekseve" parashikon se, kur punëmarrësi parashtron të dhëna serioze për diskriminim punëdhënësi është i detyruar të provojë të kundërtën. Është parashikuar si një mënyrë për të eliminuar diskriminimin akordimi për punëmarrësin

117 Informacionet në lidhje me programet e nxitjes së punësimit janë të aksesueshme edhe on line në web: http://www.shkp.gov.al

118 AP, Rekomandohet plotësimi i nenit 32 të Ligjit Nr. 7961 datë 12.07.1995, "Kodi i punës i Republikës së Shqipërisë", (i ndryshuar), 2013. nr. dok. 201301585/2.

e diskriminuar i një shpërblimi që përfshin të gjitha avantazhet që ka punëmarrësi i seksit tjetër. Neni 105/1, pika 2 i Kodit të punës parashikon se, në rastet e zgjidhjes së kontratës së punës nga punëdhënësi, kur gruaja është në punë gjatë periudhës së shtatzënisë ose është kthyer në punë pas lindjes së fëmijës, i takon punëdhënësit të vërtetojë se shkaku i pushimit nga puna nuk ka qenë shtatzënia ose lindja e fëmijës". Pavarësisht kësaj dispozite, legjislacioni ynë i brendshëm nuk është në përputhje të plotë me të drejtën e BE-së në lidhje me standardin e barrës së provës. Edhe Ligji nr. 10221, datë 4.2.2010, "Për mbrojtjen nga diskriminimi" në nenin 36, "Procedurat para gjykatës", parashikon se paditësi ka detyrim të sjellë prova në mbështetje të padisë. "…barra e provës gjendet në mënyrë fragmentare dhe jo si një standard gjithëpërfshirës në rastet e diskriminimit. Mungon ky standard në Ligjin për barazinë gjinore {2008} dhe në atë të masave ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare. {2006, ndryshuar}. Mungesa e praktikës gjyqësore kundrejt këtyre ligjeve tregon se ende ka vështirësi dhe ende nuk janë bërë të zbatueshme standardet e barrës së përmbysur të provës, të paktën në ligjet që e kanë përfshirë këtë standard[119]". AP ka rekomanduar përfshirjen në fund të nenit 9 të Ligjit nr. 7961/1995, "Kodi i punës", i ndryshuar, të një paragrafi të ri, ku të përcaktohet se pala mbi të cilën bie barra e provës për rastet kur pretendohet se ka pasur diskriminim mbi personin është punëdhënësi[120]. Ky rekomandim është pranuar dhe bërë pjesë e draft-ligjit "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995, 'Kodi i punës i Republikës së Shqipërisë' i ndryshuar, miratuar nga Këshilli i Ministrave në datën 8.4.2015. Draft-ligji pritet të miratohet nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

221. Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, "Kodi i punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar përfshin ndryshime dhe shtesa të rëndësishme në lidhje me çështjet gjinore si, mbrojtjen nga të gjitha format e diskriminimit të parashikuara në ligjin "Për mbrojtjen nga diskriminimi", duke përfshirë çdo shkak që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të së drejtës për punësim dhe profesion.

222. AP ka shprehur qartë nevojën e përmirësimit të kuadrit ligjor për mbrojtjen nga diskriminimi në punë. Ligji nr. 10221, datë 4.2.2010, "Për mbrojtjen nga diskriminimi" rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër. AP ka rekomanduar ndryshime në ligjin "Për mbrojtjen nga diskriminimi" (2010), që përfshijnë si shkaqe për diskriminim, kombësinë, një qëllim të shpallur për të diskriminuar; nxitjen për diskriminim dhe ndihmesën dhe inkurajimin e diskriminimit[121]. Këto propozime ligjore ende nuk janë pranuar dhe bërë pjesë e ligjit "Për mbrojtjen nga diskriminimi". Statusi i këtij rekomandimi është: i pazbatuar.

*Në lidhje me ngacmimet seksuale dhe morale në vendin e punës:*

223. Kodi i punës[122], Ligji nr. 9970, datë 24.07.2008, "Për barazinë gjinore në shoqëri" dhe Ligji nr. 10221, datë 4.02.2010, "Për mbrojtjen nga diskriminimi" parashikojnë mbrojtjen e punëmarrësit nga veprimet diskriminuese

119 Prof.dr.Arta Mandro, Statusi i realizimeve të vërejtjeve përmbyllëse të Komitetit CEDAW. Periudha: nga shqyrtimi i raportit të tretë periodik të Shqipërisë [korrik 2010-deri në nëntor 2012], fq. 8.

120 Avokati i Popullit, "Road map", Për zbatimin e reformave të nevojshme për 5 prioritet kyçe për procesin e integrimit në Bashkimin Evropian, fq. 10.

121 Rekomandimi nr. 97, datë 05.04.2013. Relacion për disa përmirësime në Ligjin nr. 10221 datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi". Dërguar Ministrisë së Drejtësisë dhe MPCSSHB.

122 Miratuar me Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, i ndryshuar.

të punëdhënësit, duke përfshirë edhe ngacmimin seksual në vendin e punës. Në ligjin "Për mbrojtjen nga diskriminimi" parashikohet dhe detyrimi i punëdhënësit për mbrojtjen e punëmarrësit nga ngacmimet seksuale të punëmarrësve të tjerë si edhe parashikimet e nevojshme në kontratat e punës. AP ka paraqitur rekomandime për ndryshime në Kodin penal lidhur me shtimin e dispozitave penale për "ngacmimin seksual" dhe "ngacmimin moral në punë". AP ka rekomanduar shtimin e dispozitës penale me përmbajtje: 1. "Ngacmimi seksual", me përmbajtje si vijon: "Ngacmimi i një personi me qëllim përfitimin e favoreve të një natyre seksuale dënohet me burgim nga tre deri në shtatë vjet. Kur ngacmimi seksual kryhet prej punëdhënësit, eprorit apo kushdo me të cilin viktima ka një status të veçantë varësie, dënohet me burgim nga pesë deri në 10 vjet" dhe 2."Ngacmimi moral në punë" me përmbajtje si vijon: "Ngacmimi i dikujt nëpërmjet veprimeve të përsëritura që kanë për qëllim ose sjellin si pasojë degradimin e kushteve të punës në një shkallë të tillë që mund të çojë në cenimin e të drejtave dhe të dinjitetit të personit, në prishjen e shëndetit të tij fizik ose mendor ose në dëmtimin e të ardhmes së tij profesionale, dënohet me burgim deri në pesë vjet". Këto rekomandime i janë dërguar Ministrisë së Drejtësisë. Kështu, me Ligjin nr. 144/2013, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 'Kodi penal i Republikës së Shqipërisë', të ndryshuar, neni 24, është shtuar neni 108/a, "Ngacmimi seksual", në përmbajtjen e të cilit nuk është parashikuar rasti i kryerjes së ngacmimit seksual prej punëdhënësit, eprorit apo kushdo me të cilin viktima ka një status të veçantë varësie. Pra, statusi i këtij rekomandimi është: pjesërisht i zbatuar. Statusi i rekomandimit të institucionit të AP për shtimin e dispozitës penale "Ngacmimi moral në punë" është: i pazbatuar. Në lidhje me ngacmimin moral në punë, institucioni i AP është mbështetur në problematikat e konstatuara në veprimtarinë e institucionit, e në mënyrë të veçantë trajtimit të ankesave në lidhje me mbrojtjen shoqërore të punës. Nga trajtimi i një numri ankesash dhe monitorimet e vazhdueshme që institucioni ynë ka kryer në organet e administratës publike është pretenduar cenimi i të drejtës së punës, për shkak të ushtrimit të një dhune psikologjike apo presioneve të vazhdueshme nga punëdhënësi, duke përdorur si kërcënim masat disiplinore, heqjen nga puna, gjoba, ulje rroge, etj. Duke e gjykuar shtimin e dispozitës së "Ngacmimit moral në punë" si të domosdoshme, institucioni ynë do të vazhdojë punën me qëllim zbatimin e këtij rekomandimi[123]. Zbatimi i këtij rekomandimi do të sillte efekte disproporcionale tek gratë, sepse gratë përballen më së shumti me ngacmimet morale në punë.

*Në lidhje me raportimin e ngacmimeve seksuale në vendin e punës dhe përdorimin e mjeteve ligjore:*

224. AP konsideron barrën e provës për gratë në rastin e ngacmimeve seksuale në vendin e punës si një pengesë për të përdorur me efektivitet mjetet ekzistuese.

225. AP konsideron si hapa pozitive iniciativat për ta bërë adresimin e kësaj çështje pjesë të politikave në nivel qendror dhe vendor.

### 1.1. Rekomandime.

*Në lidhje me kuadrin ligjor dhe mbrojtjen nga diskriminimi në marrëdhëniet e punës:*

226. Rekomandohen përmirësime në ligjin "Për mbrojtjen nga diskriminimi", duke përfshirë si shkaqe për diskriminim kombësinë, një qëllim të shpallur për të diskriminuar dhe ndihmesën e inkurajimin e diskriminimit, si edhe në Kodin penal në lidhje me ngacmimin seksual të kryer nga punëdhënësi, eprori apo kushdo me të cilin viktima ka një status të veçantë varësie dhe ngacmimin moral në punë. Rekomandohet miratimi pa vonesë i ndryshimeve dhe shtesave në Kodin e punës, të cilat parashikojnë mbrojtje më të mirë të grave nga diskriminimi gjinor në punë, përmes parashikimit të mbrojtjes së punëmarrësit nga ngacmimi moral i kryer nga punëmarrës të tjerë. Përfshirja e bilbilfryrësve në Kodin e punës do të shërbente për identifikimin e rasteve

123 AP, "Propozim lidhur me një shtesë në projektaktin e përgatitur nga Ministria e Drejtësisë për ndryshime në Kodin penal", 2013.

të ngacmimit moral në vendin e punës dhe adresimin e tyre nga strukturat respektive[124].

*Mbi nxitjen e punësimit:*

227. Rekomandohet ndërmarrja e iniciativave në kuadrin e legjislacionit për nxitjen e punësimit, me qëllim përfshirjen si subjekte përfituese të grave, viktima të dhunës në marrëdhëniet familjare si edhe të përfaqësuesve të komunitetit LGBTI, përfshirë gratë.

*Në lidhje me raportimin e ngacmimeve seksuale në vendin e punës dhe përdorimin e mjeteve ligjore:*

228. Rekomandohet forcimi i rolit aktiv të medias, punëdhënësve, institucioneve arsimore, organizatave të shoqërisë civile, me synim rritjen e ndërgjegjësimit mbi raportimin e ngacmimeve seksuale në vendin e punës dhe përdorimin e mjeteve ligjore.

229. Miratimi i rekomandimit të AP mbi kalimin e barrës së provës tek punëdhënësit në rastin e ngacmimeve seksuale në punë do të rrisë përdorimin nga gratë të mjeteve ligjore dhe efektivitetin e tyre.

## 2. Në lidhje me sigurimet shoqërore, kuadri ligjor dhe nevoja për përmirësimin e tij.

230. E drejta për të përfituar nga ky sistem rregullohet me Ligjin nr. 7703 datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, si dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij.

231. Ligji nr. 7703, date 11.05.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, parashikonte diskriminim pozitiv për gratë në lidhje me moshën e daljes në pension.

232. Për të përmirësuar situatën e përfituesve, AP ka rekomanduar si të domosdoshme ndryshimin e formulës së llogaritjes së pensionit, me qëllim që të ketë një lidhje më të drejtpërdrejtë të përfitimeve me kontributet e paguara. AP i është drejtuar ministrit të Financave me rekomandim për marrjen e iniciativës ligjore, për ndryshimin dhe përmirësimin e Ligjit nr. 7703 datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, konkretisht të nenit 32 të tij, me qëllim që përfituesit e pensionit të pleqërisë të gëzojnë masën e pensionit të pleqërisë më të favorshëm për ta[125].

233. Është miratuar Ligji nr. 104/2014, datë 31.07.2014, "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, i cili do të sjellë ndryshime dhe shtesa me efekte edhe tek gratë. Për të gjithë shtetasit që dalin në pension pleqërie pas datës 01.01.2015, llogaritja e masës së pensionit të pleqërisë do të bëhet me formulën e re, bazuar në kontributet e derdhura në vite dhe pagën mbi të cilën paguhen kontributet.

234. Në lidhje më të ardhurën për barrëlindje është parashikuar që periudha e përfitimit do të jetë 365 ditë kalendarike, duke përfshirë një minimum prej 35 ditësh para dhe 63 ditësh pas lindjes së fëmijës. Ligji i ri synon një eliminim gradual të privilegjeve për gratë. Kështu, së pari, e drejta e njohjes e periudhës së studimeve të larta si vjetërsi pune për efekt pensioni për gruan njihet deri në 31.12.2032.[126] Pas kësaj date kjo e drejtë shuhet. Së dyti,

124 Këto sugjerime janë dërguar në komisionin parlamentar për çështjet ligjore, administratën publike dhe të drejtat e njeriut gjatë vitit 2015.

125 Raporti mbi veprimtarinë e Avokatit të Popullit, 1 janar-31 dhjetor 2013, (nr. 65, datë 21.02.2014). www.avokatipopullit.gov.al Rekomandimi për masën e pensionit të pleqërisë më të favorshëm është marrë në konsideratë. Me shkresën nr. 8492/3 datë 03.07.2013, Ministria e Financave i ka kthyer përgjigje institucionit tonë se ndryshimi i ligjit, sa i takon dhënies së pensionit më të favorshëm, shoqërohet me efekte të konsiderueshme financiare. Si pjesë e reformës së sigurimeve shoqërore, ky rekomandim pret të rishqyrtohet.

126 Ligji nr. 104/2014, datë 31.07.2014,"Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, neni 42. Sipas këtij neni, "Periudha e kryerjes së studimeve në shkollën e lartë, me shkëputje nga puna për gruan, duke filluar nga data 1.9.2000 dhe deri në 31.12.2032, pavarësisht nga vendi se ku janë kryer studimet dhe për jo më shumë se 6 vjet, njihet periudhë sigurimi, vetëm për efekt pensioni pleqërie".

mosha e daljes në pension për gratë rritet gradualisht, duke synuar të barazohet me moshën e daljes në pension të burrave. Mosha e pensionit u rrit për gratë me dy muaj në vit për t`u barazuar me moshën e pensionit për burrat. Në lidhje me kushtet e përfitimit të pensionit familjar, me gjithë ndryshimet e ligjit, vazhdon ekzistojë një diskriminim pozitiv. Një grua e ve përfiton pension familjar kur ka mbushur moshën 55 vjeç. Për burrat e ve mosha nuk ka ndryshuar dhe mbetet 60 vjeç, duke pasur një diferencë me 5 vjet midis burrave dhe grave të ve. Ligji përmbush një standard ndërkombëtar në lidhje me kujdesin prindëror ndaj fëmijëve. Kështu, pas 63 ditësh pas lindjes, të drejtën e lejes për kujdes ndaj fëmijës e ka edhe babai ose birësuesi i siguruar, nëse këtë të drejtë nuk e ushtron apo nuk ka kushte për ta përfituar nëna. Ky ndryshim ligjor pritet të kontribuojë në lidhje me ndryshimet në rolet gjinore në familje. Ky ligj ka hyrë në fuqi me botimin në Fletoren zyrtare nr. 137, datë 1.9.2014 dhe i shtrin efektet nga data 1.1.2015.

235. Çdo shtetas, pavarësisht nga gjinia, i cili ka mbushur moshën 70 vjeç dhe është me qëndrim të përhershëm në Shqipëri, të paktën për pesë vitet e fundit, nuk plotëson kushtet për asnjë lloj pensioni nga skema e detyrueshme e sigurimeve shoqërore dhe nuk ka të ardhura ose të ardhurat që përfiton nga çdo burim tjetër janë më të ulëta se të ardhurat që jep pensioni social, është subjekt përfitues i pensionit social. Nëse do të konsiderojmë se gratë janë ato që përballen me më shumë pabarazi në tregun e punës, ky ndryshim sjell efekte sidomos për gratë. AP ngre shqetësimin se në periudhën e tranzicionit shumë shtetas shqiptarë, në mënyrë të veçantë gratë, kanë qenë të papuna dhe nuk kanë paguar kontribute vullnetarisht. Gratë që nuk plotësojnë vitet e kontributeve për të përfituar pension pleqërie sipas ligjit të sigurimeve shoqërore do të mbeten pa asnjë të ardhur deri në moshën 70 vjeç, moshë e përfitimit të pensionit social.

236. Gjithashtu, parashikimi se "për të përfituar pension social personi duhet të jetë me qëndrim të përhershëm në Shqipëri, të paktën për pesë vitet e fundit, cenon drejtpërsëdrejti emigrantët shqiptarë, ndër të cilat edhe emigrantet gra.

237. AP ka shprehur shqetësimin se mungesa e përcaktimit të nivelit minimal të standardit të jetesës në Shqipëri është një pengesë shumë e madhe në përcaktimin e politikave sociale që ndjek shteti për grupet në nevojë[127]. Institucioni i Avokatit të Popullit i ka paraqitur një rekomandim kryeministrit të Shqipërisë, për ngritjen e një grupi pune për përcaktimin e këtij niveli. Ky rekomandim është në proces[128].

*Në lidhje me situatën faktike:*

238. Pjesëmarrja në tregun formal të punës është parakushti kryesor për mundësinë e marrjes së përfitimeve të pleqërisë, papunësisë, sëmundjeve afatshkurtra dhe mëmësisë. Sipas llogaritjeve, në sektorin informal punon një përqindje më e lartë femrash, krahasuar me meshkujt, duke çuar në mbulimin e dobët të femrave nga sistemi[129].

239. Janë paraqitur 123 ankesa në lidhje me sigurimet shoqërore pranë institucionit të AP për periudhën tetor 2013-tetor 2014[130]. Nga 101 ankesa të paraqitura

127 Komente dhe mendime të Avokatit të Popullit për progres-raportin e KE-së për Shqipërinë për 2014, Tiranë 2014, fq. 4. Procesverbali i mbledhjes dt. 12.11.2014 i komisionit për çështjet ligjore, administratën publike dhe të drejtat e njeriut, seancë dëgjimore me Avokatin e Popullit për progres-raportin e vitit 2014.

128 Me përgjigjen e Kryeministrisë në qershor 2014, jemi vënë në dijeni se një grup pune me drejtues dhe ekspertë do të japin rekomandime konkrete për mënyrën dhe procedurat që duhet të ndiqen për të përcaktuar nivelin minimal të standardit të jetesës në Shqipëri. Rekomandimet e grupit të punës do t'i përcillen ministrit të MSR, i cili në ushtrim të funksioneve të tij, do të ndërmarrë hapat konkretë për inicimin e akteve përkatëse për përcaktimin e minimumit jetik në Shqipëri.

129 Strategjia kombëtare për punësim dhe aftësi 2014-2020, miratuar me VKM nr. 818, datë 26.11.2014, "Për miratimin e strategjisë kombëtare për punësim dhe aftësi 2014 – 2020 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj", botuar në Fletoren zyrtare nr. 188/2014, fq. 10322.

130 Komente dhe mendime të Avokatit të Popullit për progres-raportin e KE-së për Shqipërinë për 2014, Tiranë 2014, fq.4. Procesverbali i mbledhjes dt. 12.11.2014 i komisionit për çështjet ligjore, administratën publike dhe të drejtat e njeriut, seancë dëgjimore me Avokatin e Popullit për progres raportin e vitit 2014.

pranë institucionit tonë në fushën e sigurimeve shoqërore gjatë vitit 2014, 16 janë paraqitur nga gratë. Ankesat kanë konsistuar në llogaritje të padrejtë të masës së pensioneve të pleqërisë, mosnjohjen e vjetërsisë së punës, uljen e masës së pensioneve të parakohshme për vjetërsi shërbimi dhe nxjerrjen debitorë të ankuesve për kohën e lindjes së të drejtës për të përfituar pensionin e pleqërisë, mosmarrjen e informacionit mbi shqyrtimin e kërkesave ankimore ndaj vendimeve të degëve të përfitimeve pranë drejtorive rajonale të sigurimeve shoqërore, ndërprerjen e padrejtë të pensioneve të pleqërisë, mosvënien në dispozicion të kopjeve të dokumentacionit të dosjes të pensionit etj.

### 2.1. Rekomandime.

240. Rekomandohet që përfitimi i pensionit social të fillojë me lindjen e së drejtës për përfitim të pensionit dhe jo në moshën 70 vjeç. Zbatimi i këtij rekomandimi do të sillte efekte mbështetëse tek gratë e moshuara, të cilat nuk kanë paguar kontribute dhe nuk kanë pasur mundësi të sigurohen vullnetarisht.

241. Rekomandohet që pensioni social të jetë një përfitim që t'i jepet çdo shtetasi shqiptar, përfshirë gratë, edhe pse nuk kanë 5 vjet qëndrimi të përhershëm në Shqipëri dhe nuk përfitojnë të ardhura nga shtetet ku ato kanë punuar si emigrante.

242. Rekomandohet që pensioni social të mos merret në konsideratë në llogaritjen e pensionit mujor të pleqërisë, pasi pensioni social është përcaktuar vetëm për kategorinë e personave, që nuk kanë arritur periudhën minimale të sigurimit dhe nuk përfitojnë asnjë lloj pensioni.

243. Nevojitet deklarimi i minimumit jetik, që mbi këtë bazë të kryhen llogaritjet përkatëse.

*Në lidhje me sigurinë dhe shëndetin në punë:*

244. Ndonëse, Ligji nr. 10237, datë 18.02.2010, "Për sigurinë dhe Shëndetin në Punë" përcakton detyrimin e punëdhënësit për marrjen e masave për eliminimin e rrezikut dhe garantimin e sigurisë dhe shëndetit në punë, zbatimi dhe monitorimi i këtij ligji në vazhdimësi lë për të dëshiruar.

245. Nga Vjetari statistikor i Ministrisë së Drejtësisë për vitin 2013, rezultojnë 34 çështje me objekt "Shkeljen e rregullave të mbrojtjes në punë", neni 289 i Kodit penal dhe 34 të dënuar për këtë vepër penale.

*Politikat e punësimit, formimit dhe arsimit profesional:*

246. Fuqizimi ekonomik përbën një nga katër fushat prioritare në Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Reduktimin e Dhunës me bazë Gjinore dhe Dhunës në Familje, 2011-2015[131]. Fuqizimi i pozitës së grave dhe vajzave përmes punësimit, nxitjes së sipërmarrjes, formimit dhe kualifikimit profesional të tyre përbën një nga prioritetet e qeverisë për barazinë gjinore dhe dhunën në familje 2013-2017.

247. Ndërsa vlerëson se rritja e përfshirjes së grupeve të veçanta në tregun e punës, ndër të cilat grave/vajzave zë një vend të rëndësishëm në strategjitë dhe politikat e punësimit dhe formimit profesional, AP ka vënë theksin tek rezultatet e zbatimit të këtyre politikave.

## 3. Situata faktike. Tregu i punës, punësimi.

248. Të dhëna nga INSTAT tregojnë se "Shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës për femrat në moshë 15-64 vjeç është 50,1 %, ndërsa për meshkujt 70,2 %. Pra, rezulton një diferencë prej 20,1 pikë përqindje në favor të meshkujve, duke pasqyruar pjesëmarrjen më aktive të tyre në tregun e punës".[132]

249. Gratë e punësuara janë kryesisht të përqendruara në sektorin e shërbimeve (kundrejt bujqësisë dhe industrisë) ku

131 Kjo strategji është miratuar me VKM nr. 573, datë 16.06.2011.

132 INSTAT, "Femra dhe meshkuj në Shqipëri", 2014. i vlefshëm në: http://www.instat.gov.al/media/257796/femra_dhe_meshkuj_2014_.pdf, fq. 65.

ato mbajnë 42 % të këtyre punëve[133]. Orientimi i vajzave të reja në profesione tipike “femërore”, të paguara pak dhe që nuk kërkojnë shumë aftësi, rrit hendekun gjinor në lidhje me pagat dhe mundësinë e tyre për të gjetur punë në sektorin informal[134].

*Programet e nxitjes së punësimit:*

250. Nëpërmjet VKM nr. 27, datë 11.01.2012, “Për nxitjen e punësimit të punëkërkueseve të papuna femra”, janë zbatuar 4 programe ku janë punësuar 36 prej tyre[135]. Nëpërmjet VKM nr. 47, “Për programin e punësimit nëpërmjet formimit në punë”, janë trajtuar 28 subjekte të cilat kanë formuar nëpërmjet punës 436 punëkërkues të papunë. Pas periudhës së formimit 58% e pjesëmarrësve, ose 252 vetë (nga të cilët 134 femra) janë mbajtur në punë për të paktën një kohëzgjatje 6-mujore të përcaktuar sipas kritereve të këtij programi[136]. Edhe programet e nxitjes së punësimit të financuara nga PNUD në 20 subjekte, ku janë përfshirë 126 PuPa të regjistruar pranë zyrave të punësimit kanë kontribuar në fuqizimin ekonomik të grave. Janë mbajtur në punë pas përfundimit të programit 32 vetë, nga të cilët 25 femra[137]. Punësimi i grave në tregun e punës është i rëndësishëm edhe për aksesin që u krijon grave në skemat e sigurimeve shoqërore. Sipas llogaritjeve, në sektorin informal punon një përqindje më e lartë femrash krahasuar me meshkujt, duke çuar në mbulimin e dobët të femrave nga sistemi[138].

251. Kategoria e grave të ngujuara mund të përfitojë nga skema e pagesës së papunësisë, ndërsa pjesëmarrja e tyre në programet e nxitjes së punësimit që zbatohen nga ana e Shërbimit Kombëtar të Punësimit është e vështirë për kushtet e tyre specifike[139].

*Programet e formimit profesional:*

252. Në lidhje me pjesëmarrësit në programet e formimit profesional, për vitin 2013 janë regjistruar 9254 persona, nga të cilët janë çertifikuar 8884. Janë trajnuar 3896 femra, ose 43% e totalit[140].

*E drejta për punë dhe diskriminimi në marrëdhëniet e punës:*

253. Nga të dhënat e INSTAT rezulton se ndër personat ekonomikisht joaktivë më të ekspozuar ndaj dekurajimit janë femrat. Në vitin 2013 të papunët e dekurajuar përbënin 23 % të të gjithë individëve ekonomikisht joaktivë (20,8 % meshkuj dhe 24,2 % femra)[141]. Për vitin 2013 shkalla e papunësisë tek femrat ishte 13.2 %[142].

254. Popullsia që jeton në zonat rurale nuk përfshihet në të dhënat e papunësisë së vendit, përsa kohë që forca punëtore në këto zona konsiderohet si e vetëpunësuar në ekonomitë familjare bujqësore dhe si rezultat nuk mund të përfitojnë nga skemat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore. Gratë janë veçanërisht të prekura nga kjo dukuri[143].

255. Gratë përballen me forma të ndryshme të

133 INSTAT, “Perspektiva gjinore në Shqipëri”, Analiza gjinore e rezultateve të censusit 2011 të popullsisë dhe banesave, Tiranë 2014, fq. 68.

134 Strategjia kombëtare për punësim dhe aftësi 2014-2020, miratuar me VKM nr. 818, datë 26.11.2014, “Për miratimin e strategjisë kombëtare për punësim dhe aftësi 2014 – 2020 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj”, botuar në Fletoren zyrtare nr. 188/2014, fq. 10355.

135 Shërbimi Kombëtar i Punësimit, Buletini i tregut të punës 2013, fq. 28. i vlefshëm në http://www.kerkojpune.gov.al

136 Shërbimi Kombëtar i Punësimit, Buletini i tregut të punës 2013, fq. 27. i vlefshëm në http://www.kerkojpune.gov.al

137 Shërbimi Kombëtar i Punësimit, Buletini i tregut të punës 2013, fq. 28, i vlefshëm në http://www.kerkojpune.gov.al

138 Strategjia kombëtare për punësim dhe aftësi 2014-2020, Fletore zyrtare nr. 188/2014, fq. 10322, miratuar me VKM nr. 818, datë 26.11.2014.

139 AP,”Mbi fenomenin e gjakmarrjes”, fq. 29. (nr. 28/4, datë 22.04.2013) http://www.parlament.al/web/pub/2013_raporti_per_gjakmarrjen_15419_1.pdf

140 Shërbimi Kombëtar i Punësimit, Buletini i Tregut të Punës 2013, fq. 32, i vlefshëm në http://www.kerkojpune.gov.al

141 http://www.instat.gov.al/media/237073/tregu_i_punes_2013.pdf , fq. 7

142 http://www.instat.gov.al/media/237073/tregu_i_punes_2013.pdf, fq. 6

143 Strategjia Kombëtare “Për barazinë gjinore dhe reduktimin e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje”, 2011-2015, miratuar me VKM nr. 573, datë 16.6.2011.

diskriminimit në punë dhe vështirësi në lidhje me harmonizimin e angazhimeve në familje dhe punë[144].

256. Ka diferenca në paga, sidomos në sektorin privat, si në ndërtim, shërbime e fasoneri. Kështu[145], ka rezultuar se gratë fitojnë nga puna më pak se burrat. Kjo diferencë për vitin 2011 rezulton të jetë 5725 lekë ose 17.4 % më pak. Këtu ndikojnë edhe fushat e studimit të përzgjedhura nga femrat dhe meshkujt. "Fusha më e dominuar nga femrat e diplomuara është ajo e shkencave të arsimit, e ndjekur nga humanitaret dhe artet dhe më pas nga ajo e shëndetësisë dhe e kujdesit prej përkatësisht 78, 75 dhe 72%. Në të kundërt, fusha më e dominuar nga meshkujt me arsim të lartë është ajo e shërbimeve, pasuar nga ajo e inxhinierisë, prodhimit dhe ndërtimit, e më pas ajo e bujqësisë, pyjeve dhe peshkimit prej përkatësisht 68, 61 dhe 58%"[146]. Nuk janë marrë masa të veçanta për të adresuar hendekun gjinor në aspektin e pagesës, aksesit për sipërmarrjen dhe kredi[147].

257. "... janë femrat ato që në një numër shumë më të madh se meshkujt, kryejnë punë të papaguar (91 përkundrejt 40%)"[148]. Femrat shpenzojnë më shumë kohë për kujdesin ndaj të moshuarve dhe fëmijëve. Ditët e punës së paguar të meshkujve janë mesatarisht rreth një orë e gjysmë më të gjata sesa ato të femrave (7:39 përkundrejt 6:11 orë), kurse ditët e punës së papaguar të femrave janë shumë më të gjata sesa ato të meshkujve (5:42 përkundrejt 2:06 orë)[149]. Nuk janë ndërmarrë hapat e nevojshëm për të llogaritur dhe përfshirë veprimtaritë shtëpiake të papaguara të gruas në prodhimin e brendshëm bruto. Numri i qendrave ditore për të moshuarit dhe i institucioneve ditore të përkujdesit për fëmijët mbetet i kufizuar, duke bërë që roli i grave në familje në lidhje me fëmijët dhe të moshuarit të mbetet kryesor dhe pajtimi i përgjegjësive familjare me ato profesionale të jetë i vështirë. Mungojnë mekanizma efektivë që mundësojnë që gratë, që kryejnë punë të papaguara të përfitojnë nga shërbimet komunitare, politikat e punësimit etj.

258. Në lidhje me femrat pronare/administratore, rezulton se "27,8 % e ndërmarrjeve aktive gjithsej menaxhohen nga femrat. 33.4 % e aktivitetit ekonomik tregti menaxhohen nga femrat. 14,4 % e ndërmarrjeve me 50 e më shumë të punësuar menaxhohen nga femrat."[150];

259. Është identifikuar problemi i punëmarrëseve gra, të pasiguruara nga punëdhënësit e tyre. Kështu, edhe raporti i katërt periodik kombëtar mbi zbatimin e Konventës CEDAW, (RKPK) thekson se "për periudhën 2010-2014 janë evidentuar 4491 punëmarrës të pasiguruar (45 % femra) në 54 524 subjekte të kontrolluara me 567631 punëmarrës[151]. Këto të dhëna kanë rezultuar nga kontrolli i ushtruar nga Inspektorati Shtetëror i Punës në subjektet ekonomike të licencuara në territorin e RSH-së. Mungojnë masa efektive për adresimin e këtij problemi. Nga Vjetari statistikor i Ministrisë së Drejtësisë për vitin 2013 rezulton se janë 34 çështje të "shkeljes së rregullave të mbrojtjes në punë"-neni 289 i Kodit penal dhe 34 individë të dënuar për kryerjen e kësaj vepre penale.

260. Janë konstatuar raste të shkeljes së procedurave ligjore për largimin nga puna dhe cenimi i të drejtave të parashikuara me ligj nga administrata

144 Nga takimet e ekspertëve të AP me OJF-të në qytetin e Beratit në datën 30 shtator 2014.

145 GADC, "Pabarazia gjinore në pagë një rast shqiptar", Tiranë 2012, fq. 31.

146 INSTAT, Femra dhe meshkuj 2014. www.instat.gov.al/media/257796/femra_dhe_meshkuj_2014_.pdf, fq. 38.

147 http://www.integrimi.gov.al/al/dokumenta/progres-raporte/progres-raporti-2014&pageç1

148 INSTAT, "Femra dhe Meshkuj në Shqipëri", 2014. i vlefshëm në: www.instat.gov.al/media/257796/femra_dhe_meshkuj_2014_.pdf,fq.78.

149 http://www.instat.gov.al/media/257796/femra_dhe_meshkuj_2014_.pdf , fq. 77.

150 http://www.instat.gov.al/media/247026/regjistri_ndermarrjeve_2013.pdf , fq. 9.

151 Raporti i katërt periodik kombëtar mbi zbatimin e Konventës "Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit të grave", miratuar me VKM nr.806, datë 26.11.2014. Fletorja zyrtare e RSH nr. 187/2014, fq. 10198. http://tbinternet.ohchr.org/Treaties/CEDAW/Shared%20Documents/ALB/CEDAW_C_ALB_4_7078_E.pdf , fq.38.

publike[152]. Për periudhën gusht-dhjetor 2010 janë paraqitur 36 ankesa në lidhje me marrëdhëniet e punës, nga të cilat 17 janë paraqitur nga gratë; për vitin 2011 janë paraqitur 144 ankesa në lidhje me marrëdhëniet e punës, nga të cilat 33 janë paraqitur nga gratë. Gjatë vitit 2012 janë paraqitur 268 ankesa në lidhje me marrëdhëniet e punës, nga të cilat 89 janë paraqitur nga gratë, ndërsa për periudhën janar-shtator 2014 janë paraqitur 161 ankesa në lidhje me marrëdhëniet e punës, nga të cilat 59 janë paraqitur nga gratë. Objekti i ankesave ka konsistuar në shkeljen e dispozitave të Kodit të punës, transferime të padrejta, mosdhënie pagash, shpërblimesh ose leje vjetore, largime të padrejta nga puna dhe kalimi në listë pritje, ankesa në lidhje me ndërprerjen e marrëdhënieve të punës gjatë kohës që ankuesja ka qenë me leje barrëlindje, mosrespektim të afateve ligjore paraprake të ndërprerjes së marrëdhënieve të punës nga ana e punëdhënësit dhe shkelje të procedurave të parashikuara në ligj për largimin nga puna dhe mosarsyetim të vendimeve, mospërmbushje e detyrimit të vendosur nga Komisioni i Shërbimit Civil, në zbatim të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999, "Statusi i nëpunësit civil", etj. Këto ankesa në disa raste janë paraqitur nga gra kryefamiljare, pa të ardhura, etj. AP ka shqyrtuar ankesat dhe ka paraqitur rekomandime, me qëllim gëzimin e të drejtave nga ankueset dhe vënien përpara përgjegjësisë të personave përgjegjës.

261. AP ka shqyrtuar ankesa, që mbartnin elementë të shkeljes së barazisë, ose të diskriminimit, që kanë shërbyer si shkak për shkeljen e të drejtave të tjera të pretenduara nga ankuesit. AP ka filluar hetimin administrativ për një rast refuzimi nga ana e një mjekeje për të punuar me një infermiere me shami, duke rekomanduar marrjen e masës disiplinore ndaj mjekes dhe angazhimin e strukturave shëndetësore për mospërsëritjen e rasteve të diskriminimit jo vetëm ndërmjet personelit mjekësor, por edhe ndaj pacientëve që këto struktura trajtojnë. Rekomandimi i AP, në lidhje me këtë ankesë është zbatuar.

262. Niveli i njohjes së standardeve ndërkombëtare nga avokatët, juristët, stafi i administratës publike, gjyqtarët, prokurorët dhe punëdhënësit në fushën e punësimit, ndër të cilat edhe ato që prezanton konventa CEDAW në nenin 11, lë për të dëshiruar.

263. Njohja nga gratë e të drejtave të tyre për mbrojtjen nga diskriminimi në fushën e punës nuk është e mjaftueshme.

### 3.1. Rekomandime.

*Zhvillimi institucional:*

264. Rekomandohet forcimi i kapaciteteve të institucioneve përgjegjëse si ministria që mbulon çështjet e barazisë gjinore, Shërbimi Kombëtar i Punësimit, Inspektorati Shtetëror i Punës, Shërbimi Social Shtetëror në fushën e marrëdhënieve të punës, me qëllim respektimin e parimit të barazisë dhe mos diskriminimit. Rritja e burimeve njerëzore dhe financiare për këto institucione është e nevojshme.

*Barazia në marrëdhëniet e punës:*

265. Rekomandohet t'u jepet më shumë përparësi politikave të pjesëmarrjes së grave dhe vajzave në programe aktive punësimi, formimi profesional dhe ri trajnimi se sa skemave të mbështetjes me të ardhura[153]. Rritja e programeve aktive të formimit dhe punësimit, veçanërisht të grave, është e rëndësishme, me qëllim rritjen e mbulimit të tyre nga sistemi i mbrojtjes shoqërore.

266. Rritja e pjesëmarrjes së femrave në arsimin profesional do të ndihmonte për reduktimin e diferencës gjinore në paga, duke i orientuar drejt profesioneve më të paguara. Rekomandohen politika që rritin

152 Referuar 233 ankesave të paraqitura pranë institucionit të Avokatit të Popullit dhe të trajtuara për periudhën tetor 2013-tetor 2014. Komente dhe mendime të Avokatit të Popullit për progres-raportin e KE-së për Shqipërinë për 2014, Tiranë 2014, fq. 1., Procesverbali i mbledhjes dt. 12.11.2014 i komisionit për çështjet ligjore, administratën publike dhe të drejtat e njeriut, seancë dëgjimore me Avokatin e Popullit për progres raportin e vitit 2014.

153 Avokati i Popullit, Raport i veçantë, "Për dhunën ndaj grave dhe veprimtarinë e Avokatit të Popullit", korrik 2012, fq. 36. (nr. 208, datë 24.07.2012)

pagat në sektorët e dominuar nga femrat, promovojnë përfshirjes e tyre në shkencë, teknologji, i japin prioritet marrjes në punë të atyre që janë të kualifikuara në mënyrë të barabartë me burrat. Janë të rekomandueshme inkurajimi i zhvillimit të biznesit të grave dhe monitorimi i këtyre politikave.

267. Rekomandohet të rritet numri i qendrave ditore për të moshuarit dhe të institucioneve ditore të përkujdesit për fëmijët, duke intensifikuar përpjekjet për të siguruar një sistem të përkujdesit për fëmijët, të aksesueshëm dhe cilësor. Kjo do të ulte orët e papaguara të punës së grave në familje dhe do të rriste rolin e grave në sferën publike.

268. Rekomandohet rritja e përfaqësimit të grave në vendimmarrjen ekonomike. Strategjitë lokale rekomandohet të përfshijnë integrimin e grave dhe punësimin e tyre.

*Kryerja e monitorimeve:*

269. Rekomandohet monitorimi i vazhdueshëm i zbatimit të Ligjit nr. 9970, datë 24.07.2008, "Për barazinë gjinore në shoqëri", Ligjit "Për mbrojtjen nga diskriminimi" dhe legjislacionit të punës nga perspektiva gjinore.

270. Rekomandohet kryerja e studimeve gjinore në lidhje me punësimin e grave kryefamiljare, grave me aftësi të kufizuara, grave të trafikuara, grave të dhunuara në marrëdhëniet familjare, grave rome dhe egjiptiane, grave LBTI, etj.

*Trajnimet:*

271. Rekomandohet të organizohen trajnime për profesionistët në lidhje me njohjen e standardeve ndërkombëtare, ndër të cilat edhe e standardeve që burojnë nga Konventa CEDAW, në lidhje me barazinë në punësim. Këto trajnime nevojiten të organizohen me avokatë, gjyqtarë, prokurorë, juristë, stafe të administratës publike dhe punëdhënës.

*Në lidhje me rolin e organizatave jofitimprurëse:*

272. Rekomandohet të forcohet veprimtaria e OJF-ve, e orientuar nga të drejtat e grave në fushën e punës dhe mbrojtjen nga diskriminimi gjinor dhe/ose i shumëfishtë.

# D. DHUNA NË FAMILJE

Nenet 1 dhe 2, së bashku me nenin 5 të Konventës mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave, CEDAW, rekomandimi i përgjithshëm nr. 19 i Komitetit mbi Eliminimin e Diskriminimit të Grave, CEDAW

Nga vrojtimi kombëtar me bazë popullatën[154] 2013, "Dhuna në familje në Shqipëri", rezulton se, 59,4 % e grave (më shumë se 1 në 2 gra) thanë se kishin pësuar dhunë në familje në martesë/marrëdhënie intime "gjatë jetës", dhe 53,0 % e grave (1 në 2 gra) po përjetonin dhunë në familje "aktualisht" (brenda 12 muajve para intervistës).

## 1. Kuadri ligjor që adreson dhunën në familje.

273. Gjatë periudhës 2010-2014 kuadri ligjor për adresimin e dhunës në familje në Shqipëri është përmirësuar, duke u përafruar në vazhdimësi me standardet ndërkombëtare. Ligji nr. 9669, datë 18.12.2006, "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare" ka pësuar ndryshime që synojnë një parandalim dhe mbrojtje më efektive nga dhuna në familje të pjesëtarëve të familjes, veçanërisht të grave si pjesëtarët që pësojnë më shumë dhunë në familje[155]. Me VKM nr. 334, datë 17.02.2011, "Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij" është ngritur mekanizmi i koordinimit dhe referimit të rasteve të dhunës në familje, janë miratuar ligje të veçanta, që zgjerojnë rrethin e përfituesve të ndihmës juridike, ndihmës ekonomike etj. duke përfshirë si

154 INSTAT, "Dhuna në familje në Shqipëri", vrojtim kombëtar me bazë popullatën, 2013. Raport i përgatitur nga Dr.Robin N, Haarr, konsulente ndërkombëtare e PNUD-it, fq.33.

155 Të dhëna zyrtare nga Policia e Shtetit dhe raporte të organizatave jofitimprurëse tregojnë se gratë janë më të prekurat nga dhuna në familje.

subjekte përfituese viktimat e dhunës në familje.

274. Me miratimin e ndryshimeve në Kodin penal, me ligjin nr. 23/2012 dhe ligjin nr. 144/2013, dhuna në familje parashikohet si një vepër penale më vete dhe forma të ndryshme të dhunës në familje adresohen me mjete ligjore. Janë ashpërsuar masat e dënimit dhe dhunuesit përballen me legjislacionin penal e ndëshkohen, pavarësisht tërheqjes së viktimës nga procesi.

### 1.1. Legjislacioni civil dhe administrativ për parandalimin dhe reduktimin e dhunës në familje dhe zbatimi i tij; Kodi i familjes.

275. Mungojnë dispozita në KF që lidhin në mënyrë të drejtpërdrejtë incidentet e dhunës në familje me shpërdorimin e përgjegjësisë prindërore apo pakujdesinë e rëndë në ushtrimin e saj. Mungojnë dispozita në Kodin e familjes që parashikojnë vizita të mbikëqyrura të fëmijëve nga prindi, në rastet kur prindi është njohur si dhunues nga gjykata dhe ndaj tij është lëshuar një urdhër mbrojtje.

*Ligji nr. 9669, datë 18.12.2006, "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", i ndryshuar:*

276. Ligji nr. 9669, datë 18.12.2006, "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare" është një ligj administrativo-civil, mjetet ligjore të të cilit po përdoren gjithnjë e më shumë nga viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare.

277. Mjetet ligjore që ofron ligji nr. 9669, datë 18.12.2006, "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", i ndryshuar, UMM/UM ofrojnë mundësinë e një mbrojtje të menjëhershme, me një larmishmëri masash mbrojtëse, pa barrë financiare për viktimën, për një periudhë të përcaktuar qartë, maksimumi 1 vit, me të drejtën për t'u drejtuar sërish gjykatës për të kërkuar lëshimin e UMM/UM, pavarësisht ndjekjes penale të çështjes.

278. Me ligjin nr. 10329, datë 30.09.2010, "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006 "Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", të ndryshuar, parashikohen ndryshime të rëndësishme, që lidhen me krijimin e një rrjeti të koordinuar institucionesh përgjegjëse, ngritjen e një qendre kombëtare të shërbimit të përkujdesit shoqëror për viktimat e dhunës në familje, ruajtjen e fshehtësisë së të dhënave dhe informacioneve personale të viktimës nga punonjësit e shërbimit e të përkujdesjes shoqërore, avokatët e përfaqësuesit ligjorë të viktimave të dhunës në familje. Gjithashtu, kërkuesi i UMM/UM përjashtohet nga të gjitha taksat dhe tarifat për shpenzimet gjyqësore si dhe ato të shërbimeve përmbarimore shtetërore dhe ofrohet mbrojtje më e shpejtë dhe më efektive për fëmijët nga dhuna në familje etj.

*Rekomandime:*

279. Ratifikimi nga shteti shqiptar i Konventës së Këshillit të Evropës "Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje" shtron nevojën e harmonizimit të legjislacionit të brendshëm me standardet që parashtron kjo konventë, në lidhje me rrethin e subjekteve që gëzojnë mbrojtje ligjore nga dhuna në familje, kompensimin e viktimave të dhunës në familje, përfitimin e shërbimeve, pavarësisht raportimit nga viktima, etj.

280. Praktika dikton nevojën e ndryshimeve në Kodin e familjes, që të mundësojnë ushtrimin e të drejtës së vizitës/takimit të fëmijëve në kushtet e mbikëqyrjes nga psikologu, punonjësi social ose një person tjetër përgjegjës, i caktuar nga gjykata. Vizitat e mbikëqyrura janë të rekomandueshme edhe në rastet kur viktimat janë akomoduar në një strehëz, gjatë kohës që UM/UMM është në fuqi. Në këtë rast është e rekomandueshme që e drejta e takimit e ish-bashkëshortit të realizohet nën mbikëqyrjen e një punonjësi të strehëzës për viktimat e dhunës në familje apo një psikologu, punonjësi social ose një personi të autorizuar nga gjykata. Rekomandohet që në rastet kur prindi dhunues ka të drejtën e takimit ose vizitës së fëmijëve, vendimi i gjykatës të shoqërohet me një plan sigurie, që do të ofronte mbrojtje për viktimën dhe fëmijët dhe nuk do t`i përballë ato me një dhunë edhe më ekstreme.

Çështje të zbatimit të ligjit administrativo-civil "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare".

281. Pavarësisht numrit në rritje të urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes ose urdhrave të mbrojtjes, përqindja e lartë e vendimeve të pushimit për çështjet me objekt lëshimin e UMM/UM vazhdon të ngrerë çështjen e efektivitetit të zbatimit të këtij ligji. "Ende janë të larta rastet e vendimeve të pushimit për UM/UMM në përgjithësi dhe të atyre ku gratë janë paditëse në veçanti. Për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në 91-92 % të rasteve, kërkesa për UMM/UM është bërë nga gratë. Për GjRrGj Durrës, në rreth 84 % të vendimeve të pushimit, urdhri është kërkuar nga gratë[156]".

282. Neni 13 i Ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006, "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", i ndryshuar, në lidhje me subjektet që kanë të drejtë të paraqesin padi publike nuk ka gjetur zbatimin e duhur nga policia dhe prokuroria. Ushtrimi i të drejtës për paraqitjen e padisë publike nga policia ose prokuroria do të reduktonte numrin e çështjeve të pushimit dhe do të bënte të mundur gjykimin e çështjes, pavarësisht tërheqjes së viktimës nga procesi. Inspektorati pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë shprehet se, përmes raporteve të monitorimit, ka evidentuar praktikat e mira të komisariatit të policisë në qarkun Elbasan (në periudhën e inspektuar në GjRrGj Elbasan janë paraqitur prej komisariatit të policisë 40 çështje, me palë kërkuese policinë e shtetit), dhe në Përmet (2 çështje të paraqitura nga komisariati i policisë).[157]

283. Efektiviteti i procesit gjyqësor dhe aksesi i viktimave të dhunës në familje në sistemin e drejtësisë lidhet ngushtë me kohëzgjatjen e gjykimit. Inspektorati pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë shprehet se në 183 raste nga 2689 që ishin objekt i inspektimit, janë konstatuar shkelje të afateve ligjore, që zënë masën 6.8 % të volumit në shkallë vendi.[158] Kjo gjetje rezulton edhe nga raporte të organizatave jofitimprurëse. Kështu, nga raporte të OJF-ve ka rezultuar se "...mospërgatitja në kohë e provave bëhet shpesh pengesë për shtyrjen e gjykimeve. Kjo është arsyeja që ka më shumë raste të tejkalimit të afateve ligjore më tepër tek UM me një afat 15 ditor, sesa të UMM, me afat 48 orë."[159] Kohëzgjatja e gjykimit të çështjeve me objekt lëshimin e UMM/UM dhe tejkalimi i afateve ligjore është në kundërshtim me qëllimin që ka ligji për marrjen e masave urgjente për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje.

284. Pavarësisht programeve të edukimit publik të ofruara për përfaqësuesit e të gjithë institucioneve përgjegjëse për rritjen e ndërgjegjësimit të tyre, ende ka nevojë për të punuar për rritjen e ndërgjegjësimit të përfaqësuesve të institucioneve përgjegjëse. Kështu,

156 Prof. dr. Arta Mandro (Balili) & Av. Aurela Bozo & Prof. dr. Aurela Anastasi, "Njohja dhe zbatimi i standardeve të barazisë gjinore në procesin gjyqësor, Raport mbi gjetjet kryesore nga monitorimi i vendimeve të gjykatave të shkallës së I-rë, të rretheve gjyqësore Tiranë, Durrës, Shkodër e Vlorë, 1 janar 2011-1 qershor 2012", fq. 49, Tiranë, dhjetor 2013.

157 Këshilli i Lartë i Drejtësisë, inspektorati, "Raport tematik mbi dhunën në familje dhe masat e sigurimit për mbajtjen pa leje të armëve luftarake", janar 2014. Një nga temat në objekt të inspektimit të kryer ishte: Roli i gjykatave në luftën kundër dhunës në familje nëpërmjet kontrollit të çështjeve me objekt "Lëshimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes" dhe "Lëshimin e urdhrit të mbrojtjes". Kontrollit iu nënshtruan 28 gjykata të vendit, nga të cilat 6 gjykata të apelit dhe 22 gjykata të shkallës së parë. Raporti tematik është i vlefshëm në web: http://kld.al/korniza-ligjore/akte-nenligjore/raport-mbi-dhunen-ne-familje

158 Këshilli i Lartë i Drejtësisë, Inspektorati, "Raport tematik mbi dhunën në familje dhe masat e sigurimit për mbajtjen pa leje të armëve luftarake", janar 2014.

159 QNL, Studim, "Çështje të rritjes së efektivitetit, transparencës dhe të besimit të publikut në gjyqësor", Rezultate të nxjerra nga monitorimi i seancave dhe studimi i jurisprudencës gjyqësore në lidhje me mbrojtjen e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, në rrethet gjyqësore Tiranë, Elbasan, Shkodër, Vlorë. Periudha e monitorimit: shkurt 2012 - tetor 2013, fq. 59. Ky raport është i vlefshëm në web www.qag-al.org

Shkolla e Magjistraturës ka organizuar trajnime për gjyqtarët dhe prokurorët, ne lidhje me dhunën në familje. Kanë përfituar 238 gjyqtarë, prokurorë, oficerë të policisë gjyqësore nga trajnimet në lidhje me ndryshimet e Kodit penal me Ligjin nr. 23/2012 dhe Ligjin nr.144/2013, organizuar nga Shkolla e Magjistraturës gjatë vitit akademik 2013-2014.[160] Fokusi i trajnimeve ka qenë edhe trajtimi i çështjeve në mënyrë të ndjeshme dhe mbrojtja e grave nga riviktimizimi.

*Rekomandime:*

285. Pavarësisht përmirësimit të kuadrit ligjor, duhet të theksojmë se është e nevojshme rritja e efektivitetit të zbatimit të legjislacionit kundër dhunës në familje. Rekomandohet marrja e masave për zbatimin nga gjykatat e rretheve gjyqësore të afateve të parashikuara në Ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006, "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", i ndryshuar, për shqyrtimin e kërkesë padive me objekt lëshimin e UMM/UM me qëllim mbrojtjen e menjëhershme të viktimave të dhunës në familje.

286. Rekomandohet një zbatim më i mirë i sanksioneve për punonjësit përgjegjës, që nuk përmbushin detyrimet ligjore në lidhje me ekzekutimin e vendimeve të UMM/UM.

287. Rekomandohet organizimi në vazhdimësi i trajnimeve nga SHM për gjyqtarët, me qëllim njohjen e UMM/UM në çdo procedim ligjor ndaj të njëjtit person.

288. Rekomandohet organizimi i trajnimeve të vazhdueshme nga SHM për policinë, prokurorinë dhe subjektet që legjitimohen të paraqesin padi publike, me objekt lëshimin e UMM/UM.

289. Rekomandohet të zhvillohen trajnime në vazhdimësi për të gjithë autoritetet përgjegjëse vendore që punojnë në zbatim të legjislacionit kundër dhunës në familje.

*Ngritja dhe forcimi i mekanizmit të koordinimit dhe referimit të rasteve të dhunës në familje:*

290. Në aspektin e mekanizmit institucional, AP, në raportin e veçantë për dhunën ndaj grave, përcakton se disa nga sfidat kryesore janë burimet e pamjaftueshme njerëzore për integrimin gjinor, emërimi me kohë të plotë dhe rrjetëzimi i nëpunësit gjinor në nivel qendror dhe lokal, ngritja e kapaciteteve të tyre, etj. Gjithashtu, institucioni i AP ka vlerësuar me rëndësi, përcaktimin e strukturave apo personave të specializuar pranë autoriteteve shtetërore përgjegjëse për trajtimin e çështjeve të dhunës në marrëdhëniet familjare[161]. Përmbushja në të njëjtën kohë e disa detyrave, si e specialistes gjinore dhe koordinatores vendore të mekanizmit të koordinimit dhe referimit të rasteve të dhunës në familje, në disa raste, e shoqëruar edhe me detyra të tjera, në disa bashki e bën të vështirë punën për koordinimin dhe referimin e rasteve të dhunës në familje.

291. Ngritja dhe funksionimi i mekanizmit të koordinimit dhe referimit të rasteve të dhunës në familje ka sjellë efekte në një menaxhim më të mirë të rasteve në nivel vendor. Pavarësisht se MKR janë ngritur në 27 bashki[162], koordinimi midis aktorëve përgjegjës, anëtarë të MKR lë për të dëshiruar.

292. Duhet të theksojmë se mungesa e MKR në të gjitha bashkitë në shkallë vendi i përball gratë si viktima të dhunës në familje me një nivel të lartë rreziku, në mungesë të qasjes ndërdisiplinore që nevojitet për menaxhimin e rasteve.

293. Megjithëse rastet e viktimave të dhunës në marrëdhëniet familjare, me banim në zonat rurale janë në rritje[163], skuadra ndërdisiplinore në komuna dhe modelet e bashkëpunimit bashki-komuna gjatë periudhës së raportimit kanë qenë të

160 www.magjistratura.edu.al

161 Avokati i Popullit, Raport i veçantë, "Për dhunën ndaj grave dhe veprimtarinë e Avokatit të Popullit", korrik 2012, fq. 22. (nr. 208, datë 24.07.2012)

162 Referuar në raportin e katërt periodik kombëtar mbi zbatimin e Konventës "Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit të grave", miratuar me VKM nr.806, datë 26.11.2014. Fletorja zyrtare e RSH nr.187/2014, fq.10183.

163 Nga vrojtimi kombëtar me bazë popullatën 2013, "Dhuna në familje në Shqipëri" rezulton se gratë në zonat rurale (60,8 %) kishin shumë më tepër gjasa të përjetonin "aktualisht" dhunë në familje të të gjitha llojeve, krahasuar me gratë në zonat urbane (47,6%). INSTAT 2013, fq.53.

kufizuara.

294. Rritja e efektivitetit të punës së mekanizmave të koordinimit në nivel vendor kërkon një buxhetim më të mirë të çështjeve gjinore dhe adresimit të dhunës në familje si dhunë me bazë gjinore në buxhetet lokale në bashki, dhe një monitorim në vazhdimësi të tyre. Mungesa e mundësisë së akomodimit të viktimave të dhunës në familje në një strehëz në nivel qarku i step viktimat, vështirëson procesin e denoncimit të rasteve të dhunës dhe përfitimit të shërbimeve të nevojshme. Mungesa e një linje telefonike 24-orëshe dhe shërbimeve të tjera të nevojshme e bëjnë të vështirë përmbushjen e përgjegjësive nga anëtarët e MKR. Edhe raporti i katërt periodik kombëtar mbi zbatimin e Konventës "Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit të grave", përcakton si disa nga prioritetet e punës për përmirësimin e situatës de facto mbi DHkG/DHF ngritjen e linjës telefonike 24-orëshe dhe ngritjen e strehëzave rajonale[164]. Vlefshmëria e këtyre shërbimeve do të përbënte një përmbushje të detyrimeve ligjore për njësitë e pushtetit vendor dhe një funksionim më efektiv të mekanizmit të koordinimit dhe referimit të rasteve të dhunës në familje, në nivel lokal.

295. Shkeljet e urdhrave të mbrojtjes reflektojnë qartë problemet në koordinimin e punës së aktorëve përgjegjës për zbatimin e UMM/UM. Referuar në raportin e katërt periodik kombëtar mbi zbatimin e Konventës CEDAW, shkeljet e UM kanë shënuar rritje për vitet 2011, 2012 dhe 2013. Janë regjistruar 86 shkelje të UM për vitin 2011, 119 shkelje të UM për vitin 2012 dhe 138 shkelje të UM për vitin 2013[165].

296. Viktimat e dhunës në familje kanë mundur të përfitojnë akomodim ose shërbime të tjera, pranë qendrës kombëtare të trajtimit të viktimave të dhunës në familje, vetëm nëse kanë qenë të pajisura me UM/UMM. Kjo praktikë nuk është në përputhje me standardet e Konventës së Këshillit të Evropës kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, e cila kërkon që "Sigurimi i shërbimeve nuk duhet të varet nga gatishmëria e viktimës për të ngritur akuza ose për të dëshmuar kundër një dhunuesi[166]";

297. Ngritja e sistemit të regjistrimit të të dhënave on line në nivel kombëtar, si një nga prioritetet e qeverisë për periudhën 2013-2017, dhe regjistrimi i të dhënave në sistem vetëm në 29 bashki[167] tregojnë qartë nevojën e regjistrimit të të dhënave edhe në bashkitë e tjera.

298. Numri i grave, viktima të dhunës që kanë përfituar ndihmë juridike falas, bazuar në ligjin "Për ndihmën juridike" është i kufizuar. Kështu, gjatë gjysmës së parë të vitit 2014 kanë përfituar ndihmë juridike nga komisioni shtetëror për ndihmën juridike vetëm 2 gra të dhunuara në marrëdhëniet familjare. Kjo pranohet edhe në raportin e katërt periodik kombëtar[168] mbi zbatimin e Konventës CEDAW, duke shprehur qartë problemet në lidhje me aksesin në ndihmën juridike.

299. Policia vazhdon të mbetet një aktor i rëndësishëm në zbatim të Ligjit 9669, datë 18.12.2006, "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare". Nga ankesat e paraqitura rezulton se janë evidente rastet kur viktima e dhunës në familje nuk ka informacion mbi hapat e ndërmarrë nga organi i policisë mbi vendimin e gjykatës

164 Raporti i katërt periodik kombëtar mbi zbatimin e Konventës "Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit të grave", miratuar me VKM nr. 806, datë 26.11.2014. Fletorja zyrtare e RSH nr.187/2014, fq. 10183.

165 Raporti i katërt periodik kombëtar mbi zbatimin e Konventës "Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit të grave", miratuar me VKM nr.806, datë 26.11.2014. Fletorja zyrtare e RSH nr.187/2014, fq. 10184.

166 neni 18 i Konventës së Këshillit të Evropës "Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje".

167 Referuar raportit të katërt periodik kombëtar mbi zbatimin e Konventës "Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit të grave", miratuar me VKM nr. 806, datë 26.11.2014. Fletorja zyrtare e RSH nr.187/2014, fq. 10186, deri në fund të gushtit 2014, rezultojnë 29 bashki që hedhin të dhënat në sistem.

168 Raporti i katërt periodik kombëtar mbi zbatimin e Konventës "Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit të grave", miratuar me VKM nr. 806, datë 26.11.2014. Fletorja zyrtare e RSH nr.187/2014, fq. 10184. (4 raste/ 2013; 2 raste për gjashtëmujorin e I-rë 2014 -një shtetase shqiptare, një e huaj)

së rrethit gjyqësor[169] etj. Gjatë vitit 2014, nga shqyrtimi i ankesave, në disa raste ka rezultuar se punonjësit e policisë nuk kanë vepruar në përputhje me dispozitat ligjore që rregullojnë këtë fushë[170].

300. "...gjatë periudhës 2009-2013 u trajnuan 4400 punonjës të shëndetësisë, nga të cilët 1275 femra u trajnuan në vitin 2010, 730 në vitin 2011 dhe 1067 në vitin 2013"[171]. Ndonëse janë trajnuar në vazhdimësi punonjës të shëndetësisë (mjek të përgjithshëm, infermiere e specialistë) për problemet e dhunës në familje, janë përgatitur manuale udhëzuese për trajtimin e viktimave prej tyre, ende mbetet për të përmirësuar në identifikimin e rasteve të dhunës në familje nga personeli shëndetësor, ofrimin e ndihmës psikologjike krahas ndihmës mjekësore, pajisjen e viktimave të dhunës në familje me raport mjekësor, paraqitjen e dokumenteve të certifikuara për gjykatën si edhe shoqërimin apo transportimin e viktimave.

301. Pagesat e paunifikuara për psikologët dhe punonjësit socialë në çështjet familjare, mungesa e trajnimeve të vazhdueshme, etj, kanë përbërë pengesa për aksesin e viktimave të dhunës në familje në sistem. Institucionalizimi i pozicionit të psikologut pritet të garantojë më mirë të drejtat e viktimave të dhunës në familje.

302. Zyrat e shërbimeve sociale pranë disa bashkive kanë hedhur hapa në përmbushjen e disa detyrimeve ligjore si referimi, orientimi i viktimave të dhunës në familje, marrja pjesë në gjykimet për lëshimin e UM për të mitur, instalimi në disa raste i linjave telefonike ditore në kuadrin e mbështetjes nga donatorë të ndryshëm, ngritja e qendrave sociale dhe rehabilituese për viktimat në një numër të caktuar bashkish. Megjithatë, nevojitet përmbushja edhe e detyrimeve të tjera ligjore si: paraqitja e kërkesës në gjykatë për UM për të mitur dhe për UMM, zbatimi i vendimeve gjyqësore të UMM/UM, ofrimi i programeve rehabilituese për viktimat dhe dhunuesit në të gjitha bashkitë, instalimi i një linje telefonike 24-orë, etj. Shoqërimi i viktimave të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe transportimi i tyre në rastet e një rreziku ekstrem kërkon një buxhetim më të mirë nga pushteti vendor.

303. Në mungesë të shërbimeve për viktimat në nivel vendor, qendra kombëtare e trajtimit të viktimave të dhunës në familje ka përbërë një komponent të rëndësishëm, duke funksionuar prej muajit prill 2011. Numri i përfituesve nga shërbimet e qendrës, që nga momenti i ngritjes së saj deri në muajin shtator 2014 është 174 përfitues në total, nga të cilët 69 janë gra dhe 105 janë fëmijë[172].

304. Institucioni ynë ka kontribuar përmes rekomandimeve në lidhje me përmbushjen e standardeve të shërbimeve shoqërore dhe integrimin e viktimave pas dhunës së pësuar në këtë qendër[173]. "Me iniciativën e Avokatit të Popullit, është kryer një inspektim në qendrën kombëtare të trajtimit të viktimave të dhunës, Kamëz, Tiranë, në periudhën 10.04.2012-12.04.2012. Ky inspektim mori shkas nga ankesa e bërë nga disa gra të strehuara në këtë qendër, si dhe nga transmetimi i një kronike televizive për trajtimin dhe kushtet e ofruara në këtë institucion. Pas inspektimit, AP rekomandoi si më poshtë: 1. Shkarkimin nga detyra të drejtueses së qendrës, duke zgjidhur menjëherë kontratën e

169 Nga hetimi administrativ i çështjes së ankueses Zh.P rezultoi mungesa e informimit të viktimës mbi vendimin e vazhdimit të efekteve të urdhrit të mbrojtjes, vendim i marrë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier. (ankesë e trajtuar nga AP, nr. dok. 201400928/4, 2014).

170 AP, Raport vjetor "Për veprimtarinë e Avokatit të Popullit", 1 janar-31 dhjetor 2014.

171 http://www.sociale.gov.al/files/documents_files/Raporti_Final_Pekin+20_dt_30.04.2014.pdf f. 32.

172 Të dhënat janë mundësuar nga Zj. Fatbardha Hoxhalli, drejtore e qendrës kombëtare për viktimat e dhunës në familje, në shtator 2014.

173 Shërbimet e ofruara drejtpërdrejt nga qendra janë: ushqim, veshje, strehim i përkohshëm në qendër, mbështetje/këshillim individual, asistencë psikosociale, program për fëmijët, edukim arsimor për fëmijët, grupe mbështetëse terapeutike, menaxhim rasti, asistencë mjekësore, asistencë ligjore, kualifikim dhe trajnim profesional, aktivitete okupacionale, rehabilituese, përgatitje për referim dhe integrim, ndërmjetësim për riintegrim në familje, monitorim dhe vlerësim të rasteve pas referimit pranë qendrave riintegruese apo komunitetit, shërbime të mbështetura në komunitet për përfitueset në tranzicion etj.

punës, për shkaqe të justifikuara në bazë të nenit 153 të Kodit të punës. 2. Marrjen e masave për riorganizimin e stafit dhe shtimin në organikë të një juristi dhe një psikologeje si shumë të nevojshëm dhe të domosdoshëm. 3. Marrjen e masave për ruajtjen dhe shoqërimin me njerëz të specializuar, me mjetin e institucionit të grave dhe fëmijëve kur ato dalin jashtë qendrës. 4. Trajnimin e vazhdueshëm të stafit në lidhje me trajtimin dhe komunikimin, që ato duhet të kenë me gratë dhe fëmijët e strehuar në këtë qendër. 5. Hartimin e një rregulloreje të brendshme, shumë të nevojshme, ku të përcaktohen qartë të drejtat dhe detyrimet e stafit dhe grave të strehuara, rregulla të cilat të mos bien ndesh me Kushtetutën dhe liritë themelore të njeriut. 6. Detyrimin e MPÇSSHB për nxjerrjen e udhëzimit për zbatimin e standardeve sipas VKM nr. 505, dt. 13.07.2011. 7. Përmirësimin e trajtimit ushqimor. Këto rekomandime janë realizuar.

305. Megjithatë, streha vazhdon të aplikojë kritere pranimi që s'ka pse të jenë aq të shtrënguara[174]. Viktimat e dhunës në familje mund të përfitojnë akomodim ose shërbime të tjera të ofruara pranë kësaj qendre, vetëm nëse janë të pajisura me UM/UMM. Sigurimi i shërbimeve nuk duhet të varet nga gatishmëria e viktimës për të ngritur akuza ose për të dëshmuar kundër një dhunuesi[175]; Periudha e 48 orëve brenda të cilave gjykata vendos në lidhje me lëshimin e UMM dhe mosofrimi i akomodimit për viktimat deri në marrjen e këtij urdhri, i përball ato me një rrezik të lartë për jetën.

306. Standardet e shërbimeve të përcaktuara me VKM nr. 505, datë 13.07.2011, "Për miratimin e standardeve të shërbimeve të perkujdesit shoqëror për viktimat e dhunës në familje, në qendrat rezidenciale, publike dhe jo publike" drejtojnë punën e stafit të qendrës kombëtare të trajtimit të viktimave të dhunës. Detyrimit për përmbushjen e tyre nuk i përgjigjen si duhet burimet njerëzore dhe financiare, si mungesa e një juristi me kohë të plotë, psikologu me kohë të plotë, etj.

307. Problem tjetër, i evidentuar edhe në raportin vjetor 2011 të punës së Avokatit të Popullit është dhe fakti që: Strategjia Kombëtare "Për barazinë gjinore dhe kundër dhunës me bazë gjinore dhe asaj në familje 2011-2015" e miratuar me VKM nr. 573 date 16.06.2011 ka parashikuar, ndër të tjera, dhe nënkontraktimin e OJF-ve për të ofruar shërbimet përkatëse për viktimat e dhunës në familje. Mundësia dhe detyrimi për të bashkëpunuar ndërmjet organeve të qeverisjes vendore dhe qendrore për shërbimet sociale është vendosur qartësisht në Ligjin nr. 9669, date 18.12.2006 "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare". Por zbatimi rigoroz i këtij ligji kërkon financim të organizatave të shoqërisë civile nga organet kompetente shtetërore, në mënyrë që ato të kryejnë siç duhet shërbimet për viktimat e dhunës në familje, për parandalimin e saj dhe rehabilitimin e dhunuesve[176]".

308. Në bashkitë e mëdha ka një numër të madh OJF-sh që ofrojnë shërbime, por njësitë e qeverisjes vendore nuk kanë marrëveshje me organizatat për të shfrytëzuar këto kapacitete. Ato, në përgjithësi nuk prokurojnë shërbime të përkujdesit shoqëror[177].

"Nuk ka një bazë ligjore të detajuar që të mbështesë mirëfilli dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë kontraktimin, delegimin dhe prokurimin e OJF-ve për shërbimet sociale nga organet e pushtetit vendor."[178].

*Rekomandime:*

309. Rekomandohet të forcohen MKR ekzistuese për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje, në mënyrë efektive.

174 http://www.integrimi.gov.al/al/dokumenta/progres-raporte/progres-raporti-2014&page1

175 neni 18 i Konventës së Këshillit të Evropës "Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës të grave dhe dhunës në familje".

176 Avokati i Popullit, Raport i veçantë, "Për dhunën ndaj grave dhe veprimtarinë e Avokatit të Popullit", korrik 2012, fq. 33. (nr. 208, datë 24.07.2012)

177 Komiteti Shqiptar i Helsinkit, "Reforma në shërbimet sociale dhe roli i njësive të qeverisjes vendore", Tiranë 2014. fq. 45.

178 http://www.qag-al.org/WEB/publikime/kontraktimi_ojf.pdf

310. Rekomandohet ngritja në të gjitha njësitë e qeverisjes vendore, e mekanizmave të referimit të rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare[179].

311. Të rritet ndërgjegjësimi i njësive të pushtetit vendor mbi buxhetimin e prioriteteve gjinore, duke i bërë çështjet gjinore pjesë të politikave dhe planeve të veprimit të hartuara në nivel vendor.

312. Rekomandohet marrja e masave ligjore dhe ndërgjegjësimi i aktorëve përgjegjës, me qëllim që sigurimi i shërbimeve të mos varet nga gatishmëria e viktimës për të përdorur mjetet ligjore ose për të dëshmuar kundër një dhunuesi.

313. Rekomandohet zbatimi i masave të parashikuara në Strategjinë Kombëtare "Për barazinë gjinore dhe kundër dhunës me bazë gjinore dhe asaj në familje 2011-2015", që kërkojnë krijimin e procedurave dhe mundësive për nënkontraktimin e OJF-ve, për të ofruar shërbimet përkatëse për viktimat e kësaj dhune[180].

314. Rekomandohet ngritja e një linje telefonike kombëtare që funksionon 24 orë në ditë gjatë 7 ditëve të javës, që do të ofronte mbështetjen e viktimave të dhunës në familje gjatë 24 orëve, duke iu përgjigjur të gjitha formave të dhunës me profesionalizëm dhe respektim të konfidencialitetit;

315. Sipas nenit 10 të Ligjit "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore"[181](2000), rekomandohet që "njësitë e qeverisjes vendore, bazuar në të ardhurat që mbledhin, të programojnë fonde të posaçme për ngritjen e shërbimeve në territorin ku ato kanë juridiksionin e tyre, duke qenë se shërbimet shoqërore janë funksione të vetë bashkive dhe komunave"[182].

316. Rekomandohet forcimi i bashkëpunimit të pushtetit qendror dhe pushtetit vendor me organizatat jofitimprurëse që ofrojnë shërbime për viktimat e dhunës. Zbatimi me efektivitet i këtij bashkëpunimi kërkon të vlerësohet mundësia e financimit të organizatave të shoqërisë civile nga fondet e njësive të qeverisjes vendore, apo nga fondet buxhetore[183].

317. Rekomandohet organizimi i trajnimeve në vazhdimësi për anëtarët e ekipit teknik ndërdisiplinor për njohjen dhe zbatimin e të gjitha detyrimeve me të cilat i ngarkon Ligji nr. 9669, datë 18.12.2006, "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", i ndryshuar. Rekomandohet zbatimi i detyrimit ligjor për aktorët përgjegjës mbi informimin e viktimave të dhunës në familje, mbi hapat e ndjekur nga organet përgjegjëse dhe rezultatet e tyre. Ndryshimet në Kodin penal në vitin 2012 dhe 2013, në lidhje me dhunën në familje dhe ndryshimet në ligjin "Për ndihmën juridike" (2008), ligjin "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore (2005) etj., sjellin efekte në punën e këtij mekanizmi, të cilat duhen njohur nga anëtarët e MKR.

318. Koordinimi i veprimeve të organit të policisë, zyrave të përmbarimit dhe zyrave të shërbimeve sociale pranë bashkive do të mundësonte zbatimin e urdhrave të mbrojtjes, monitorimin e tyre në vazhdimësi dhe parandalimin e akteve të mëtejshme të dhunës në familje.

319. Rekomandohet regjistrimi i rasteve të dhunës në familje të trajtuara në nivel vendor, në të gjitha bashkitë e vendit.

320. Rekomandohet të përfshihet në detyrimet

179 Avokati i Popullit, raport i veçantë, "Për dhunën ndaj grave dhe veprimtarinë e Avokatit të Popullit", korrik 2012, fq. 36. (nr. 208, datë 24.07.2012)

180 Avokati i Popullit, raport i veçantë, "Për dhunën ndaj grave dhe veprimtarinë e Avokatit të Popullit", Korrik 2012, fq. 37. (nr. 208, datë 24.07.2012)

181 Ligji nr. 8652, datë 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore".

182 Avokati i Popullit, raport i veçantë "Për dhunën ndaj grave dhe veprimtarinë e Avokatit të Popullit", korrik 2012, fq. 25. (nr. 208, datë 24.07.2012)

183 AP, raport "Për zbatimin e masave të parashikuara në rekomandimet 6, 7, 10, 11 dhe 12 të BE për Shqipërinë, të cilat kanë lidhje me fushën e veprimtarisë së Avokatit të Popullit, si dhe aktiviteti i institucionit lidhur me këto rekomandime, gjatë periudhës janar-qershor 2012", Tiranë, korrik 2012, fq. 13.
http://www.avokatipopullit.gov.al/sites/default/files/ctools/Raport%20i%20vecante%20masat%20e%20BE.pdf

ligjore të aktorëve përgjegjës informimi i viktimave të dhunës në familje, në rastet kur viktima dhe familja e saj mund të jenë në rrezik, kur autori i veprës arratiset ose lirohet përkohësisht ose përfundimisht, standard i pranuar nga shteti shqiptar me Ligjin nr.104/2012, "Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës 'Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje'".

### 1.2. Kodi penal dhe mbrojtja nga dhuna në familje përmes zbatimit të tij.

321. AP vlerëson miratimin e ndryshimeve në Kodin penal me Ligjin nr. 23/2012[184], dhe Ligjin nr. 144/2013[185], në lidhje me dhunën në familje, si hap të rëndësishëm në përmbushje të VP të Komitetit CEDAW për Shqipërinë në vitin 2010 si dhe në VP të mëparshme. Me Ligjin nr. 23/2012, "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, "Kodi penal i republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, është shtuar në KE neni 130/a, "dhuna në familje", e cila përbën një vepër penale të veçantë. Përndjekja (neni 121/a i Kodit penal) përbën një vepër penale që dënohet me burgim nga gjashtë muaj gjer në katër vjet. Ligji sanksionon me masa më të larta dënimi kryerjen e kësaj vepre nga ish-bashkëshorti, ish-bashkëjetuesi apo personi që ka pasur lidhje shpirtërore me të dëmtuarin, duke parashikuar se dënimi rritet me një të tretat e dënimit të dhënë; kur vepra kryhet ndaj të miturit, gruas shtatzënë ose një personi të pazotë për t'u mbrojtur, si dhe kur kryhet nga një person i maskuar ose shoqërohet me mbajtjen ose me përdorimin e armëve, dënimi rritet deri në një të dytën e dënimit të dhënë.

Me Ligjin nr. 23/2012 është parashikuar se kryerja e veprimeve në kundërshtim me vendimin e gjykatës, në lidhje me detyrat e lindura nga urdhrat e mbrojtjes të dhëna prej saj, përbën kundërvajtje penale[186] dhe masa e dënimit është me burgim gjer në dy vjet.

322. Me Ligjin nr. 144/2013 konsiderohet si e kryer në rrethana rënduese kryerja e veprës penale gjatë ose pas dhënies së urdhrave gjyqësorë të mbrojtjes nga dhuna në familje"[187]. "Vrasja për shkak të marrëdhënieve familjare dënohet me burgim jo më pak se njëzet vjet ose me burgim të përjetshëm[188]." Neni 102 i KP, paragrafi i parë është ndryshuar si më poshtë: "Kryerja e marrëdhënieve seksuale me dhunë, me të rritura ose midis bashkëshortëve apo bashkëjetuesve, pa pëlqimin e njërit prej tyre, dënohet me burgim nga tre gjer në dhjetë vjet."

323. Shteti shqiptar ka siguruar se hetimet dhe ndjekja penale e këtyre veprave nuk janë tërësisht të varura nga një raport ose ankesë e paraqitur nga viktima, dhe se procedimi mund të vazhdojë edhe nëse viktima e tërheq deklaratën ose ankesën e saj, duke qenë kështu në pajtim edhe me Konventën e Stambollit[189]. Vepra e dhunës në familje me ndryshimet në legjislacionin penal ndiqet ex officio[190].

324. Institucioni i AP ka rekomanduar shtesën në Kodin penal të dispozitës "Ngacmimi moral në shtëpi", me këtë përmbajtje:"Ngacmimi i bashkëshortit, partnerit apo personit me të cilin bashkëjeton nëpërmjet veprimeve të përsëritura, që kanë për qëllim ose sjellin si pasojë degradimin e kushteve të jetës, duke çuar në prishjen e shëndetit fizik ose mendor të personit, dënohet me burgim deri në tre vjet, kur këto veprime kanë shkaktuar një paaftësi totale në punë për një kohëzgjatje më të shkurtër ose të barabartë me tetë ditë ose kur nuk kanë

184 Ligji nr. 23/2012, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 'Kodi penal i Republikës së Shqipërisë'", të ndryshuar.

185 Ligji nr. 144/2013, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 'Kodi penal i Republikës së Shqipërisë'", i ndryshuar.

186 Neni 321 i Kodit penal, "Veprime në kundërshtim me vendimin e gjykatës".

187 Kodi penal, neni 50, "Rrethanat rënduese", e/1. (ligji nr. 144/2013, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, "Kodi penal i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar)

188 Me Ligjin nr. 144/2013, neni 79/c, "Vrasja për shkak të marrëdhënieve familjare".

189 Konventa e Këshillit të Evropës "Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje", ratifikuar me ligjin nr. 104/2012;

190 Dhuna në familje nuk përfshihet në kategorinë e veprave penale që përcakton neni 59 i Kodit të procedurës penale që ndiqen me kërkesë të të dëmtuarit akuzues në gjykatë si dhe në kategorinë e veprave penale që ndiqen me ankim nga i dëmtuari, sipas nenit 284 të Kodit të procedurës penale.

shkaktuar asnjë lloj paaftësie në punë dhe me pesë vjet burg nëse ato kanë shkaktuar një paaftësi totale në punë për një kohëzgjatje më të madhe se tetë ditë. Dënimet e parashikuara në dispozitën e mësipërme aplikohen edhe për ngacmimet e kryera nga ish-bashkëshorti, ish-partneri apo personi me të cilin bashkëjetonte personi i dëmtuar". Ky rekomandim është dërguar në Ministrinë e Drejtësisë, por nuk është miratuar ende nga Kuvendi i Shqipërisë.

*Çështje të zbatimit të legjislacionit penal për mbrojtjen nga dhuna në familje:*

325. Gjatë vitit 2014 AP, pasi është njohur me veprimet hetimore të kryera në lidhje me veprat penale të dhunës në familje dhe vlerësimin nga policia të raportimeve të dhunës në familje, me qëllim përgatitjen e kërkesës për UMM/UM, si dhe me rastet dhe arsyet e mosvlerësimit etj., i ka rekomanduar drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit, në dijeni edhe ministrit të Brendshëm dhe prokurorit të përgjithshëm "Përmirësimin e punës parandaluese nga policia dhe luftë me efikasitet të organeve të zbatimit të ligjit për veprat penale të dhunës në familje". Është rekomanduar forcimi i rolit të policisë, me qëllim parandalimin e dhunës në familje dukë qenë më pranë komunitetit, bashkëpunimi me organet e qeverisjes vendore, rritja e shpejtësisë dhe efektivitetit në veprimet e policisë gjyqësore, me qëllim vënien para përgjegjësisë ligjore të autorëve të veprave penale të dhunës në familje si edhe marrja e masave për integrimin në shoqëri të viktimave të dhunës në familje. Raporti vjetor i vitit 2014 i AP e njeh këtë[191].

326. Nga Vjetari statistikor i Ministrisë së Drejtësisë për vitin 2014 rezulton se, për veprën penale të parashikuar nga neni 130/a i KP, "Dhuna në familje", gjykata ka shqyrtuar 531 çështje të dhunës në familje për të cilat 476 persona janë dënuar si vijon: 16 me gjobë, 452 deri në 2 vjet burg dhe 8 me 2-5 vjet burg. Në lidhje me nenin 321 të KP "Veprime në kundërshtim me vendimin e gjykatës", janë shqyrtuar 46 çështje gjyqësore, për të cilat janë dënuar 55 persona, duke përfshirë 3 të dënuar me gjobë dhe 52 të dënuar deri në 2 vjet burg.

327. Në lidhje me zbatimin e ndryshimeve në Kodin penal, një nga shqetësimet që kemi ngritur në raportet tona vjetore është se dhuna psikologjike është e vështirë të provohet dhe shpesh i lë autorët të pandëshkuar. Kjo gjetje merr një rëndësi të veçantë në kuadrin e ndryshimeve në Kodin penal dhe parashikimit të veprave penale që lidhen me dhunën psikologjike si "përndjekja" (vetëm 6 të dënuar për vitin 2013), "keqtrajtimi i të miturit" (vetëm 2 të dënuar për vitin 2013), etj., si edhe numrit të vogël të çështjeve të gjykuara me këtë objekt dhe personave të dënuar për kryerjen e këtyre veprave.

328. Në praktikë ka hezitim në lidhje me denoncimin e dhunës seksuale midis bashkëshortëve, ndërkohë që, jo rrallë ajo është bërë shkak për zgjidhjet e martesave. Konstatohet se rastet e ndjekjes penale për kryerjen e marrëdhënieve seksuale me dhunë midis bashkëshortëve apo bashkëjetuesve janë shumë të rralla. Kjo pranohet edhe në raportin e katërt periodik kombëtar mbi zbatimin e Konventës CEDAW, sipas të cilit, "... rezulton 1 procedim penal i regjistruar për kryerje të marrëdhënieve seksuale me dhunë midis bashkëshortëve/bashkëjetuesve (2013)[192]".

329. Institucioni i AP vlerëson si mjaft shqetësues në marrëdhëniet familjare numrin e vrasjeve të grave. Ky shqetësim është prezantuar edhe në raportin e katërt periodik kombëtar mbi zbatimin e Konventës CEDAW, ku për vitin 2013[193] janë raportuar 17 raste

330. AP ka ndjekur me iniciativë çështje të dhunës në familje ndaj grave me AK. Kështu, AP ka filluar me iniciativë rastin

191 Raporti vjetor i AP "Mbi aktivitetin e AP, 1 janar-31 dhjetor 2014", fq.12.

192 Raporti i katërt periodik kombëtar mbi zbatimin e Konventës "Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit të grave", miratuar me VKM nr. 806, datë 26.11.2014. Fletorja zyrtare e RSH nr. 187/2014, fq. 10186.

193 Raporti i katërt periodik kombëtar mbi zbatimin e Konventës " Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit të grave ", miratuar me VKM nr. 806, datë 26.11.2014. Fletorja zyrtare e RSH nr. 187/2014, fq. 10186

e shtetases me aftësi të kufizuar M.D., e dhunuar në marrëdhëniet familjare nga pjesëtarët e familjes[194]. (gusht 2013) Autoritetet përgjegjëse në zbatimin e legjislacionit nuk janë të ndërgjegjësuara mjaftueshëm mbi faktin se, aftësia e kufizuar përbën një faktor rreziku për përballjen e grave me dhunë në familje.

331. Vlerësimi i denoncimeve nga viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare merr një rëndësi të veçantë në rastet kur viktimat i përkasin grupeve vulnerable si, gra me aftësi të kufizuar[195], gra që i përkasin minoritetit rom ose egjiptian, etj. Nga ankesa të paraqitura para institucionit të AP kanë rezultuar mosveprime të punonjësve të policisë, në vend të përmbushjes së detyrimeve ligjore të vlerësimit të kallëzimit të viktimave të dhunës në marrëdhëniet familjare, marrjes së masave për kryerjen e ekspertimit mjeko-ligjor të viktimave etj. Janë evidente raste të përpjekjeve për pajtim të dhunuesit dhe viktimës nga ana e punonjësve të policisë apo aktorëve të tjerë përgjegjës, duke kryer kështu veprime në kundërshtim me frymën e legjislacionit për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje.

332. "Procesi i dëmshpërblimit të gruas që ka pësuar torturë ose dhunë seksuale, ose forma të tjera të keqtrajtimit, në praktikë është i vakët. Padia civile në procesin penal përdoret shumë rrallë.

194 AP ka ndjekur rastin M.D., një grua me AK, e cila është përballur me dhunë në marrëdhëniet familjare. (Gusht 2013).

195 Në rastin nr. 201302146, filluar me iniciativën e Avokatit të Popullit mbi bazën e medias së shkruar, pas hetimit të pavarur administrativ dhe shkuarjes në vend, në komunën Allkaj të Lushnjë, u konstatua se shtetasja M.D., person me aftësi të kufizuar, ishte keqtrajtuar dhe lidhur nga duart e këmbët me tel, prej babait K.D. dhe vëllait E.D. Pas ngjarjes, e dëmtuara ka shkuar për të bërë kallëzim penal në komisariatin e policisë Lushnjë, por nga punonjësi i policisë L.P, nuk është bërë vlerësimi i kallëzimit si, dhe përpilimi i kërkesës për lëshimin e urdhrit të mbrojtjes, për t'ia dërguar Gjykatës. Gjithashtu, punonjësi i policisë L.P. nuk ka përpiluar vendimin për kryerjen e ekspertimit mjeko-ligjor të të dëmtuarës. Ai ka marrë të akuzuarit në komisariatin e policisë dhe ka bërë ballafaqim verbal të të akuzuarve me të dëmtuarën M.D., duke i marrë një deklaratë në të cilën ajo është shprehur se "nuk kishte pasur asnjë presion nga familja dhe se nuk kanë përdorur dhunë ndaj saj".

333. AP ka shprehur shqetësimet dhe ka paraqitur rekomandimet mbi çështjen e dhunës në familje përmes raporteve vjetore dhe të veçanta. Kështu, në korrik të vitit 2012, AP ka përgatitur dhe paraqitur raportin e veçantë "Për dhunën ndaj grave dhe veprimtarinë e Avokatit të Popullit" pranë Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

*Rekomandime:*

*Në lidhje me kuadrin ligjor:*

334. Rekomandohet rishikimi i legjislacionit penal mbi dhunën në familje në frymën e Konventës së Këshillit të Evropës kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje. Rekomandohet rishikimi i legjislacionit me qëllim që viktimat, që kanë pësuar dëme të rënda trupore ose dëme të shëndetit të kompensohen mjaftueshëm nga shteti, brenda një afati kohor të arsyeshëm. Kjo bën të nevojshme krijimin e një skeme funksionale kompensimi që do të ndihmonte për rehabilitimin e viktimave të dhunës në familje dhe krimeve të tjera të dhunshme.

335. Rekomandohet që e drejta e viktimave për kompensim të bëhet e mundur jo vetëm në bazë të së drejtës civile apo administrative, por të mund të realizohet efektivisht edhe në bazë të së drejtës penale, si pjesë e një sanksioni të së drejtës penale.

336. Nevojitet miratimi i ndryshimeve në Kodin e procedurës penale, me qëllim përcaktimin e statusit të viktimave të krimeve të dhunshme, të drejtave të viktimave, (si e drejta për informim, përfaqësimi i viktimave me avokat në proces etj), rolit të autoriteteve përgjegjëse në lidhje me garantimin e të drejtave të viktimave në frymën e standardeve ndërkombëtare që shteti shqiptar ka pranuar. Rekomandimi në lidhje me ndryshimet ne KPrP, nr. 220, datë 12.08.2013 i është dërguar Ministrisë së Drejtësisë. Ndryshimet në KPrP ende nuk janë miratuar. Një çështje që meriton vëmendjen e duhur është e drejta e viktimave të veprave penale për të pasur një avokat mbrojtës në procesin penal.

337. Rekomandohet përfshirja e detyrimit ligjor të informimit të viktimave të dhunës

në familje, në rastet kur viktima dhe familja mund të jenë në rrezik, kur autori i veprës arratiset ose lirohet përkohësisht ose përfundimisht. Informimi i viktimës në lidhje me zhvillimin e hetimeve dhe procesin penal nga profesionistët e zbatimit të ligjit është i rekomandueshëm.

*Në lidhje me situatën de facto:*

338. Rekomandohet vlerësimi nga punonjësit e policisë i çdo rasti të denoncuar dhune në familje, me qëllim parandalimin e përshkallëzimit.

339. Rekomandohet rritja e punës së organeve të policisë dhe drejtësisë, me qëllim zbatimin e ndryshimeve të fundit të Kodit penal, identifikimin e autorëve të veprave penale të dhunës ndaj grave dhe dënimin e tyre në një kohë sa më të shkurtër, duke i dhënë fund pandëshkueshmërisë.

340. Përdorimi i mjetit të padisë civile në procesin penal kërkon edhe rritjen e ndërgjegjësimit të profesionistëve të sistemit të drejtësisë, në lidhje me të drejtën për kompensim të viktimave të dhunës në familje, rritjen e ndërgjegjësimit të viktimave të dhunës në familje në lidhje me këtë të drejtë dhe garantimin e ndihmës juridike etj.

341. Rekomandohet organizimi i trajnimeve të vazhdueshme nga SHM për gjyqtarë, prokurorë dhe oficerë të policisë gjyqësore në lidhje me njohjen e ndryshimeve të fundit të Kodit penal, njohjen e formave të veçanta të dhunës në familje si dhuna psikologjike, seksuale, etj., dhe forcimin e një qasjeje të orientuar nga viktimat e veprave penale.

342. Rekomandohet vënia para përgjegjësisë e aktorëve përgjegjës që nuk përmbushin detyrimet e parashikuara në Ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006, "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", i ndryshuar, ose që kryejnë veprime ose mosveprime diskriminuese.

343. Rekomandohet forcimi i rolit të Kuvendit të Shqipërisë në lidhje me adresimin e dhunës në familje nëpërmjet përmirësimeve të legjislacionit, rezolutave, etj. Rekomandohet diskutimi në kohë i raporteve të veçanta të institucionit të AP në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, me qëllim publikimin dhe përdorimin e rezolutave si një mjet për përmirësimin e punës.

*Në lidhje me format e tjera të dhunës ndaj grave:*

344. AP ka treguar vëmendje edhe ndaj formave të tjera të dhunës me bazë gjinore, si trafikimi i qenieve njerëzore, që përbën një fenomen që ndikon në mënyrë disproporcionale mbi gratë. Duke vlerësuar ndryshimet në kuadrin ligjor dhe rolin e politikave, AP dërgoi në datën 17.02.2014 rekomandimin për përgatitjen dhe dërgimin për miratim në Këshillin e Ministrave të "Planit të ri Kombëtar të Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore" dhe të "Planit të Veprimit për Luftën Kundër Trafikimit të Fëmijëve dhe Mbrojtjen e Fëmijëve, Viktima të Trafikimit". Garantimi në praktikë i të drejtave të viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore kërkon një angazhim më të madh nga aktorët përgjegjës. Miratimi i ndryshimeve në KPrP do të forcojë qasjen e orientuar nga viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore si një nga format e dhunës me bazë gjinore. Çështje të aksesit të viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore në ndihmën juridike, përfitimet ekonomike dhe shërbimet sociale janë trajtuar në raport.

# E. AKSESI NË PËRFITIME EKONOMIKE DHE NË SHËRBIME SOCIALE[196]

Neni 13 i Konventës CEDAW, paragrafi nr.36 & 37 i VP.

## 1. Aspekte të aksesit të grave në ndihmën dhe shërbimet shoqërore. Situata ligjore.

196 Në këtë pjesë trajtohen çështje që lidhen edhe me nenin 4 të Konventës CEDAW, si edhe paragrafin nr. 37 të vërejtjeve përmbyllëse të Komitetit CEDAW për Shqipërinë në 2010.

345. Legjislacioni për ndihmën dhe shërbimet shoqërore është përmirësuar gjatë periudhës së raportimit, duke ofruar de jure më shumë mundësi për rritjen e aksesit të grave në këto përfitime dhe shërbime. Ligji nr. 10 399, datë 17.3.2011, "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9355, datë 10.3.2005, 'Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore'", përcakton si subjekte që përfitojnë ndihmë ekonomike edhe viktimat e trafikimit, pas daljes nga institucionet e përkujdesit shoqëror, deri në çastin e punësimit të tyre si edhe viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare, për periudhën e vlefshmërisë së urdhrit të mbrojtjes ose të urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes"[197]. Masa e ndihmës ekonomike është 3000 lek në muaj. Në ligj parashikohet se secili prej bashkëshortëve, në rastet kur ata janë në proces zgjidhjeje martese dhe nuk ka ende një vendim gjykate të formës së prerë, mund të paraqesë kërkesë për ndihmë ekonomike. Në këtë rast, masa e përfitimit të ndihmës ekonomike caktohet e ndarë për të dy bashkëshortët. Edhe aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji kanë sjellë rregullime, me efekte tek gratë. Vendimi nr. 375, datë 11.06.2014, "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 904, datë 12.12.2012, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kritereve, të procedurave dhe dokumentacionit të përfitimit të ndihmës ekonomike në zonat pilot", parashikon se bashkëshortja ka të drejtën për të tërhequr dhe marrë në dorëzim ndihmën ekonomike. Udhëzimi nr. 9, datë 23.6.2014, "Mbi zbatimin e VKM nr. 904, datë 12.12.2012, "Për përcaktimin e kritereve, të procedurave dhe të dokumentacionit të përfitimit të ndihmës ekonomike, në zonat pilot", përcakton bashkëshorten si përgjegjëse për tërheqjen dhe marrjen në dorëzim të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe parashikon procedura të thjeshta për përfitimin e ndihmës ekonomike për individët në nevojë dhe viktimat e trafikimit dhe dhunës në familje. Kështu, viktimat e trafikimit paraqesin, përveç çertifikatës individuale dhe fotokopjes së kartës së idEntit, një vërtetim trajtimi në institucionet e përkujdesjes shoqërore. Ndërsa viktimat e dhunës në familje, përveç çertifikatës familjare dhe fotokopjes së kartës së idEntit, paraqesin UM/UMM. Me VKM nr. 505, datë 13.07.2011, "Për miratimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për viktimat e dhunës në familje, në qendrat rezidenciale, publike dhe jopublike" janë miratuar standardet e shërbimeve për viktimat e dhunës në familje, me qëllim rritjen e cilësisë së jetesës së viktimave dhe vënien në qendër të shërbimeve të viktimave dhe të drejtave të tyre.

346. Institucioni i AP vlerëson ndryshimet e bëra në Ligjin 9355/2005 sipas të cilave kushtëzohet shpërndarja e NE me punë komunitare dhe kufizohet në kohë NE. Është e rëndësishme që parashikimet e këtij ligji të zbatohen.

347. Me një vëmendje të veçantë për zonat rurale, AP ka rekomanduar të ofrohen në këto zona, programe të posaçme të lidhjes së ndihmës ekonomike me arsimimin e fëmijëve, shëndetësinë, etj. Ky rekomandim është zbatuar. Me ndryshimet e vitit 2014, në Ligjin nr. 9355, datë 10.03.2005, "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", i ndryshuar, është parashikuar mbështetja me subvencione shtesë për çdo fëmijë që ndjek arsimin e detyrueshëm dhe për çdo fëmijë të vaksinuar të familjeve të skemës së ndihmës ekonomike.

348. Reforma e shërbimeve sociale në Shqipëri është një reformë që orientohet nga parimi i barazisë dhe mosdiskriminimit. Transformimi i pjesshëm nga shërbimi rezidencial në atë ditor, deinstitucionalizimi i këtyre shërbimeve dhe ofrimi i shërbimeve të reja më afër përfituesve janë disa nga risitë që sjell reforma e shërbimeve sociale. Procesi i hartimit të strategjisë së përfshirjes sociale 2015-2020 përshkohet nga perspektiva gjinore.

197 Neni 2, i ligjit nr. 10 399, datë 17.3.2011, "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9355, datë 10.3.2005 'Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore', i ndryshuar".

## 2. Situata faktike në lidhje me aspekte të aksesit të grave në ndihmën dhe shërbimet sociale.

*Në lidhje me ndihmën ekonomike:*

349. Pavarësisht mundësive që ofron Ligji nr. 9355, datë 10.3.2005, "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, në një numër rastesh gratë kryefamiljare janë përballur me përjashtime nga skema e ndihmës ekonomike. Projekti pilot i shpërndarjes së ndihmës ekonomike familjeve në nevojë, në mënyrë elektronike dhe bazuar në formulën e pikëzimit, u shtri në qytetet Tiranë, Durrës dhe Elbasan. Kriteret, procedurat dhe dokumentacioni i përfitimit të ndihmës ekonomike në zonat pilot janë përcaktuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 904 datë 12.12.2012[198]. Zbatimi i këtij projekti është shoqëruar me probleme, të cilat janë reflektuar në ankesat e paraqitura. Në datën 04.12.2014 janë regjistruar rreth 250 ankesa me objekt "përjashtimin nga skema e ndihmës ekonomike". "Ka rezultuar se nga zbatimi i projektit pilot për përfitimin e ndihmës ekonomike në qytetet Tiranë, Elbasan, Durrës, janë përjashtuar nga skema e përfitimit të kësaj ndihme kryefamiljarë që jetojnë vetëm, si dhe familje me pak anëtarë[199]. Gjatë vitit 2014, janë paraqitur pranë institucionit të AP 185 ankesa për mospërfitim apo ndërprerje të ndihmës ekonomike, 72 prej të cilave janë paraqitur nga gratë. Ankesat e shqyrtuara kanë konsistuar kryesisht në pretendime për masën e përfitimit të ndihmës ekonomike, ndërprerjen e ndihmës ekonomike, parregullsi dhe vonesa në dhënien e pagesës së ndihmës ekonomike, mospërfshirjen e familjeve të ngujuara në skemat e ndihmës ekonomike, etj. AP ka kontribuar në zgjidhjen e ankesave përmes fuqisë së rekomandimeve për organet e pushtetit vendor dhe SHSSH.

350. Rezulton se në disa bashki është krijuar një praktikë e mirë në lidhje me përfitimin e ndihmës ekonomike nga gratë e dhunuara në marrëdhëniet familjare, të pajisura me UMM/UM. Numri i femrave, viktima të trafikimit të qenieve njerëzore, që kanë përfituar ndihmë ekonomike është i kufizuar. Këtu ka pasur ndikimin e vet edhe mentaliteti shoqëror dhe paragjykimet e këtij mentaliteti në lidhje me viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore të shfrytëzuara për qëllime seksuale. AP vlerëson se masa e ndihmës ekonomike që marrin gratë kryefamiljare, viktimat e dhunës në familje dhe viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore është e pamjaftueshme për të adresuar nevojat e tyre për rehabilitim.

351. Kërkesat e paraqitura pranë AP tregojnë se niveli i informacionit të qytetarëve, përfshirë gratë, në lidhje me përfitimet nga legjislacioni i ndihmës ekonomike nuk është në nivelin e duhur.

*Në lidhje me pagesat për PAK, përfshirë gratë:*

352. Nga ankesat e paraqitura para institucionit të Avokatit të Popullit rezulton se ka pasur vonesa për muaj të tërë në lidhje me pagesat e kryera nga pushteti vendor, bashkitë/komunat në lidhje me personat me AK, përfshirë gratë. Kështu, në vitin 2012 janë trajtuar 8 ankesa të paraqitura nga gratë dhe në vitin 2013 janë trajtuar 65 ankesa të paraqitura prej tyre. Gjatë vitit 2014 nga 57 ankesa për të drejtat e PAK, 11 ankesa janë paraqitur nga gratë. Një pjesë e ankesave kanë pasur në objektin e tyre vonesa në pagesën e verbërisë. Institucioni ynë i ka dërguar rekomandim MMSR si dhe MF për kryerjen e pagesave. AP ka rekomanduar lëvrimin sa më parë të fondeve për pagesën e vonuar të personave me aftësi të kufizuar, me rekomandimin Nr. Dok. 201204106/2, 2012. Të gjitha ankesat e shqyrtuara janë zgjidhur me çeljen e fondeve përkatëse.

353. Me rekomandimin nr. Dok. 201300614/2, 2013 është rekomanduar lëvrimi sa

198 Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 904, datë 12.12.2012, "Për përcaktimin e kritereve, të procedurave dhe dokumentacionit të përfitimit të ndihmës ekonomike në zonat pilot".

199 Komente dhe mendime të Avokatit të Popullit për progres-raportin e KE-së për Shqipërinë për 2014, Tiranë 2014, fq. 3. Procesverbali i mbledhjes dt. 12.11.2014 i komisionit për çështjet ligjore, administratën publike dhe të drejtat e njeriut, seancë dëgjimore me Avokatin e Popullit për progres-raportin e vitit 2014.

më parë i fondeve për pagesën e subvencionimit të faturave të energjisë elektrike ndaj personave me aftësi të kufizuar, përfshirë gratë me AK, në bashkinë Berat. Ky rekomandim drejtuar MMSR si dhe MF është zbatuar dhe kanë përfituar edhe gratë PAK.

*Shpërblimi për lindje:*

354. Sigurimi për lejen e lindjes përfshin, përveç të ardhurave për barrëlindje, të ardhurat për kompensim barrëlindje, dhe shpërblim për lindje fëmije. AP ka marrë ankesa nga qytetare, në lidhje me mosmarrjen e shpërblimit për lindje dhe ka kontribuar për zgjidhjen e tyre.

*Në lidhje me aksesin në shërbimet e përkujdesit shoqëror:*

355. Ndonëse me ligj parashikohet aksesi i qytetarëve, përfshirë gratë në shërbimet sociale, situata faktike lë për të dëshiruar në lidhje me shpërndarjen gjeografike të shërbimeve sociale, aksesin real të grave në këto shërbime, grave me AK, sa lehtësisht përfitojnë nga këto shërbime gratë e trafikuara dhe gratë e dhunuara në marrëdhëniet familjare, pavarësisht përdorimit të mjeteve ligjore.

356. AP ka kontribuar në përmirësimin e standardeve të qendrës kombëtare pritëse për viktimat e trafikut, Linzë përmes konstatimit të nevojave për arsimin e përfitueseve, ofrimin e shërbimeve të psikologut dhe përkthyesit me kohë të plotë si edhe rekomandimeve për adresimin e problemeve.

357. Buxhetimi i shërbimeve shoqërore në disa bashki është mundësuar me mbështetjen e UN Women, UNDP, etj. Shumat që disa bashki kanë parashikuar në buxhetin e tyre për adresimin e çështjeve gjinore janë të limituara. Pavarësisht parashikimeve ligjore, buxheti për ndihmën dhe shërbimet shoqërore përballohet kryesisht nga buxheti i shtetit. AP ka tërhequr vëmendjen edhe në lidhje me qëndrueshmërinë e shërbimeve, sidomos në kuadrin e decentralizimit të tyre.

358. Megjithëse Strategjia Kombëtare "Për barazinë gjinore, kundër dhunës me bazë gjinore dhe asaj në familje (2011-2015)" parashikon nënkontraktimin e OJF-ve, për ofrimin e shërbimeve sociale, hapat e hedhur në këtë drejtim janë të pamjaftueshëm. Nevojitet të ndërmerren iniciativa ligjore, megjithëse kjo strategji ka parashikuar përmirësimin e legjislacionit të prokurimeve dhe financimin publik që mundëson kontraktimin e shërbimeve nga organizatat jofitimprurëse të specializuara gjatë viteve 2011-2013

359. Nga inspektimet e kryera nga AP në institucionet rezidenciale për kujdesin dhe zhvillimin e personave me aftësi të kufizuar, për të moshuarit etj., përfshirë gratë ka rezultuar se kushtet e jetesës lënë për të dëshiruar, ka mungesë fondesh për investime dhe mungesa në burimet njerëzore. Rekomandime nga institucioni i AP u janë drejtuar kryetarëve të bashkive dhe Shërbimit Social Shtetëror në lidhje me institucionet rezidenciale të inspektuara.

## 3. Rekomandime në lidhje me ndihmën dhe shërbimet sociale.

*Në lidhje me ndihmën ekonomike dhe gratë me AK:*

360. Të rishikohet formula e sistemit të pikëzimit për përfitimin e ndihmës ekonomike, të kryhet një analizë e kujdesshme e përmbajtjes së pyetësorit të formularit që aplikohet për përcaktimin e pikëzimit dhe të rishikohet pyetësori dhe formulari. Rekomandohet kryerja e rivlerësimit të të gjitha rasteve të pikëzimit për ato familje që janë përjashtuar nga përfitimi i ndihmës ekonomike.[200] Ky rekomandim është dërguar pranë MMSR dhe kjo ministri është shprehur se do të angazhohet për rishikimin e koeficienteve, me qëllim një përfshirje më të gjerë të grupeve në

200 Komente dhe mendime të Avokatit të Popullit për progres-raportin e KE-së për Shqipërinë për 2014, Tiranë 2014, fq. 3. Procesverbali i mbledhjes dt. 12.11.2014 i komisionit për çështjet ligjore, administratën publike dhe të drejtat e njeriut, seancë dëgjimore me Avokatin e Popullit për progres-raportin e vitit 2014.

nevojë, përfshirë gratë[201]. Përmbushja e këtyre rekomandimeve do të sillte efekte pozitive tek gratë, veçanërisht tek gratë kryefamiljare.

361. Rekomandohet rishikimi i masës së ndihmës ekonomike. Në rastin e viktimave të dhunës në familje dhe viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore, rishikimi të kryhet me qëllim që kjo ndihmë t`i shërbejë rehabilitimit të këtyre subjekteve.

362. Rekomandohet ofrimi i programeve nga organet e qeverisjes vendore për angazhimin e përfituesve të ndihmës ekonomike në shërbime komunitare, me qëllim rritjen e të ardhurave dhe fuqizimin e grave përfituese.

363. Rekomandohet kryerja në kohë nga pushteti vendor e pagesave të ndihmës ekonomike, pagesave për PAK apo individë të tjerë në nevojë, përfshirë gratë.

*Në lidhje me aksesin në shërbimet e përkujdesit shoqëror:*

364. Duke njohur rolin që mund të luajë pushteti vendor në lidhje me ofrimin e shërbimeve sociale, rekomandohet ngritja, funksionimi dhe ofrimi i shërbimeve sipas standardeve të miratuara, të monitoruara dhe vlerësuara në bashkëpunim më SHSSH. Rekomandohet që monitorimi të orientohet nga përfituesit dhe gjinia e tyre. Është i rekomandueshëm përmirësimi i shpërndarjes, tipologjisë së shërbimeve shoqërore, llojshmërisë së tyre në përputhje me nevojat e grupeve vulnerable, përfshirë gratë.

365. Rekomandohet përmirësimi i shërbimeve në institucionet rezidenciale për gratë, përmes përmirësimit të kushteve dhe shtimit të personelit me kujdestarë, psikologë, punonjës socialë etj.

366. Rekomandohet të nxitet rritja e numrit të ofruesve të shërbimeve sociale publike dhe jopublike, në nivel vendor, me qëllim përmbushjen e nevojave të grave, në mënyrë të veçantë grave të margjinalizuara.

367. Rekomandohet të forcohet bashkëpunimi midis shtetit dhe organizatave jofitimprurëse në ofrimin e shërbimeve sociale për qytetarët, përfshirë gratë. Ligji "Për prokurimin publik" ka nevojë për plotësime dhe interpretime, përmes amendimeve ose akteve nënligjore që të parashikojë një procedurë të posaçme në rastet e shërbimeve sociale[202]. Rekomandohet të bëhen përmirësimet e nevojshme në ligjin "Për prokurimin publik", me qëllim kontraktimin e organizatave jofitimprurëse për ofrimin e shërbimeve shoqërore në nivel vendor, në mënyrë të veçantë për grupet në nevojë.

368. Rekomandohet të merren masa për zbatimin e Ligjit nr. 125/2013, "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat", me qëllim zhvillimin e procedurave të prokurimit publik për shërbimet sociale nga pushteti vendor.

369. Rekomandohet që dalja e grave, viktima të dhunës në familje dhe viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore nga institucionet e përkujdesjes shoqërore të shoqërohet me ofrimin e mundësive për punësim, me qëllim fuqizimin e tyre ekonomik. Kjo kërkon një kombinim më të mirë të skemave pasive me skemat aktive të punësimit të grupeve të veçanta si gratë e trafikuara, gratë e dhunuara në marrëdhëniet familjare etj.

## 4. Aksesi në hua bankare, ndihma hipotekare dhe forma të tjera të kredisë financiare.

370. Në lidhje me aksesin në kredi, hua bankare, ndihma hipotekare dhe forma të tjera të kreditit financiar, "në legjislacionin bankar, përfshirë edhe aktet rregullatore të Bankës së Shqipërisë, apo edhe manualet

201 Rekomandimi nr. K1/V12-4. prot, nr. dok. 201401869/4, datë 4.12.2014, "Rekomandohet marrja e masave konkrete për përmirësimin e formulës së sistemit të pikëzimit, për përfitimin e ndihmës ekonomike", drejtuar ministrit të MMSR, z. Erion Veliaj. http://www.avokatipopullit.gov.al/sites/default/files/ctools/css/REKOMANDIMI%20per%20ndihmen%20ekonomike.pdf

202 QNL, Raport, "Analizë e kuadrit ligjor mbi nënkontraktimin e OJF-ve nga organet qendrore dhe vendore, për shërbimet e dhunës në familje". Ky raport është i vlefshëm në www.qag-al.org

dhe rregulloret për kredidhënien nga bankat e nivelit të dytë, nuk ka ndonjë specifikë dalluese favorizuese për femrat. Gjithashtu, duhet nënvizuar se nuk ka asnjë klauzolë ligjore, rregullatore apo teknike që të bëhet pengesë për gratë."[203]

371. Mungojnë masa efektive në favor të lehtësimit të marrjes së kredive nga gratë, në mënyrë të veçantë gratë rurale, gratë me aftësi të kufizuar etj.

372. Masat pozitive që përfshijnë programe të posaçme mikrokrediti ose kredi të vogla, ose që përfshijnë partneritetin me institucionet financiare, të gatshme të japin kredi për gratë, janë të limituara dhe numri i grave përfituese është i vogël.

373. Raporte të organizatave jofitimprurëse evidentojnë se ka një nivel të pamjaftueshëm informacioni tek gratë, në lidhje me të drejtat e tyre për kredi financiare dhe detyrimet që ato kanë në rastin e dorëzanisë, me qëllim garantimin e shlyerjes së kredisë.

374. Edhe raporti i katërt periodik kombëtar mbi zbatimin e Konventës CEDAW pranon se "Aksesi i kufizuar në kredi dhe mungesa e kolateralit, si në rastin kur gratë janë ose jo të regjistruara si bashkëpronare ose kanë kolateral së bashku me burrat, i privon ato nga të drejtat për fillimin e bizneseve"[204].

*Rekomandime:*

375. Rekomandohet marrja e masave efektive, me qëllim rritjen e aksesit të grave në kredi, si një mjet për pavarësinë ekonomike të tyre përmes hapjes së bizneseve dhe fuqizimit të tyre ekonomik. Por, nga ana tjetër është e rekomandueshme edhe rritja e nivelit të informacionit të grave mbi këto të drejta.

203 A.Mandro, "Të drejtat pronësore të grave, rasti i Shqipërisë", Analizë e standardeve ligjore dhe e zbatimit të tyre në praktikë. Tiranë 2013, fq. 89. Është përgatitur me mbështetjen teknike dhe financiare të Entit të Kombeve të Bashkuara për barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave (UN Women) në bashkëpunim me MMSR dhe MD.

204 Raporti i katërt periodik kombëtar mbi zbatimin e Konventës "Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit të grave", miratuar me VKM nr. 806, datë 26.11.2014. Fletorja zyrtare e RSH nr. 187/2014, fq. 10203.

## 5. Situata ligjore dhe praktike në lidhje me të drejtat e pronësisë dhe regjistrimin e pasurisë së paluajtshme.

Neni 13 i Konventës CEDAW, paragrafi 36 dhe 37 i vërejtjeve përmbyllëse të Komitetit mbi Eliminimin e Diskriminimit të Grave.

376. Në kuadrin ligjor. AP vëren se mungojnë rregullime të plota në Kodin e familjes, në lidhje me barazinë në të drejta dhe detyrime midis bashkëjetuesve.

377. Në nivel politikash. AP ka vlerësuar hartimin e një strategjie të re për pronën, strategjinë ndërsektoriale, "Reforma në fushën e të drejtave të pronësisë, 2012-2020".

378. Në lidhje me situatën de facto. Ndonëse KC dhe Kodi i procedurës civile u njohin grave të drejta të barabarta me burrat në lidhje me pronësinë, zbatimi në praktikë i tyre nuk ka sjellë rezultate të barabarta.

379. Bashkëshortët janë më pak aktivë sesa bashkëshortet në paditë e pjesëtimit të pasurisë bashkëshortore, sepse ata gëzojnë de facto pasurinë dhe nuk kanë 'interes' nga pjesëtimi gjyqësisht. Shumica e vendimeve të pjesëtimit të pasurisë, ku paditëse janë gratë, pushohen. Monitorimi për GjRrGj Tiranë na e jep këtë të dhënë për mbi 70% të këtyre vendimeve. Tërheqja nga gjykimi me qëllim pushimin e çështjes është pa dyshim një e drejtë ligjore. Por, numri i lartë i grave që tërhiqen nga gjykimi i çështjes për të pjesëtuar gjyqësisht pasurinë bashkëshortore duket se nxitet edhe nga faktorë të tjerë socialekonomike apo dhe mungesa e informacionit juridik[205].

380. Niveli i njohjes së dispozitave të KC, KF mbi marrëdhëniet dhe regjimet pasurore dhe përdorimi i mjeteve ligjore nga gratë në lidhje me të drejtat pronësore është i pamjaftueshëm.

381. Nga një studim i Bankës Botërore rezulton se nga 27.741 femra pronare, shumica prej 9418 femra zotërojnë më pak se 25 % të

205 http://www.qag-al.org/WEB/publikime/raporti_shqip.pdf fq. 46.

pronës[206].

382. Praktika e fitimit të pronës me trashëgim ka evidentuar raste të mosrespektimit të të drejtës së bashkëshortes, si bashkëpronare në pasurinë e krijuar gjatë martesës. Kjo ka ndikuar mandej në përcaktimin e padrejtë të pjesëve të trashëgimtarëve të tjerë në cenim të të drejtave të bashkëshortes[207]. Në praktikë, pjesëtimi i pasurisë sipas trashëgimit fillon pa i zbritur 1/2 që i takon bashkëshortit/es pasjetues nga bashkëpronësia e bashkëshortëve. Pavarësisht të dhënave në rritje që raportohen në raportin e shtetit, në lidhje me numrin e grave që trashëgojnë pronësinë, situata praktike evidenton problematika me të cilat përballen gratë. Në lidhje me bashkëpronësinë e fituar nga trashëgimia ligjore, femrat shpesh heqin dorë nga pronësia e fituar. Raporte të OJF-ve tregojnë se, "Kjo ndodh për shkak të kulturës zakonore, por mund të ndodhë edhe për shkak të mashtrimit, frikës ose dhunës nga anëtarët meshkuj, përfitues të trashëgimisë"[208].

383. Mungojnë monitorime të zbatimit të Ligjit nr. 33/2012, "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" dhe efekteve që ky ligj ka sjellë për gratë. Neni 41 i këtij ligji, "Regjistrimi i pasurive të paluajtshme në bashkëpronësi" rregullon bashkëpronësinë midis bashkëshortëve duke parashikuar se, "Nëse pasuria, objekt i kontratës së kalimit të pronësisë, realizuar në favor të personave fizikë, të cilët në regjistrin e gjendjes civile kanë statusin e të martuarit, është pasuri e fituar gjatë martesës, në përputhje me nenin 76 të Kodit të familjes, regjistrimi në seksionin përkatës i kartelës së pasurisë bëhet në bashkëpronësi të të dy bashkëshortëve". Megjithëse kjo dispozitë ligjore parashikon në mënyrë të qartë detyrimin e ZVRPP për regjistrimin e bashkëshortit si bashkëpronar të prezumuar në rastet e fitimit të pronësisë gjatë martesës për shkak të regjimit pasuror martesor të bashkësisë ligjore, nuk ka një qëndrim të unifikuar nga punonjësit e ZVRPP në zbatimin e kësaj dispozite.

384. Shpesh, gruaja dhe bashkëshortja merret si garante/dorëzanëse/bashkëkredimarrëse, e cila nënshkruan kontratën e kredisë apo kontratën e dorëzanisë për shlyerjen e detyrimit të marrë si kredi[209]. Praktika ka sjellë në vëmendje raste të mungesës së informacionit nga gratë, se me nënshkrimin e kontratës ato janë përgjegjëse për shlyerjen e detyrimit të marrë nga bashkëshorti në rast se ai nuk e shlyen atë.

385. Reforma në fushën e të drejtave të pronësisë 2012-2020 kërkon respektimin e të drejtave të barazisë gjinore në dhënien e vendimeve për çështjet e pronësisë, por progresi vazhdon të jetë i pamjaftueshëm.

386. AP ka ngritur shqetësimin mbi mosekzekutimin nga organet shtetërore të vendimeve gjyqësore në lidhje me fitimin, njohjen, ndryshimin, pushimin e një të drejte pronësie të paluajtshme, ose një të drejte reale mbi të. Kjo praktikë ka sjellë efekte negative edhe mbi gratë.

*Regjistrimi i lejeve të legalizimit:*

387. Praktikat e ALUIZNI-t dhe përgatitja e dosjes në emër të kryefamiljarit dhe jo bazuar në çertifikatën familjare sjell efekte përjashtuese mbi gratë. Një raport i Bankës Botërore konfirmon aplikimin ditor shumë të ulët për regjistrimin e lejeve të legalizimit nga aplikante femra gjatë vitit 2013 për Tiranën: 384 femra dhe 2399 meshkuj. Arsyeja kryesore për këtë fakt mund të shpjegohet me numrin shumë të

---

206 Të dhëna të ndara sipas gjinisë-Ballkani Perëndimor. Raporte statistikore 2005-2013, fq. 60. http://www.fao.org/fileadmin/user_upload/nr/land_tenure/Genders_Report_WB.pdf

207 A. Mandro, "Të drejtat pronësore të grave. Rasti i Shqipërisë", Analizë e standardeve ligjore dhe e zbatimit të tyre në praktikë. Tiranë 2013, fq. 64. Ky studim është përgatitur me mbështetjen teknike dhe financiare të Entit të Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave (UN WOMEN) në bashkëpunim me MMSR dhe MD.

208 QNL, "Të drejtat pronësore dhe gruaja", Broshurë informuese, Tiranë 2014, fq. 10. Kjo broshurë është përgatitur nga qendra për nisma ligjore qytetare, me mbështetjen financiare dhe teknike të Entit të Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave në Shqipëri (UN Women) në kuadër të programit të bashkëpunimit ndërmjet Qeverisë së Shqipërisë dhe Kombeve të Bashkuara 2012-2016.

209 QNL, "Të drejtat pronësore dhe gruaja", Broshurë informuese, Tiranë 2014, fq. 20.

ulët të lejeve të legalizimit që janë lëshuar në emër të grave dhe vajzave, e cila provon impaktin negativ gjinor të zbatimit të ligjit mbi legalizimin dhe nevojën për përmirësim[210].

388. Pranë Institucionit të Avokatit të Popullit janë paraqitur një sërë ankesash nga qytetarët, përfshirë gratë të cilët kanë ngritur shqetësimin e zvarritjeve të procesit të legalizimit me vite të tëra. Ky proces është i lidhur me një sërë procesesh të tjera shumë të rëndësishme, sikurse ai i kthimit dhe kompensimit të pronës ish-pronarëve, regjistrimit të pasurive të paluajtshme, urbanizmit dhe planifikimit për urbanizim të zonave të banuara, etj. Në këto kushte, çdo vonesë në procesin e legalizimit, urbanizimit dhe integrimit të ndërtimeve pa leje është vonesë për gjithë zinxhirin e proceseve të tjera të lidhura me të[211]. Kjo praktikë ka sjellë efekte tek gratë në mënyrë të veçantë në regjistrimin e pasurive, pjesëtimin e pasurisë pas zgjidhjes së martesës, etj. Institucioni i AP ka rekomanduar "Realizimin e iniciativës legjislative për përmirësimin e dispozitave të Ligjit nr. 9482 datë 3.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", i ndryshuar, lidhur me përcaktimin e një afati unik taksativ të përcaktuar qartë, brenda të cilit duhet të përfundojnë procedimet administrative që lidhen me vendimmarrjen për legalizimin e ndërtimeve informale, apo shtesave informale në objektet me leje ndërtimi, kjo në përputhje me pikën 1, të nenit 81, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë". Statusi i këtij rekomandimi është: Rekomandim pa përgjigje.

389. AP vlerëson se procedurat për legalizimin e ndërtimeve informale si dhe urbanizimin dhe integrimin e tyre janë komplekse, në mënyrë të veçantë për grupet e margjinalizuara të grave.

210 "Të dhëna të ndara sipas gjinisë-Ballkani Perëndimor, raporte statistikore 2005-2013", fq. 70. http://www.fao.org/fileadmin/user_upload/nr/land_tenure/Genders_Report_WB.pdf

211 Rekomandim legjislativ për përmirësimin e dispozitave të Ligjit nr. 9482 datë 3.04.2006, "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", i ndryshuar, nr. K3/Th16-2, datë 19.11.2014, (nr. dok. 201401933/2), drejtuar ministres së Zhvillimit Urban dhe Turizmit, Zj. Eglantina Gjermeni dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integrimit të Zonave/ Ndërtimeve Informale, drejtorit të përgjithshëm, z. Artan Lame.

### 5.1. Rekomandime në lidhje me të drejtat pronësore të grave.

390. Strategjia ndërsektoriale, reforma në fushën e të drejtave të pronësisë 2012-2020, ka përcaktuar se, "Nevojiten përmirësime në legjislacion, rritje e aksesit të grave në institucionet për të drejtat e pronësisë, monitorimi i zbatimit të legjislacionit, trajnime të stafeve qendrore dhe lokale që merren me të drejtat e pronësisë, fushata sensibilizuese për informimin dhe promovimin e të drejtave të grave. Këto masa do të planifikohen në përputhje edhe me Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Reduktimin e Dhunës me bazë Gjinore e Dhunës në Familje dhe Planin e saj të Veprimit[212].

391. Në lidhje me forcimin e kapaciteteve. Nevojiten të organizohen trajnime me punonjës të Zyrave Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, me qëllim njohjen dhe zbatimin e Ligjit nr. 33/2012, "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", nenit 41/2 i cili rregullon bashkëpronësinë midis bashkëshortëve në mënyrë të unifikuar.

392. Rritja e ndërgjegjësimit dhe nivelit të informacionit. Të rritet niveli i informacionit të grave mbi dispozitat e KF mbi pronësinë gjatë martesës dhe pas zgjidhjes së saj, si edhe mbi të drejtat pronësore në bashkëjetesë. OJF-të duhet të forcojnë rolin e tyre në këtë drejtim.

393. Rekomandohet rritja e nivelit të informacionit të grave në zonat rurale për lehtësitë fiskale dhe kriteret vlerësuese mbështetëse që gëzojnë shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor, që drejtohen nga gratë.

394. Të forcohet në legjislacion dhe në praktikën e zbatimit të tij roli i zyrave noteriale në lidhje me informimin ligjor mbi të drejtat pronësore në martesë dhe bashkëjetesë.

212 Strategjia ndërsektoriale, Reforma në fushën e të drejtave të pronësisë 2012-2020. http://www.drejtesia.gov.al/ fq. 25.

395. Rekomandohet të shpejtohen dhe të thjeshtohen procedurat për legalizimin e ndërtimeve informale, si dhe urbanizimin dhe integrimin e tyre, me qëllim që gratë, në mënyrë të veçantë gratë vulnerabile, të mund të kenë akses në këto procedura.

396. Të unifikohen praktikat e ALUIZNI, me qëllim përgatitjen e dosjes bazuar në çertifikatën familjare dhe jo në aplikimin që më së shumti paraqitet nga kryefamiljari.

## 6. Në lidhje me gratë dhe strehimin.

397. Referuar numrit të ankesave të paraqitura pranë institucionit të AP rezulton se për periudhën tetor 2013-tetor 2014 janë trajtuar 119 ankesa me këtë objekt[213]. Për vitin 2014, institucioni i Avokatit të Popullit ka trajtuar 159 ankesa lidhur me objektivin e strehimit, prej të cilave në 50 ankesa subjekte ankimuese janë gratë. Kryesisht, objekti i këtyre ankesave lidhet me zvarritjen e procedurave për përfitimin nga një prej programeve sociale, mungesa e transparencës në vendimmarrje, etj. Nga këto ankesa rezulton se statusi i ankueseve gra është kryesisht “gra kryefamiljare dhe me fëmijë në ngarkim”.

398. Kriteret e parashikuara për përfitimin e strehimit nga pjesa më e madhe e familjeve që gëzojnë statusin e të pastrehit, veçanërisht komuniteti rom, përfshirë gratë, janë të vështira për t`u përmbushur.

399. Gjithashtu, edhe familje që kanë përfituar njëherë nga këto programe, janë përballur me rrezikun e nxjerrjes nga shtëpia, për shkak se nuk kanë mundur të paguajnë këstet e kredisë. Kështu, gjatë vitit 2014, AP ka ndjekur me shqetësim çështjen e disa pjesëtarëve të familjeve rome në qytetin e Korçës, të cilët rrezikonin të nxirreshin nga banesat e tyre për shkak të mospërmbushjes së detyrimeve të tyre kontraktuale. Në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Entit Kombëtar të Banesave në Tiranë, u vendos: rishikimi i kushteve të kontratës së kredisë për familjet të cilat ishin në pamundësi pagimi të késteve mujore; zgjatja e afatit të përgjithshëm të kontratës së kredisë për këto banesa sociale si edhe ndarja e shumës së kamatëvonesës në disa késte me qëllim që të ishte e përballueshme nga familjet. Gjithashtu, nga ana e Institucionit të Avokatit të Popullit është rekomanduar ofrimi i mundësive për punësim, në mënyrë prioritare për pjesëtarët e familjeve që kanë statusin e të pastrehit.

400. Pavarësisht se janë parashikuar si subjekt përfitues në Ligjin nr 54/2012[214], gratë dhe vajzat të mbijetuara nga forma të ndryshme të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje përballen me problemin e strehimit.

### 6.1. Rekomandime në lidhje me gratë dhe strehimin.

401. Institucioni i AP rekomandon që institucionet përkatëse të pushtetit qendror dhe vendor të bashkëpunojnë dhe bashkërendojnë veprimet për të shtuar programet e strehimit që ofrohen[215]. Shtimi i programeve do të rriste numrin e përfituesve, ndër të cilët edhe përfitueseve gra.

402. Rekomandohet trajtimi me prioritet i rasteve të veçanta dhe grupeve vulnerable si PAK, përfshirë gratë.

403. Gjithashtu, përfitimi de facto i grave dhe vajzave të dhunuara nga forma të ndryshme të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje, nga banesat sociale do të përbënte një mjet për riintegrimin e tyre.

404. Rekomandohet marrja e masave për

213 Komente dhe mendime të Avokatit të Popullit për progres-raportin e KE-së për Shqipërinë për 2014, Tiranë 2014, fq. 4. Procesverbali i mbledhjes dt. 12.11.2014 i komisionit për çështjet ligjore, administratën publike dhe të drejtat e njeriut, seancë dëgjimore me Avokatin e Popullit për progres-raportin e vitit 2014.

214 Ligji nr. 54/2012, datë 10.05.2012, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9232, datë 13.5.2004 ‘Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane’, të ndryshuar”.

215 Komente dhe mendime të Avokatit të Popullit për progres-raportin e KE-së për Shqipërinë për 2014, Tiranë 2014, fq. 5-6. Procesverbali i mbledhjes dt. 12.11.2014 i komisionit për çështjet ligjore, administratën publike dhe të drejtat e njeriut, seancë dëgjimore me Avokatin e Popullit për progres-raportin e vitit 2014.

funksionimin e vendstrehimeve provizore si një alternativë strehimi për grupet në nevojë, përfshirë gratë.

## 7. Sipërmarrja e grave.

405. Plani i veprimit për mbështetjen e gruas sipërmarrëse 2014-2020, në vijim të strategjisë së biznesit dhe investimeve për periudhën 2014-2020, synon të garantojë politika mbështetëse për gratë sipërmarrëse, ngritjen e kapaciteteve të tyre, përfshirje më të madhe në skemat e mbështetjes financiare, mbështetje të grave sipërmarrëse në zonat rurale etj.

406. Krijimi në vitin 2014 i fondit në mbështetje të gruas sipërmarrëse, me vlerë të përgjithshme 26 500 000 lekë, për një periudhë zbatimi katërvjeçare përbën një hap të rëndësishëm për fuqizimin ekonomik të grave, përmes subvencionimit të normës së interesit të kredive për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme të drejtuara nga gratë si pronare apo administratore.

*Rekomandime:*

407. Pavarësisht përpjekjeve, mbetet shumë për të bërë me qëllim përfitimin de fakto të grave nga iniciativat e ndryshme dhe rritjen e numrit të përfitueseve. Edhe raporti i katërt periodik kombëtar mbi zbatimin e Konventës CEDAW, sjell në vëmendje se nga 7 projektet e miratuara nga fondi i inovacionit, gjatë vitit 2013 nuk ka përfituar asnjë grua sipërmarrëse”[216].

408. Rekomandohen iniciativa që forcojnë ndërmarrjet e drejtuara ose të administruara nga gratë. Monitorime të rregullta të efekteve të fondit mbi gratë sipërmarrëse janë të nevojshme.

216 Raporti i katërt periodik kombëtar mbi zbatimin e Konventës “Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit të grave”, miratuar me VKM nr. 806, datë 26.11.2014. Fletorja zyrtare e RSH nr. 187/2014, fq. 10203.

# F. BUXHETIMI GJINOR

Neni 3 Hapa të ndërmarrë në kuadrin ligjor dhe zbatimin e tij.

Institucioni i AP vlerëson se “Integrimi gjinor duhet të jetë pjesë e gjithë politikave sociale, ekonomike dhe politike në Shqipëri për të pasur arritjen e një zhvillimi të qëndrueshëm nëpërmjet shfrytëzimit të potencialit të plotë njerëzor të vendit, sikurse dhe garantimit të gëzimit të këtyre arritjeve nga të gjitha grupet shoqërore[217]”.

*Në nivel qendror:*

409. VKM Nr. 465, datë 18.7.2012 “Për integrimin gjinor në programin buxhetor afatmesëm” përbën një hap të rëndësishëm drejt buxhetimit të çështjeve të barazisë gjinore. Me këtë vendim, tashmë të gjitha institucionet e linjës, duke filluar nga viti 2013 duhet të përfshihen në procesin e buxhetimit gjinor dhe të përcaktojnë në buxhetet e tyre tregues të matshëm për barazinë gjinore, duke synuar integrimin e perspektivës gjinore në procesin buxhetor ekzistues. Ndër të tjera, ky vendim synon të harmonizojë buxhetimin gjinor me Strategjinë Kombëtare “Për barazinë gjinore dhe eliminimin e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje 2011-2015”. Ky vendim u pilotua gjatë vitit 2013 në dy ministri dhe gjatë vitit 2014 në 8 ministri (9 programe buxhetore)[218].

410. Udhëzimi nr. 21, datë 21.06.2013 “Për përcaktimin e procedurave për integrimin gjinor në programin buxhetor afatmesëm” përcakton procedura të qarta në lidhje me përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2014-2016, në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 465, datë 18.07.2012 “Për integrimin gjinor në programin buxhetor afatmesëm”. Ky udhëzim përcakton detyrimin e të gjitha ministrive të linjës të përzgjedhin ato programe buxhetore për të cilat do të

217 Avokati i Popullit, raport i veçantë “Për dhunën ndaj grave dhe veprimtarinë e Avokatit të Popullit”, korrik 2012, fq.36. (nr. 208, datë 24.07.2012).

218 Raporti i katërt periodik kombëtar mbi zbatimin e Konventës “Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit të grave”, miratuar me VKM nr. 806, datë 26.11.2014. Fletorja zyrtare e RSH nr. 187/2014, fq. 10181.

zbatohet buxhetimi gjinor, mbështetur në objektivat e Strategjisë Kombëtare "Për barazinë gjinore dhe reduktimin e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje, 2011-2015". Të gjitha ministritë e linjës në vlerësimin e kërkesave për grante konkurruese të paraqitura nga njësitë e pushtetit vendor përfshijnë në kriteret e vlerësimit edhe kritere për arritjen e barazisë gjinore. Udhëzimi parashikon se gjatë vlerësimit dhe miratimit të projekteve të dërguara nga sekretariatet përkatëse të ministrive të linjës, sekretariati i fondit për zhvillimin e rajoneve (DEBASKON) pranë Këshillit të Ministrave, mban parasysh integrimin e perspektivës gjinore.

411. Përmes organizimit të trajnimeve janë rritur kapacitetet e specialistëve të drejtorive të planifikimit të buxhetit dhe nëpunësve gjinorë të ministrive mbi buxhetimin gjinor në programin buxhetor afatmesëm. Gjatë vitit 2012, trajnimet u ndoqën nga 248 pjesëmarrës (165 gra dhe 83 burra) të cilët ishin specialistë të politikave, programeve, financës dhe barazisë gjinore nga qeverisja qendrore (65 pjesëmarrës: 59 gra dhe 6 burra) si edhe qeverisja vendore (183 pjesëmarrës: 106 gra dhe 77 burra)[219].

412. Nuk janë emëruar nëpunës të barazisë gjinore me kohë të plotë në të gjitha ministritë e linjës dhe njësitë e pushtetit vendor. Referuar raportit të katërt periodik kombëtar mbi zbatimin e Konventës "Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit të grave", "deri në shtator 2013 në nivel qendror, vetëm 3 nga 15 ministri kishin të përcaktuar me strukturë një nëpunës gjinor, ndërsa ministritë e tjera kishin pika fokale për çështjet e barazisë gjinore"[220].

*Në nivel vendor:*

413. Përvojat lidhur me buxhetimin gjinor në nivel lokal kanë evidentuar nevojën për zhvillimin e kapaciteteve në autoritetet lokale, të tilla që të sigurojnë aplikimin e praktikës së buxheteve gjinore. Për më gjerë, një analizë gjinore e strategjive sektoriale do të mundësonte adresimin e duhur të nevojave dhe të drejtave të grave dhe të burrave në sektorë të ndryshëm të ekonomisë dhe shoqërisë[221].

414. Buxhetimi dhe planifikimi gjinor u zbatua në bashkinë e Tiranës, Vlorës, Shkodrës[222], etj., gjatë vitit 2013.

415. Janë përgatitur politika dhe plane të veprimit me orientim gjinor në bashkinë e Burrelit, Fierit[223], Durrësit, Korçës, etj., gjatë vitit 2013-2014. Këto politika dhe plane veprimi kanë integruar çështjen e barazisë gjinore ose kanë përbërë politika dhe plane veprimi specifike për barazinë gjinore.

416. Referuar raportit të katërt periodik kombëtar mbi zbatimin e Konventës "Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit të grave", "..Në nivel vendor, nga 65 bashki në total, 18 kanë zyra të posaçme të BGJ me nëpunës gjinorë të emëruar me kohë të plotë, ndërsa 47 bashki kanë pika fokale të BGJ[224]".

*Rekomandime:*

417. Rekomandohet ngritja dhe forcimi i mekanizmave për barazinë gjinore në nivel qendror dhe vendor, veçanërisht shpejtimi i procesit për emërimin e nëpunësve gjinorë në strukturat e ministrive dhe të nëpunësve vendorë për çështjet gjinore në bashkitë e vendit, me kohë të plotë. Përmbushja e këtij rekomandimi do të siguronte integrimin gjinor në politika, buxhete, etj.

219 Raport i UN Women mbi buxhetimin gjinor, 2012. Raporte të UN Women mbi bashkëpunimin me qeverinë në kuadrin e programit të bashkëpunimit të UN me qeverinë shqiptare 2012-2016.

220 Raporti i katërt periodik kombëtar mbi zbatimin e Konventës "Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit të grave", miratuar me VKM nr. 806, datë 26.11.2014. Fletorja zyrtare e RSH nr. 187/2014, fq. 10179.

221 Avokati i Popullit, raport i veçantë "Për dhunën ndaj grave dhe veprimtarinë e Avokatit të Popullit", korrik 2012, fq. 19. (nr. 208, datë 24.07.2012)

222 UN Women ka kontribuar në vazhdimësi në këtë proces.

223 Këto politika dhe plane veprimi janë përgatitur me mbështetjen e Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim, PNUD dhe agjencive të tjera të UN.

224 Raporti i katërt periodik kombëtar mbi zbatimin e Konventës "Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit të grave", miratuar me VKM nr.806, datë 26.11.2014. Fletorja zyrtare e RSH nr.187/2014, fq. 10180.

418. Rekomandohet marrja e masave me qëllim që të sigurohet qëndrueshmëria e nëpunësve gjinorë dhe forcimi i kapaciteteve të tyre në nivel qendror dhe vendor.

# BIBLIOGRAFIA


- Kushtetuta e RSH-së miratuar me Ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, i ndryshuar

**Akte ndërkombëtare të ratifikuara nga RSH-së dhe akte të tjera ndërkombëtare**

- Konventa CEDAW, ratifikuar me ligjin nr. 1769, datë 9.11.1993, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 33, datë 15.10.2008.
- Konventa e Këshillit të Europës "Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje", ratifikuar me ligjin nr. 104/2012.
- Konventa e OKB-së "Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara", ratifikuar me ligjin nr. 108/2012.
- Direktiva 2000/78 EC, neni 10.
- Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme 48/134 e 20 Dhjetorit 1993.
- Komiteti CEDAW, Rekomandimi i Përgjithshëm nr.33, mbi aksesin e grave në drejtësi
- Komiteti CEDAW, Rekomandimi i Përgjithshëm nr. 13, "Pagë e barabartë për punë me vlerë të barabartë".
- Komiteti CEDAW, Rekomandimi i Përgjithshëm nr.19.
- Komiteti CEDAW, Rekomandimi i Përgjithshëm nr.5, (masat e veçanta të përkohshme).
- Komiteti CEDAW, Rekomandimi i Përgjithshëm nr.23, (jeta politike dhe publike).
- Vërejtjet Përmbyllëse të Komitetit CEDAW për Shqipërinë në 2010.

**LIGJE DHE AKTE NËNLIGJORE**

- Ligji nr.8454, datë 4.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar.
- Ligji nr.9970, datë 24.07.2008, "Për barazinë gjinore në shoqëri".
- Ligji nr.10221, datë 4.2.2010, "Për mbrojtjen nga diskriminimi".
- Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë miratuar me ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, ndryshuar me ligjin nr. 74/2012, datë 19.07.2012.
- Ligji nr.74/2012, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, 'Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë'.
- Ligji nr.10 039, datë 22.12.2008, "Për ndihmën juridike", të ndryshuar".
- Ligji nr.143/2013, "Për disa shtesa në ligjin nr.10039, datë 22.12.2008, "Për ndihmën Juridike".
- Ligji nr.77/2014, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.10 039, datë 22.12.2008, 'Për ndihmën juridike', të ndryshuar".
- Ligji nr.23/2012, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7895, datë 27.1.1995 'Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë'", të ndryshuar.
- Ligji nr.144/2013, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7895, datë 27.1.1995 'Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë'", të ndryshuar.
- Kodi i Punës, miratuar me Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, i ndryshuar.
- Ligji nr.104/2014, datë 31.07.2014,"Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.7703, datë 11.05.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.
- Ligji nr.10 399, datë 17.3.2011, "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9355, datë 10.3.2005 'Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore'", i ndryshuar.
- Ligji nr.9062, datë 8.5.2003, "Kodi i Familjes".
- Ligji nr.8652, datë 31.07.2000 "Për

organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore".

- Ligji nr.7767, datë 9.11.1993, "Për aderimin në Konventën 'Për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave".
- Ligji nr.9052, datë 17.4.2003, "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Protokollin Shtesë të Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave".
- Ligji nr.8485, datë 12.5.1999, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë".
- Ligji nr.8503, datë 30.6.1999,"Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare".
- Ligji nr.9888, datë 10.3.2008, "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve".
- Ligji nr.44/2012, datë 19.4.2012, "Për shëndetin mendor".
- Ligji nr.9135, datë 11.9.2003, "Për mbrojtjen e konsumatorit".
- Ligji nr.93/2014, "Për përfshirjen dhe akesueshmërinë e PAK".
- Ligji nr.33/2012, "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme".
- Ligji nr.152/2013, "Për nëpunësin civil".
- Ligji nr.69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar".
- Ligji nr.54/2012, datë 10.05.2012, "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9232, datë 13.5.2004 'Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane', të ndryshuar".
- Udhëzimi nr.02, datë 18.08.2011, "Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të institucioneve buxhetore në llogari të thesarit", botuar në Fletoren Zyrtare nr. 133, datë 28.09.2011.
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.904, datë 12.12.2012, "Për përcaktimin e kritereve, të procedurave dhe dokumentacionit të përfitimit të ndihmës ekonomike në zonat pilot".

**Raporte, rekomandime dhe dokumenta të institucionit të AP**

- AP, Raport i veçantë nr.208 date 24.07.2012, "Për dhunën ndaj grave dhe veprimtarinë e Avokatit të Popullit", korrik 2012, f.19,22,25, 33, 36,37. http://www.parlament.al/web/pub/2012_raporti_per_dhunen_ndaj_grave_15414_1.pdf
- AP, "Mbi fenomenin e gjakmarrjes", 2013, fq.7,29. http://www.parlament.al/web/pub/2013_raporti_per_gjakmarrjen_15419_1.pdf
- AP, Raport "Për zbatimin e masave të parashikuara në rekomandimet 6, 7, 10, 11 dhe 12 të BE për Shqipërinë, të cilat kanë lidhje me fushën e veprimtarisë së Avokatit të Popullit, si dhe aktiviteti i institucionit lidhur me këto rekomandime, gjatë periudhës janar-qershor 2012", Tiranë, Korrik 2012, f.5,6,7,13.
- http://www.avokatipopullit.gov.al/sites/default/files/ctools/Raport%20i%20vecante%20masat%20e%20BE.pdf
- AP, Raport i veçantë, "Për situatën e krijuar nga mosekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë", nr. 211, dt..27.07.2012,fq.5,6,8,11,26.
- http://www.parlament.al/web/pub/2012_raporti_per_vendimet_gjyqesore_15413_1.pdf
- Raport i posaçëm i veprimtarisë së Avokatit të Popullit gjatë vitit 2012 për të drejtat e personave LGBT, nr.245, datë 05.09.2012. http://www.parlament.al/web/pub/2012_raporti_per_lgbt_15412_1.pdf
- Raport Vjetor "Për veprimtarinë e Avokatit të Popullit", Viti 2013, nr.65, datë 21.02.2014, f.15.
- Raport Vjetor "Për veprimtarinë e Avokatit të Popullit", Viti 2012, fq.49.
- Raportit Vjetor "Për Veprimtarinë e Avokatit të Popullit", 1 janar-31 dhjetor 2014,fq.12.
- AP, "Raport i posaçëm i veprimtarisë së Avokatit të Popullit për punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuar (PAK), në

institucionet e pushtetit qendror e atij lokal", fq. 10, Prill 2013.

- AP, Draft Raport, "Për ndjekjen, analizimin dhe evidentimin e shkaqeve që kanë ndikuar në rritjen e kërkesave për azil të shtetasve shqiptarë në shtetet anëtare të zonës Shengen", 2014,fq.12,13.
- AP, "Sugjerime dhe konstatime mbi Udhërrëfyesin mbi 5 prioritetet miratuar me VKM Nr.330 datë 28.05.2014", shkresë Nr. 296 datë 01.10.2014, drejtuar Ministres së Integrimit Evropian znj. Klajda Gjosha.
- Shkresa Nr.197/1 date 13.06.2014 , "Dërgohen mendime dhe komente mbi projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr.10039, datë 22.12.2008 "Për ndihmën Juridike", i ndryshuar.
- Komente dhe mendime të Avokatit të Popullit për Progres Raportin e KE-së për Shqipërinë për 2014, Tiranë 2014, f.1,2,3,4,5,6. Procesverbali i mbledhjes dt. 12.11.2014 i Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, Seancë dëgjimore me Avokatin e Popullit për progres raportin e vitit 2014.
- Avokati i Popullit, "Road Map", Për zbatimin e reformave të nevojshme për 5 prioritet kyçe për procesin e integrimit në Bashkimin Evropian, fq.10,16,17.
- Shkresa e AP nr.116, datë 13.04.2012. Relacion për ndryshimet e Ligjit nr.7961/1995, dërguar MPCSSHB.
- Avokati i Popullit, Botim Periodik i Institucionit të Avokatit të Popullit, nr.1, Nëntor 2014, fq.9,10, 23.

**Rekomandime**

- AP, Rekomandohet plotësimi i nenit 32 të Ligjit Nr. 7961 datë 12.07.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", (i ndryshuar), 2013. Nr. Dok. 201301585/2.
- AP, Rekomandohet plotësimi i nenit 32 të Ligjit Nr. 7961 datë 12.07.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", (i ndryshuar), 2013, Nr. Dok. 201301585/4.
- AP, "Propozim lidhur me një shtesë në projekt-aktin e përgatitur nga Ministria e Drejtësisë për ndryshime në Kodin Penal", 2013.
- Rekomandimi nr.97 datë 05.04.2013. Relacion për disa përmirësime në Ligjin nr.10221 datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi'. Dërguar Ministrisë se Drejtësisë dhe MPCSSHB.
- Rekomandimi nr.Doc.201501690/2, mbi ndryshimet në ligjin nr.9062, datë 05.08.2003, "Kodi i Familjes i RSH-së".
- Rekomandim legjislativ për përmirësimin e dispozitave të Ligjit nr.9482 datë 3.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", i ndryshuar, Nr.K3/Th16-2 datë 19.11.2014, (Nr. Dok.201401933/2), drejtuar Ministres së Zhvillimit Urban dhe Turizmit, Zj. Eglantina Gjermeni dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integrimit të Zonave/ Ndërtimeve Informale, Drejtorit të Përgjithshëm, Z.Artan Lame.
- Realizimi i disa përmirësimeve në Ligjin nr.69 datë 21.06.2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të cilat do të parashikojnë dhe garantojnë integrimin në arsim të fëmijëve Romë, nga niveli parashkollor e deri në nivelet e tjera më të larta të arsimit; (shkresa nr.K1/I62-6 datë 23.12.2013).
- AP, Rekomandimi nr.dok.201500100/2, janar 2015, "Rekomandim për marrjen e iniciativës për përmirësime në Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë me synim përfaqësimin dhe aksesin e barabartë gjinor".
- Rekomandimi nr. K1/V12-4. Prot, nr. Dok.201401869/4, datë 4.12.2014, "Rekomandohet marrja e masave konkrete për përmirësimin e formulës së sistemit të pikëzimit, për përfitimin e ndihmës ekonomike", drejtuar Ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë Z. Erion Veliaj. http://www.avokatipopullit.gov.al/sites/default/files/ctools/css/REKOMANDIMI%20per%20ndihmen%20ekonomike.pdf

- Rekomandim Nr.K3/A83-2 datë 18.11.2014 (nr. Dok. 201402095/2), Rekomandim për analizimin e menjëhershëm të praktikave administrative të ndjekura dhe akteve administrative të nxjerra nga ana e INUK, për ndërtimet e ndodhura në zonën e Selitës, ku do të zbatohet projekti i ndërtimit të "Unazës së Re", drejtuar Zj. Dallëndyshe BICI, Kryenispektore e Inspektoriatit Ndërtimor Urbanistik, Kombëtar dhe z. Saimir Tahiri, Ministër, Ministria e Punëve të Brendshme. http://www.avokatipopullit.gov.al/sites/default/files/ctools/css/Rekomandim%20_vendimamrja%20INUK%2017%20nentor%202014.pdf

- "Rekomandim për marrjen e masave për regjistrimin e pjesëtarëve të minoritetit Rom ne regjistrat e gjendjes civile, në njësitë vendore ku ata kanë vendbanimin aktual".

- Rekomandim Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta për ndërhyrjen urgjente dhe verifikimin e situatës së rëndë sociale, si dhe zgjidhjen e problemit të strehimit të pjesëtarëve të komunitetit Rom në kampin e ish-Dekorit. (shkresa nr.K3/M39-7 date 12.08.2013)

- Rekomandim Bashkisë Tiranë për zgjidhjen e problemit të strehimit të pjesëtarëve të komunitetit Rom në kampin e ish-Dekorit.(shkresa nr.K3/M39-5 date 6.08.2013)

- Rekomandim Shefit të Komisariatit nr. 2 për hetimin e kallëzimeve penale me objekt cenimin e jetës dhe shëndetit të pjesëtareve të komunitetit Rom në kampin e ish-Dekorit. (shkresa nr.K3/M39-6 date 12.08.2013)

- Rekomandim Ministrisë së Shëndetësisë për marrjen e masave për trajtimin dhe asistencën e vazhdueshme shëndetësore për pjesëtarët e komunitetit Rom në kampin e ish-Dekorit.(shkresa K3/M39-8 date 15.08.2013)

- Rekomandimi drejtuar Drejtorisë Arsimore Rajonale Tiranë për marrjen e masave për të mundësuar regjistrimin e fëmijëve të komunitetit Rom, që jetojnë në kampin e ish Dekorit në rrugën e Kavajës, në shkollat 9-vjeçare pranë vendbanimit aktual të tyre dhe pajisjen e tyre me libra dhe bazën mësimore falas. (shkresa nr.K1/L44-4 date 12.09.2013)

- AP ka rekomanduar përmirësimin e kushteve të jetesës në vendbanime konkrete të minoritetit Rom, sikurse godina e ish Repartit Ushtarak, të ndodhur në Zonën e Sharrës, Tiranë. (K3/E53-2 date 6.11.2013)

- Rekomandimi nr.Dok.201401900/4, "Rekomandohet garantimi dhe respektimi i të drejtave të banorëve të komunitetit rom në zonën e Selitës lidhur me programet e strehimit social", drejtuar Bashkisë Tiranë, Entit Kombëtar të Banesave, Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Turizmit dhe Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë. (shkresa nr.K3/Sh63-4 date 18.11.2014)

- Rekomandimi nr.116, datë 13.4.2012, drejtuar Z. Spiro Ksera, ish Ministër i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

- Rekomandimet për IEVP "Ali Demi" janë dërguar me shkresën Nr. K4/I35-2 Prot., datë 02.09.2015.

- Rekomandimet për Institucionin e Veçantë Shëndetësor të Burgjeve (IVSHB) janë dërguar me shkresën Nr. K4/I6-2 Prot., datë 22.01.2015.

**Politika**

- Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Reduktimin e dhunës me bazë gjinore dhe Dhunës në Familje, 2011-2015. Kjo Strategji është miratuar me VKM nr.573, datë 16.06.2011.

- Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2014-2020, miratuar me VKM "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2014 – 2020 dhe të Planit të Veprimit për zbatimin e saj", botuar në Fletoren Zyrtare nr.188/2014, fq.10322,10355.

- Strategjia Ndërsektoriale, Reforma në fushën e të drejtave të pronësisë 2012-2020 http://www.drejtesia.gov.al/, fq.25.

**Raporte të shtetit shqiptar**

- Raporti i Katërt Periodik Kombëtar mbi zbatimin e Konventës "Për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave", miratuar me VKM nr.806, datë 26.11.2014. Fletorja Zyrtare e RSH nr.187/2014, fq. 10177,10178,10179,10180, 10181,10183,10184,10186,10198,10203;

**Botime të tjera**

- Parimet në lidhje me statusin e institucioneve kombëtare për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut ("Parimet e Parisit"), Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme 48/134 e 20 dhjetorit 1993.
- KQZ, Raport për Veprimtarinë e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, 1 janar-31 dhjetor 2014, i vlefshëm në: http://www2.cec.org.al/Portals/0/Images/CEC/Legjislacioni_2015/VENDIME_2015/VENDIM_29/KQZRaporti%20per%20Kuvend%20%202014.pdf
- OSCE, "ZGJEDHJET PARLAMENTARE", 23 qershor 2013, Misioni i OSBE/ODIHR-it për Vëzhgimin e Zgjedhjeve, Raporti Përfundimtar. Ky raport është i vlefshëm në http://www.osce.org/sq/odihr/elections/
- A.Anastasi&A.Mandro&E.Shkurti & A.Bozo, "Barazia gjinore dhe mosdiskriminimi", ' Barazia gjinore në vendimmarrje', Tiranë 2012, fq.98.
- Raporti përfundimtar i Misionit të OSBE/ODIHR-it për Vëzhgimin e Zgjedhjeve, "Zgjedhjet e qeverisjes vendore", 8 maj 2011,fq.22. Ky raport është i vlefshëm në http://www.osce.org/sq/odihr/
- Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Raport mbi situatën e respektimit të të drejtave të njeriut në Shqipëri për vitin 2014. Tiranë, Dhjetor 2014, fq.28.
- Prof.Dr.Av.Aurela Anastasi, "In margine al Sinodo 2014", 'Çështje të ekzekutimit te vendimeve gjyqësore për detyrimin ushqimor ndaj fëmijëve në rastet e shkurorëzimit (Rasti i Shqipërisë)', Bari 2014, f.44.
- Programi i Kombeve të Bashkuara për mbështetjen e përfshirjes sociale në Shqipëri, "Strehimi social në shqipëri: vlerësim i nevojave", Tiranë 2014, f.8.
- FSHDPAK, "Objektivat e programit qeverisës dhe planet për aftësinë e kufizuar", Raport vëzhgimi, Tiranë 2014, fq.28.
- Prof.Dr.Arta Mandro, Statusi i realizimeve të Vërejtjeve Përmbyllëse të Komitetit CEDAW. Periudha: nga shqyrtimi i raportit të tretë periodik të Shqipërisë korrik 2010-deri në Nëntor 2012, fq.8.
- INSTAT, "Perspektiva gjinore në Shqipëri", Analiza gjinore e rezultateve të censusit 2011 të popullsisë dhe banesave, Tiranë 2014, f.68.
- Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim, "Pabarazia gjinore në pagë një rast shqiptar", Tiranë 2012, fq.31.
- INSTAT, "Dhuna në familje në Shqipëri", Vrojtim kombëtar me bazë popullatën, 2013,fq.33,53. Raport i përgatitur nga Dr.Robin N, Haarr, Konsulente ndërkombëtare e PNUD-it.
- Prof.Dr.Arta Mandro (Balili) & Av.Aurela Bozo & Prof.Dr.Aurela Anastasi, "Njohja dhe zbatimi i standardeve të barazisë gjinore në procesin gjyqësor", Raport mbi gjetjet kryesore nga monitorimi i vendimeve të Gjykatave të shkallës së I-rë, të Rretheve Gjyqësore Tiranë, Durrës, Shkodër e Vlorë, 1 janar 2011-1 qershor 2012. fq.13,49, Tiranë, Dhjetor 2013.
- Komiteti Shqiptar i Helsinkit, "Reforma në shërbimet sociale dhe roli i njësive të qeverisjes vendore", Tiranë 2014. fq.45.
- A.Mandro, "Të drejtat pronësore të grave, Rasti i Shqipërisë", Tiranë 2013, f.64,89, përgatitur me mbështetjen teknike dhe financiare të Entit të Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave (UN Women) në bashkëpunim me Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe Ministrinë e Drejtësisë.
- QNL, "Të drejtat pronësore dhe gruaja", Broshurë informuese, Tiranë 2014, f.10, 20.

- Kjo broshurë është përgatitur nga Qendra për Nisma Ligjore Qytetare, me mbështetjen financiare dhe teknike të Entit të Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave në Shqipëri (UN Women) në kuadër të Programit të Bashkëpunimit ndërmjet Qeverisë së Shqipërisë dhe Kombeve të Bashkuara 2012-2016.
- QNL, Raport, "Analizë e kuadrit ligjor mbi nënkontraktimin e OJF-ve nga organet qendrore dhe vendore, për shërbimet e dhunës në familje". Ky raport është i vlefshëm në www.qag-al.org
- QNL, Studim, "Çështje të rritjes së efektivitetit, transparencës dhe të besimit të publikut në gjyqësor", Rezultate të nxjerra nga monitorimi i seancave dhe studimi i jurisprudencës gjyqësore në lidhje me mbrojtjen e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, në rrethet gjyqësore Tiranë, Elbasan, Shkodër, Vlorë. Periudha e monitorimit: Shkurt 2012 - Tetor 2013, fq. 59. Ky raport është i vlefshëm në web www.qag-al.org
- Raport i UN Women mbi buxhetimin gjinor, 2012.
- Raporti mbi të Drejtat e Njeriut, 2013. http://albanian.tirana.usembassy.gov/latest-embassy-news/2014---deklarata/raporti-pr-t-drejtat-e-njeriut-pr-vitin-2013-26-shkurt-2014.html
- Cani Drenofci, B (2012), Field notes on women with disabilities in the E&E region (Albania), fq.10.
- USAID, "Gratë me AK në rajonin e Evropës dhe EuroAzisë", 2012, fq. 5,28.
- Këshilli i Lartë i Drejtësisë, Inspektorati, "Raport tematik mbi dhunën në familje dhe masat e sigurimit për mbajtjen pa leje të armëve luftarake", Janar 2014.

**WEBSITE**

- European Commission, Albania 2014 Progress Report. http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2014/20141008-albania-progress-report_en.pdf
- http://albanian.tirana.usembassy.gov/latest-embassy-news/2014---deklarata/raporti-pr-t-drejtat-e-njeriut-pr-vitin-2013-26-shkurt-2014.html
- www.gazetaidea.com, 3 Maj 2013.
- Komisioni Europian, Progres Raporti 2014 për Shqipërinë, http://www.integrimi.gov.al/al/dokumenta/progres-raporte/progres-raporti-2014&page=1
- Këshilli i Lartë i Drejtësisë, Inspektorati, "Raport tematik mbi dhunën në familje dhe masat e sigurimit për mbajtjen pa leje të armëve luftarake", Janar 2014. Një nga temat në objekt të inspektimit të kryer ishte: Roli i gjykatave në luftën kundër dhunës në familje nëpërmjet kontrollit të çështjeve me objekt "Lëshimin e Urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes" dhe "Lëshimin e Urdhrit të Mbrojtjes". Kontrollit iu nënshtruan 28 gjykata të vendit, nga të cilat 6 gjykata të apeleve dhe 22 gjykata të shkallës së parë. Raporti tematik është i vlefshëm në web: http://kld.al/korniza-ligjore/akte-nenligjore/raport-mbi-dhunen-ne-familje .
- Vendimi i KMD nr.100, datë 14.10.2013, http://kmd.al/skedaret/1383048306-Vendim%20Nr%20100.pdf
- Vendimi i KMD nr.101, datw 18.10.2013, http://www.kmd.al/skedaret/1383048378-Vendim%20Nr%20101.pdf
- http://kmd.al/skedaret/1394541003-Raporti%20vjetor%202013.pdf
- Strategjia Ndërsektoriale, Reforma në fushën e të drejtave të pronësisë 2012-2020 http://www.drejtesia.gov.al
- INSTAT, Femra dhe Meshkuj 2014,fq.65,90,93. http://www.instat.gov.al/media/257796/femra_dhe_meshkuj_2014_.pdf.
- http://www.ecoi.net/file_upload/1226_1390300219_com-instranet1.pdf
- http://www.sociale.gov.al/files/documents_files/Raporti_Final_Pekin+20_dt_30.04.2014.pdf
- INSTAT, Femra dhe Meshkuj 2013.

- http://eeas.europa.eu/delegations/albania/documents/al_rapport_2013.pdf
- web: http://www.shkp.gov.al
- Shërbimi Kombëtar i Punësimit, Buletini i Tregut të Punës 2013, fq. 7,12,27,28,32,. i vlefshëm në http://www.kerkojpune.gov.al
- http://www.integrimi.gov.al/al/dokumenta/progres-raporte/progres-raporti-2014&page=1
- http://www.instat.gov.al/media/257796/femra_dhe_meshkuj_2014_.pdf , f. 77.
- http://www.instat.gov.al/media/247026/regjistri_ndermarrjeve_2013.pdf ,f.9.
- QNL, Studim, "Çështje të rritjes së efektivitetit, transparencës dhe të besimit të publikut në gjyqësor", Rezultate të nxjerra nga monitorimi i seancave dhe studimi i jurisprudencës gjyqësore në lidhje me mbrojtjen e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, në rrethet gjyqësore Tiranë, Elbasan,Shkodër, Vlorë. Periudha e monitorimit: Shkurt 2012 - Tetor 2013, f. 59. Ky raport është i vlefshëm në web www.qag-al.org
- www.magjistratura.edu.al
- http://www.sociale.gov.al/files/documents_files/Raporti_Final_Pekin+20_dt_30.04.2014 .pdf, f.32.
- http://www.qag-al.org/WEB/publikime/kontraktimi_ojf.pdf
- http://www.gjykatatirana.gov.al
- Ministria e Drejtësisë, Vjetari Statistikor 2013, fq.63.
- Gender dissagregated data-Western Balkans, Statistical Reports 2005-2013, fq.60, 70. http://www.fao.org/fileadmin/user_upload/nr/land_tenure/Genders_Report_WB.pdf
- http://www.drejtesia.gov.al/al/dokumente/statistika
- http://www.drejtesia.gov.al/files/userfiles/Analiza_e_sistemit_te_drejtesise_FINAL/Analiza_e_sistemit_te_drejtesise_FINAL.pdf
- http://www.avokatipopullit.gov.al/sites/default/files/ctools/css/Rekomandimi%20MAS%202.pdf
- http://www.avokatipopullit.gov.al/sites/default/files/ctools/css/Rekomandimi%20MAS%203_0.pdf

**ANKESA**

- Ankesa F.T, (2013), Ankesa L.K (2011), Ankesa e D.N., në lidhje me të drejtën e takimit të fëmijëve. (2013), Ankesa V.T. (2013) V.T., Ankesw e shtetases E.P, nr.doc.201201794.(2012)
- Çështja e ankueses nga komuniteti rom, M.K. Nr. Dok. 201302695/10, K1/M65-10, datë 15/05/2014. (Rekomandimi dërguar Bashkisë Tiranë është zbatuar pjesërisht).
- Çështja e ankueses nga komuniteti rom, M.SH. Nr. Dok. 201201724/9, K1/M27-9, datë 10/06/2014. (Rekomandimi dërguar Bashkisë Tiranë është pa përgjigje)
- Ankesë e Zh.P trajtuar nga AP, Nr. Dok. 201400928/4, 2014.
- Rast me iniciativë, M.D., nr.201302146.

**INTERVISTA**

- Intervista me shtetasen R.G.
- Intervista me përfaqësuesin e Zyrës Rajonale Pogradec, Egli Rustemi, botuar në "Avokati i Popullit", Botim Periodik i institucionit të Avokatit të Popullit, nr. 1, Nëntor 2014.